



ANALIZË E POLITIKAVE

Nr. 3/14 – MAJ 2014

Kosova në Kontekst Rajonal: Marrëdhëniet Politike Bilaterale

Ky projekt është përkrahur nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë



**NORWEGIAN MINISTRY
OF FOREIGN AFFAIRS**

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të KIPRED-it, dhe këto nuk duhen konsideruar si pikëpamje të donatorit.

Përgatitur nga: Shpend Kursani, Violeta Haxholli dhe Gent Gjikolli

Copyright © 2014 KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet dhe të ruhet në ndonjë sistem rikuperues, apo të bartet në çfarëdo forme apo në çfarëdo mënyre, elektronike, mekanike, fotokopjuese apo tjetërfare, pa lejen paraprake në shkrim të botuesit. Luteni të kontaktoni info@kipred.org or +381 38 227 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave

Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778

www.kipred.org

Përmbajtja

1	Hyrje e Përgjithshme.....	4
1.1	Kosova dhe dinamika politike në rajon.....	4
1.2	Marrëdhëniet dhe kontaktet bilaterale	8
1.3	Shtetet rajonale dhe subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës.....	13
1.4	Metodologjia	15
2	Kosova dhe shtetet fqinje	20
2.1	Politikat e jashtme dhe rajonale	20
2.2	Cilësia e marrëdhënieve me shtetet fqinje.....	23
2.2.1	Marrëdhëniet bilaterale me SHQIPËRINË	23
2.2.2	Marrëdhëniet bilaterale me MAQEDONINË.....	24
2.2.3	Marrëdhëniet bilaterale me MALIN E ZI.....	26
2.2.4	Marrëdhëniet/kontaktet bilaterale me SERBINË.....	27
2.2.5	Çështjet bilaterale shitesë të Kosovës me fqinjët e vet	30
2.2.6	Fqinjët në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës	30
2.3	Intensiteti i marrëdhënieve me shtetet fqinje	35
2.3.1	Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Shqipëria	35
2.3.2	Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Maqedonia	36
2.3.3	Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Mali i Zi.....	38
2.3.4	Intensiteti i marrëdhënieve/kontakteve bilaterale – Kosova dhe Serbia	39
3	Kosova dhe vendet e tjera mosnjohëse të rajonit	41
3.1	Politikat e jashtme dhe rajonale	41
3.2	Cilësia e marrëdhënieve me mosnjohësit e tjerë në rajon.....	43
3.2.1	Marrëdhëniet/kontaktet bilaterale me BH.....	43
3.2.2	Marrëdhëniet/kontaktet bilaterale me GREQINË.....	45
3.2.3	Marrëdhëniet/kontaktet bilaterale me RUMANINË	47
3.2.4	Mosnjohësit rajonalë në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës.....	50
3.3	Intensiteti i marrëdhënieve me mosnjohësit e tjerë të rajonit.....	53
3.3.1	Intensiteti i marrëdhënieve/kontakteve bilaterale – Kosova dhe BH.....	53
3.3.2	Intensiteti i marrëdhënieve/kontakteve bilaterale – Kosova dhe Greqia.....	54
3.3.3	Intensiteti i marrëdhënieve/kontakteve bilaterale – Kosova dhe Rumania	55
4	Kosova dhe shtetet e tjera anëtare të UE-së në rajon.....	57
4.1	Politikat e jashtme dhe rajonale	57
4.2	Cilësia e marrëdhënieve me shtetet e tjera anëtare të UE-së.....	59
4.2.1	Marrëdhëniet bilaterale me SLOVENINË.....	59
4.2.2	Marrëdhëniet bilaterale me KROACINË.....	60
4.2.3	Marrëdhëniet bilaterale me BULLGARINË.....	62
4.2.1	Çështjet bilaterale shitesë të Kosovës me shtetet e tjera anëtare të UE-së.....	63
4.2.2	Shtetet e tjera të UE-së në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës.....	63
4.3	Intensiteti i marrëdhënieve me shtetet e tjera anëtare të UE-së.....	66
4.3.1	Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Kroacia.....	66
4.3.2	Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Sllovenia.....	67
4.3.3	Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Bullgaria	69
5	Kosova dhe Turqia	71
5.1	Politika e jashtme dhe rajonale.....	71
5.2	Cilësia e marrëdhënieve me Turqinë.....	71
5.3	Turqia në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës	73
5.4	Intensiteti i marrëdhënieve me Turqinë	74
6	PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME	78
7	Anekset	80

1 HYRJE E PËRGJITHSHME

Ky studim shqyrton marrëdhëniet politike bilaterale të Kosovës me 11 shtetet e rajonit që nga shpallja e pavarësisë nga ana e saj në shkurtin e vitit 2008. Ky studim përqendrohet në atë se si Kosova ia doli të përshtatej në rajon, ku, edhe përkundrejt asaj që shumica e shteteve e kanë pranuar, shtetësia dhe legjitimiteti rajonal i saj ende mbeten të sfiduara nga njëri nga shtetet fqinje, si dhe nga disa shtete të tjera të rajonit, përfshirë këtu edhe disa nga shtetet anëtare të Unionit Evropian (UE) të tij. Kjo Hyrje e Përgjithshme së pari e elaboron dhe e vë Kosovën përkundrejt dinamikës aktuale rajonale, dhe më pastaj i përmbledh gjetjet dhe qëllimet kryesore me metodologjinë e shfrytëzuar, për ta vlerësuar cilësinë dhe intensitetin e marrëdhënieve politike midis Kosovës dhe çdo shteti tjetër të rajonit. Punimi është i ndarë në pesë pjesë kryesore. E para merret me cilësinë dhe intensitetin e marrëdhënieve bilaterale të Kosovës me shtetet fqinje të saj; pjesa e dytë merret me cilësinë dhe intensitetin e marrëdhënieve dhe kontakteve të Kosovës me shtetet e tjera të rajonit që nuk e kanë pranuar atë; pjesa e tretë merret me cilësinë dhe intensitetin e marrëdhënieve bilaterale të Kosovës me vendet e tjera të rajonit që janë anëtare të UE-së; pjesa e katërt merret me cilësinë dhe intensitetin e marrëdhënieve bilaterale me Turqinë; dhe në pjesën e fundit është Përfundimi. Ajo që është më e afërta me përshkrimin e gjetjeve të këtij studimi është pohimi i dhënë nga Ambasadori i Bullgarisë në Kosovë, Bobi Bobev, që ka deklaruar se “Në Ballkan, marrëdhëniet midis shteteve historikisht janë shumë të mira, përderisa ato të mos kufizohen me njëri-tjetrin”.¹ Është pikërisht ky qëndrim ai që në masë të madhe e përmbledh cilësinë e marrëdhënieve të Kosovës me të gjitha shtetet e rajonit.

1.1 Kosova dhe dinamika politike në rajon

Kosova është ndër shtetet më të vogla në rajon, dhe atë, si ekonomikisht, ashtu edhe nga aspekti i madhësisë së territorit dhe popullatës së saj, mirëpo kjo në të njëjtën kohë e luan një rol të rëndësishëm për sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Kosova ka treguar që është faktor stabiliteti në dy raste të ndryshme por gradualisht të ngjashme. Së pari, Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit 2008 nuk e destabilizoi rajonin dhe nuk u bëri thirrje aktorëve të tjerë të rajonit për të kërkuar ndryshim kufijsh, ashtu siç u frikësuan disa, dhe që, në fakt, u shfrytëzua si argument (nga ana e Serbisë në këtë rast) kundër pavarësisë së Kosovës. Dhe së dyti, është dialogu në rrjedhje e sipër, i ndihmuar nga UE-ja midis Kosovës dhe Serbisë, i cili filloi më 8 mars 2011, dhe është duke vazhduar ende, dhe, po ashtu, pritet të zgjasë edhe më tutje, dhe i cili përcillet nga afër jo vetëm nga aktorë të tjerë rajonal, por, po ashtu, edhe nga e tërë UE-ja, Shtetet e Bashkuara (SHBA), si dhe nga aktorë të tjerë globalë. Duke e patur parasysh atë që shumica e këtyre aktorëve dialogun midis Kosovës dhe Serbisë e konsiderojnë si një nga faktorët kryesorë të stabilitetit në rajon, që të dyja palët kundërshtuese i mban në tryezën e bisedimeve, pra larg nga mjetet e tjera të bërjes së politikës detyruese, atëherë Kosova, duke qenë pjesë e këtij dialogu, e mban mbi vete një pjesë të konsiderueshme të stabilitetit rajonal. Edhe përkundrejt kësaj, dhe duke e lënë anash rastin e Bosnje-Hercegovinës (BH), rajoni është ende i ngarkuar nga një rast i pazgjidhur dhe kompleks, që është procesi i krijimit të shtetit të ri, jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropë, i cili ka filluar me Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, por nuk ka përfunduar ende. Pesë nga 28 vendet anëtare të UE-së, dhe 4 nga 11 shtetet e rajonit që analizohen në këtë punim, Kosovën nuk e kanë njohur ende, duke e lënë kësajsoj dinamikën e këtij rasti në fatin

¹ Bobi Bobev (Ambasador, Ambasada e Bullgarisë në Kosovë), intervistë në Prishtinë, 3 tetor, 2013.

e dialogut të ndihmuar nga UE-ja midis Kosovës dhe Serbisë, dhe atë jo vetëm si një proces, por po ashtu në pajtim me rezultatet përfundimtare që do t'i japë.

Nga këndvështrimi i Kosovës, i tërë rajoni të cilin ky punim e shqyrton duke e vënë Kosovën përballë çdonjërit dhe të gjitha shteteve të rajonit ashtu që t'i analizojë marrëdhëniet dhe kontaktet bilaterale me to, përbëhet nga katër shtetet fqinje të Kosovës (Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia), pesë shtete anëtare të UE-së (Kroacia, Sllovenia, Bullgaria, Greqia dhe Rumania), dhe dy shtete të tjera që nuk janë, as fqinje të Kosovës, as anëtare të UE-së, Bosnje-Hercegovina dhe Turqia. Kësisoj, pos fqinjëve të saj, BH dhe Turqia janë të vetmet shtete në rajon që nuk janë shtete anëtare të UE-së, por që kanë aspirata t'i bashkangjiten Unionit në të ardhmen. Pos kësaj, rajoni i ka 7 shtete anëtare të Organizatës së Traktatit Veriatlantik (NATO) (Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Rumania, Sllovenia dhe Turqia), që do të thotë që përmes Shqipërisë që Aleancës iu bashkangjit në vitin 2009, NATO-ja si një trup ndërkombëtar tashmë është bërë fqinj i Kosovës. Nga këto njëmbëdhjetë shtete të rajonit, katër Kosovën nuk e kanë njohur ende: Serbia (shtet fqinj), Greqia dhe Rumania (shtete anëtare të UE-së dhe të NATO-s), dhe BH (shtet që nuk është fqinj, dhe nuk është anëtar i UE-së dhe i NATO-s).

Shtetet	Anëtar i BE-së	Anëtar i NATO-s
Shqipëria	Jo	Po
BH	Jo	Jo
Bullgaria	Po	Po
Kroacia	Po	Po
Greqia	Po	Po
Kosova	Jo	Jo
Maqedonia	Jo	Jo
Mali i Zi	Jo	Jo
Rumania	Po	Po
Serbia	Jo	Jo
Sllovenia	Po	Po
Turqia	Jo	Po

Kjo strukturë rajonale çon po ashtu në një dinamikë komplekse rajonale nga këndvështrimi, si i Kosovës, ashtu edhe i rajonit. Duke e patur parasysh që disa nga shtetet e këtij rajoni (1) tashmë janë anëtare të UE-së dhe të NATO-s; (2) që disa janë vetëm anëtare të NATO-s; (3) që disa aspirojnë t'u bashkangjiten ndonjërit nga këta trupa ndërkombëtarë (4) që të tjerat aspirojnë t'u bashkangjiten të dyve; si dhe (5) që të gjitha e kanë pozicionimin e tyre të dallueshëm gjeografik, atëherë është e qartë që shtetet e këtij rajoni po ashtu i kanë të përbashkëta disa aspekte të politikave të tyre të jashtme dhe rajonale, ndërkohë që përvetësojnë politika dhe qasje të ndryshme në aspektet e tjera. Për shembull, ndërkohë që politikat e jashtme të shteteve fqinje të Kosovës janë që ato në fund t'i bashkangjiten dhe të integrohen në UE, këto nuk e kanë të përbashkët të njëjtën politikë kur fjala është për anëtarësinë në NATO. Serbia tashmë e ka shpallur neutralitetin ushtarak dhe nuk synon, të paktën në një afat kohor të shkurtër apo të mesëm, t'i bashkangjitet Aleancës. Shqipëria, nga ana tjetër, është fqinji i vetëm i Kosovës që është anëtar i NATO-s, ndërkohë që Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia, që të gjithat synojnë të bëhen pjesë të Aleancës në të ardhmen e menjëhershme. Krahasuar me shtetet e tjera të rajonit, përfshirë këtu edhe fqinjët e saj, Kosova ndjek një politikë të jashtme që i shërben interesave më jetike të menjëhershme të ekzistencës së saj, që janë rritja e numrit të njohjeve nga një shumicë absolute e shteteve në bashkësinë dhe në institucionet ndërkombëtare, dhe është i vetmi shtet i rajonit integriteti territorial i të cilit kërcënohet në mënyrë të vazhdueshme nga njëri nga fqinjët e saj. Shtetet e tjera të rajonit nuk janë të përballura me këso kërcënimesh dhe, kësisoj, nuk ndjekin një politikë të tillë të jashtme dhe rajonale të drejtpërdrejtë.

Ngjashëm, shtetet e tjera të rajonit që nuk janë anëtare të UE-së, të tilla si Turqia dhe BH, kanë po ashtu interesa të përbashkëta kur fjala është për bashkangjitjen në UE, edhe pse pengesat që këto i

kanë në rrugën e tyre për në UE janë në tërësi të ndryshme. Ndërkohë që BH, nga njëra anë, përballet me përçarjet e brendshme dhe karakterizohet me elemente të ndryshme të shtetit të dështuar që atë e parandalojnë për t'i bërë reformat dhe për t'i plotësuar kushtet e parashtruara nga UE-ja, Turqia, nga ana tjetër, përballet me përçarjet brenda vetë UE-së rreth asaj se a duhet pranuar apo jo Turqinë, duke i patur parasysh demografinë dhe vendndodhjen e saj gjeografike. Njësoj si Kosova, e cila përqendrohet në interesat e veta të menjëhershme jetike, gjë që shumica e vendeve të tjera të rajonit nuk kanë nevojë ta bëjnë, ashtu edhe BH përqendrohet, po ashtu, në interesat e veta jetike të menjëhershme, që janë mbrojtja dhe zbatimi i plotë i Marrëveshjes Paqësore të Dejtonit, të cilën shumë e shohin si frena të dorës së BH-ës për reformën dhe përparimin e mëtejshëm drejt UE-së.

Kur fjala është për shtetet e rajonit që janë anëtare të UE-së, ato ndjekin politika më të ndryshme të jashtme dhe rajonale në krahasim me shtetet e tjera të rajonit. Duke patur parasysh që tashmë janë anëtare të UE-së, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Rumania dhe Sllovenia ndjekin politika të jashtme dhe rajonale që janë më të veçanta. Politikat që çojnë kah siguria dhe stabiliteti rajonal dhe ruajtja e tyre, janë prioritare për të gjitha shtetet anëtare të UE-së në rajon. Megjithatë, këto kanë dallime kur puna vjen në fqinjëritë e tyre të drejtpërdrejta. Për shembull, duke e patur parasysh 'hisën qeverisëse' paraprake të tyre në ish-Jugosllavinë, Sllovenia dhe Kroacia Ballkanin Perëndimor e mbajnë shumë më afër radarëve të politikave të tyre të jashtme dhe rajonale, se që këtë e bëjnë, për shembull, Bullgaria dhe Rumania. Ngjashëm, duke e patur parasysh vendndodhjen gjeografike të Greqisë dhe fqinjërinë e saj të drejtpërdrejtë, Ballkani Perëndimor është po ashtu lartë në listën e prioriteteve të politikës së jashtme dhe rajonale greke. Radarët e politikave të jashtme dhe rajonale të Bullgarisë dhe të Rumanisë e mbajnë shumë më afër rajonin e Detit të Zi, dhe qëllimi i tyre është ta sigurojnë paqen në atë pjesë të rajonit, gjë kjo e cila Kroacisë, Sllovenisë dhe Greqisë nuk i intereson dhe aq.

Duke e patur parasysh atë që i tërë rajoni tashmë është kthyer kah Perëndimi dhe e ndjek një rend dite të përbashkët për t'u integruar politikisht dhe ekonomikisht në strukturat dhe instrumentet e tij, pos UE-së si një trup ndërkombëtar multilateral, Shtetet e Bashkuara janë po ashtu të vendosura si aktori më i rëndësishëm shtetëror në prioritetet e politikave të jashtme të shumicës së shteteve të rajonit. Shqipëria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Kosova, Serbia dhe Turqia janë vende rajonale që e kanë shprehur në mënyrë të qartë që SHBA-të janë interes i tyre strategjik, dhe, kësaj, këto e kanë vënë si prioritet kultivimin e marrëdhënieve bilaterale me të. Kosova, për shembull, konsideron që "marrëdhëniet e afërta dhe të veçanta me Shtetet e Bashkuara [janë] një prioritet i veçantë i politikës së jashtme të Kosovës".² Shqipëria i konsideron SHBA-të si "aleat i pazëvendësueshëm për demokracinë e re shqiptare";³ ngjashëm, Maqedonia përkushtohet ndaj "fuqizimit të vazhdueshëm të strategjive të veta të partneritetit me SHBA-të".⁴ Po ashtu, edhe Serbia, dhe edhe Mali i Zi, SHBA-të i vendosin krah për krah me UE-në, Rusinë dhe Kinën si shtylla kryesore të politikës së jashtme.⁵ Kroacia konsideron që marrëdhëniet me SHBA-të janë të një "rëndësie të veçantë", dhe që "fuqizimi i marrëdhënieve të partneritetit me SHBA-të mund të ketë një efekt pozitiv në pozitën e tërësishme

² "Foreign Policy Aims" ["Synimet e politikës së jashtme"], MPJ, Kroaci.

³ "Politika e Jashtme", Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë, qasur më 27 janar, 2014, <http://www.punetejashtme.gov.al/en/mission/priorities>.

⁴ "Goals and Priorities" ["Qëllimet dhe Prioritetet"], Ministria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë, qasur më 20 dhjetor, 2013, <http://www.mfa.gov.mk/?q=node/411&language=en-gb>.

⁵ Milan Milenkovic, "Is there a change in Serbian foreign policy" ["A ka ndonjë ndryshim në politikën e jashtme të Serbisë"], Transconflict, 1 shkurt, 2013, qasur më 20 nëntor, 2013, <http://www.transconflict.com/2013/02/is-there-a-change-in-serbian-foreign-policy-102/>.

ndërkombëtare të Kroacisë dhe në realizimin e qëllimeve të politikës së saj të jashtme.”⁶ Ngjashëm, Turqia synon t’i forcojë më tutje marrëdhëniet e veta bilaterale me SHBA-të pos atyre me shtetet e veçanta anëtare të UE-së.⁷

Bullgaria dhe BH, nga ana tjetër, marrëdhëniet bilaterale me SHBA-të i konsiderojnë si të rëndësishme, mirëpo, këtë e bëjnë në një mënyrë më të nënkuptuar dhe për çështje kontekstuale të ndryshme. Bullgaria, për shembull, marrëdhëniet SHBA-UE i shikon si një politikë të rëndësishme të jashtme, dhe përpiqet të zhvillojë marrëdhënie solide me SHBA-të dhe ta intensifikojë dialogun dhe bashkëpunimin politik në të gjitha nivelet; një nga synimet e Bullgarisë në marrëdhëniet me SHBA-të është heqja e hyrjes me viza në SHBA për shtetasit bullgarë.⁸ Duke e patur parasysh që mbrojtja dhe zbatimi i Marrëveshjes Paqësore të Dejttonit janë të një rëndësie më të lartë për BH-ën, atëherë marrëdhëniet bilaterale me “vendet anëtare të Bordit Drejtues të Këshillit për Zbatimin e Paqes [si] SHBA-të, Federata Ruse, Britania e Madhe, Franca, Kina, vendet e tjera anëtare të Këshillit të Sigurimit të KB, [dhe] vendet anëtare të Unionit Evropian” janë jetike.⁹ Greqia, Rumania dhe Sllovenia përpiqen t’i forcojnë marrëdhëniet me SHBA-të përmes platformës së NATO-s.

Së fundi, ajo që e karakterizon dinamikën në rajon është politika e orientuar etnikisht, që e ndjekin shumica e shteteve të rajonit, dhe në veçanti fqinjët e Kosovës. Pos “marrëdhënieve të tyre të mira fqinjësore” të përbashkëta, një politikë kjo e përbashkët për fqinjët e Kosovës, shumica prej tyre i japin rëndësi dhe vëmendje shtesë ndonjë vendi të veçantë fqinj me të cilin e kanë të përbashkët, ose identitetin kulturor, ose të kaluarën historike, ose prapaskenën, dhe kështu janë të prirura të ruajnë marrëdhënie më të veçanta bilaterale me to se me shtetet e tjera. Kështu, për shembull, pos pohimit që politika e saj e jashtme synon të zhvillojë “marrëdhënie të mira me shtetet fqinje”, Kosova i jep më tepër rëndësi marrëdhënieve të saj me Shqipërinë, dhe njëri nga dokumentet e saj të politikës së jashtme e thotë që “[b]ashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë e zë një vend të veçantë në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës”¹⁰. Ngjashëm, pos zhvillimit të marrëdhënieve dhe komunikimeve të mira me respektim të ndërsjellë me të gjithë fqinjët, Mali i Zi ia jep “një rëndësi të veçantë [...] marrëdhënieve me Serbinë, që detyron marrëdhënie të partneritetit të barabartë dhe të respektimit të ndërsjellë”.¹¹ Në politikën e vet rajonale, Shqipëria po ashtu i kushton më tepër vëmendje çështjeve specifike në raport me vendet e veçanta fqinje. Për shembull, Shqipëria synon ta luaj një rol aktiv për paqen dhe sigurinë rajonale duke e përkrahur “procesin e zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës,” dhe, në rastin e Maqedonisë, duke “e përkrahur Marrëveshjen e Ohrit, dhe duke e njohur atë si të vetmen platformë për prosperitetin e Maqedonisë dhe për marrëdhëniet e mira, miqësore dhe fqinjësore midis dy vendeve”.¹²

⁶ “Foreign Policy Aims” [“Synimet e Politikës së Jashtme”], MPJ, Kroaci.

⁷ “Synopsis of the Turkish Foreign Policy” [“Përmbledhje e Politikës së Jashtme të Turqisë”], Ministria e Punëve të Jashtme e Turqisë, qasur më 7 dhjetor, 2013, <http://www.mfa.gov.tr/synopsis-of-the-turkish-foreign-policy.en.mfa>.

⁸ “Foreign Affairs” [“Punët e Jashtme”], Ambasada e Republikës së Bullgarisë në Londër, qasur më 24 dhjetor, 2013, http://www.bulgarianembassy-london.org/index.php?option=com_content&task=view&id=35&Itemid=103.

⁹ “Basic Directions of BiH Foreign Policy” [“Udhëzimet Themelore të Politikës së Jashtme të BH-ës”], Ministria e Punëve të Jashtme e BH-ës, qasur më 5 janar, 2014, http://www.mvp.gov.ba/vanjska_politika_bih/osnovni_pravci_vanjske_politike_bih/?id=2.

¹⁰ “Kosovo Foreign Objectives” [“Qëllimet e Jashtme të Kosovës”], Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, qasur më 25 nëntor, 2013, <http://www.mfa-ks.net/repository/docs/Kosovoforeignobjectives.pdf>.

¹¹ “Foreign Policy” [“Politika e Jashtme”], Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Integritimit Evropian e Malit të Zi, qasur më 11 janar, 2014, <http://www.mvpei.gov.me/en/ministry/Foreign-Policy/>.

¹² “Misioni i MPJ”, Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë, qasur më 14 tetor, 2013, http://www.mfa.gov.al/index.php?option=com_multicategories&view=article&id=5391:misioni-i-ministrise-se-puneve-te-jashtme&Itemid=64&lang=en.

Në marrëdhëniet e veta bilaterale me BH-ën, Serbia i jep po ashtu më tepër rëndësi forcimit të marrëdhënieve të veta me Banja Llukën, se me Sarajevën, dhe Republika Serbe (RS) si kryeqytet të vetin e merr më tepër Beogradin se Sarajevën. Ngjashëm, serbët në Kosovë, tash edhe me ardhjen e pritur të Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë, si kryeqytet të tyre do ta shikojnë më tepër Beogradin se Prishtinën. Kështu që, në tërësi, shtetet e rajonit, dhe në veçanti ato që ende janë të lëna jashtë strukturave euroatlantike, vazhdojnë të ndjekin politika të jashtme të mbështetura etnikisht, e cila, deri në një masë, e kërcënon pikërisht sigurinë dhe stabilitetin rajonal që shtetet e tjera fqinje përpiqen ta arrijnë.

1.2 Marrëdhëniet dhe kontaktet bilaterale

Kur Kosova vihet në kontekstin bilateral me shtetet e tjera të rajonit, cilësia dhe intensiteti i marrëdhënieve të saj me çdonjërin vend në rajon janë të ndryshme. Nga aspekti i cilësisë së marrëdhënieve, Shqipëria dhe Turqia janë të vetmet vende në rajon me të cilat Kosova ka marrëdhënie të shkëlqyera, ndërkohë që kjo ruan marrëdhënie shumë intensive me Shqipërinë dhe intensive me Turqinë. Cilësia e shkëlqyer e marrëdhënieve midis Kosovës dhe këtyre dy shteteve përftohet nga fakti që, edhe Shqipëria, edhe Turqia, Kosovën e kanë njohur menjëherë, një ditë pasi që kjo e shpalli pavarësinë e vet, ndërkohë që marrëdhëniet diplomatike u vendosën në ditën e njohjes, për dallim nga disa shtete të tjera të rajonit që i kanë shtyrë këto dy aspekte fundamentale në zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale. Po ashtu, Turqia dhe Shqipëria tashmë kishin patur prani diplomatike përmes Zyrave të tyre Ndërlidhëse, madje edhe para se Kosova ta shpallte pavarësinë e vet, dhe këto e kishin ngritur statusin e tyre diplomatik në Ambasadë, dhe i kishin emëruar ambasadorët shumë më heret se shtetet e tjera të rajonit.

Pos kësaj, ajo që i kontribuon marrëdhënieve të shkëlqyera bilaterale midis Kosovës dhe këtyre dy shteteve, është numri i marrëveshjeve që këto kanë nënshkruar me Kosovën; Shqipëria renditet e para ndër fqinjët e saj dhe e dyta në rajon me 17 marrëveshje të nënshkruara me Kosovën në total, ndërkohë që Turqia renditet e para në rajon, ku numri total i marrëveshjeve që i ka nënshkruar me Kosovën është 21.¹³ Pos kësaj, për dallim nga shumica e shteteve në rajon, as Shqipëria, dhe as Turqia, nuk kanë zbatuar asnjë herë pengesa për lëvizjen e qytetarëve të Kosovës. Ajo që po ashtu i ka kontribuar marrëdhënieve të shkëlqyera midis Kosovës dhe Shqipërisë, dhe midis Kosovës dhe Turqisë, janë investimet që këto dy shtete i kanë bërë në Kosovë, të cilat janë ndër më të lartat në rajon. Midis viteve 2008-2012, Shqipëria ka qenë investitori i tretë më i madh në Kosovë, me investime totale mesatare vjetore prej më tepër se 16.2 milionë €¹⁴, ndërkohë që Turqia ka qenë investitori i dytë më i madh në Kosovë, pas Sllovenisë, me investime totale mesatare vjetore prej më tepër se 28.6 milionë €.¹⁵

Sa i përket intensitetit të marrëdhënieve, në rastin e marrëdhënieve bilaterale të Kosovës me Shqipërinë, intensiteti i aktiviteteve politike i ka kontribuar më tepër se aktiviteti ekonomik asaj që këto dy shtete të kenë marrëdhënie shumë intensive me njëri-tjetrin. Nga ana tjetër, në rastin e

¹³ Meqë kjo është vetëm një përmbledhje e studimit, të gjitha burimet janë të dhëna në pjesën e mëtejme të analizës.

¹⁴ Shpend Kursani, "Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations" ["Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare"], KIPRED, No. 3/13, korrik, 2013, 59-61.

¹⁵ "Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations" ["Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare"], 59-61.

marrëdhënieve bilaterale të Kosovës me Turqinë, intensiteti i aktiviteteve ekonomike i ka kontribuar më tepër se aktiviteti politik asaj që këto dy shtete të kenë marrëdhënie *intensive* me njëri-tjetrin. Këtu ia vlen të përmendet ajo që Shqipëria dhe Turqia janë të vetmet vende në rajon që marrëdhëniet e tyre bilaterale me Kosovën, i kanë mbajtur dhe vazhdojnë t'i mbajnë, në një masë të madhe, nëse jo edhe në tërësi, të pakushtëzuara.



Maqedonia dhe Mali i Zi, nga ana tjetër, janë vende të tjera fqinje me të cilat Kosova ka marrëdhënie bilaterale *shumë të mira* dhe *jo të këqija* respektivisht, mirëpo, të cilat, në të njëjtën kohë, marrëdhëniet e tyre me Kosovën i kanë mbajtur mjaft të kushtëzuara kur krahasohen me Shqipërinë dhe me Turqinë. Maqedonia dhe Mali i Zi janë dy vendet e fundit të rajonit që e kanë njohur Kosovën, dhe, për dallim nga shtetet e tjera të rajonit që Kosovën e kanë njohur, ose menjëherë, ose brenda dy muajve të parë, Maqedonia dhe Mali i Zi njohjet e tyre i kanë bërë vetëm 8 muaj pasi që Kosova e shpalli pavarësinë. Edhe Maqedonia, edhe Mali i Zi, i shtynë njohjet e tyre meqë frikoheshin se mos i prishnin marrëdhëniet e tyre me Serbinë, dhe posaçërisht ndërvarësinë e ndërsjellë ekonomike. Për këtë arsye, u desht që disa nga fuqitë perëndimore, përfshirë këtu edhe shtetet kyçe anëtare të UE-së dhe të NATO-s, të zbatojnë paksa trysni, duke i joshur ato me proces më të shpejtë të hyrjes, ashtu që t'i nxisin për të lëvizur me njohjet e tyre. Komuniteti shqiptar në Maqedoni e luajti, po ashtu, një rol të rëndësishëm, dhe siguria e stabiliteti rajonal janë marrë parasysh gjatë tërë procesit. Për dallim nga Turqia dhe Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi kanë ndërtuar marrëdhënie të kushtëzuara bilaterale me Kosovën. Për shembull, Mali i Zi nuk ka dashur ta ngritë përfaqësimin e vet diplomatik përpos nëse Kosova e ngrit statusin e malazezëve të Kosovës në një komunitet kushtetues – i barabartë me të drejtat kushtetuese që i gëzojnë komunitetet e tjera në Kosovë. Ngjashëm, Maqedonia nuk ka dashur të vendosë marrëdhënie diplomatike, përderisa Kosova të mos pajtohet me demarkacionin e kufirit, e kështu me radhë.

Ajo që i kontribuon më së shumti asaj që Maqedonia të ketë marrëdhënie bilaterale *shumë të mira*, në krahasim me Malin e Zi që me Kosovën ka marrëdhënie bilaterale *jo të këqia*, është numri i marrëveshjeve që çdonjëri nga këto dy shtete i ka nënshkruar me Kosovën. Maqedonia renditet e treta në mesin e vendeve të rajonit për nga numri i marrëveshjeve të nënshkruara me Kosovën, që janë 16 në total, ndërkohë që Mali i Zi, sa i përket numrit të marrëveshjeve të nënshkruara me Kosovën renditet i teti në rajon, apo i fundit në mesin e shteteve që e kanë pranuar atë, dhe ky numër është 3 në total. Maqedonia dhe Mali i Zi kanë patur investime fare modeste në Kosovë, dhe kjo nuk i kontribuon shumë cilësisë së marrëdhënieve midis tyre dhe Kosovës. Sa i përket intensitetit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe këtyre dy shteteve, Kosova ka marrëdhënie që janë *pak intensive* me Maqedoninë, dhe marrëdhënie *jo aktive* me Malin e Zi, gjë kjo që është për t'u habitur duke e patur parasysh që këto dy shtete janë fqinjë të drejtpërdrejtë të Kosovës. Marrëdhëniet pak intensive midis Kosovës dhe Maqedonisë përftohen kryesisht nga aktiviteti ekonomik, në vend se nga aktiviteti politik midis dy shteteve, ndërkohë që me Malin e Zi, si aktiviteti politik, ashtu edhe ai ekonomik, mbeten prapa.

Cilësia e marrëdhënieve midis Kosovës dhe katër shteteve të rajonit që nuk e kanë njohur mbetet *e dobët*, por marrëdhëniet me disa prej tyre janë intensive deri në një masë. Për shembull, krahas asaj që marrëdhëniet me Serbinë janë *të dobëta*, nga njëra anë, këto marrëdhënie mbahen në nivelin *pak intensiv*, nga ana tjetër. Marrëdhëniet midis Kosovës dhe mosnjohësve janë të dobëta për shkak të faktit që Serbia nuk e njeh Kosovën dhe angazhohet në sfidimin aktiv të legjitimitetit ndërkombëtar të saj.



Kosova dhe Serbia nuk janë angazhuar në kurfarë aktivitete bilaterale politike, mirëpo këto kanë ruajtur kontakte tejet intensive në nivelin multilateral. Kështu, për shembull, kryeministrat e të dyja shteteve janë takuar më tepër se 16 herë deri në shtatorin e vitit 2013, dhe që të dyja palët janë angazhuar po ashtu në të gjitha nivelet e tjera qeverisëse me qëllim që t'i koordinojnë aktivitetet që kanë të bëjnë me të gjitha konkludimet/marrëveshjet që janë arritur si pjesë e dialogut të ndihmuar

nga UE-ja që filloi më 8 mars 2011. Si pasojë, ato që i kontribuojnë intensitetit më të lartë të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, nuk janë rezultat i aktivitetit të tyre politik bilateral, por ndodhin në sajë të marrëdhënieve intensive ekonomike midis tyre. Përndryshe, Serbia është partneri i dytë tregtar i Kosovës.

Sa i përket shteteve tjera të rajonit që nuk e kanë njohur Kosovën, që të gjithat e ruajnë qëndrimin e tyre fillestar të mosnjohjes, dhe përkundrajt marrëdhënieve *të dobëta* midis tyre dhe Kosovës, intensiteti i marrëdhënieve është bindës duke e patur parasysh qëndrimin që ato e marrin ndaj Kosovës. Për shembull, ndërkohë që marrëdhëniet me BH dhe Rumaninë janë *joaktive*, njësoj si edhe ato midis Kosovës dhe Malit të Zi, marrëdhëniet e Kosovës me Greqinë janë *pak intensive*. Ky nivel i intensitetit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Greqisë përftohet nga disa aktivitete të dobëta politike midis dy vendeve, dhe një aktiviteti ekonomik që ekziston deri në një masë. Për dallim nga disa mosnjohës të tjerë të rajonit, Greqia ka qenë më e hapur ndaj Kosovës, dhe nuk e ka marrë ndonjë qëndrim izolues, çfarë e kanë marrë BH, dhe fillimisht edhe Serbia, e deri në një masë edhe Rumania. Greqia e kupton që politika rajonale gjithëpërfshirëse, pa e ndryshuar qëndrimin e vet ndaj statusit përfundimtar të Kosovës, i shërben sigurisë dhe stabilitetit rajonal (edhe pse në afat të shkurtër), mirëpo ajo, të paktën, ka qenë e hapur që disa herë t'i presë dhe t'u vijë në vizita një numri të zyrtarëve të lartë të Kosovës. BH dhe Rumania, nga ana tjetër, ndaj Kosovës kanë qenë madje edhe më izoluese se vetë Serbia. BH e shikon Kosovën nga prizmi serb dhe kjo vepron ndaj Kosovës në një mënyrë madje edhe më agresive se vetë Serbia; Republika e saj Serbe (RS) dhe përfaqësuesit serbë në nivelet e ndryshme qeveritarare në BH janë duke i bllokuar palët kur në BH shtrohen çështjet që kanë të bëjnë me Kosovën. Për dallim nga Greqia, Rumania ka qenë më e kujdesshme për të mos u takuar zyrtarisht me çfarëdo zyrtarë të lartë të Kosovës, ashtu që të mos e dërgojë ndonjë mesazh potencial rreth ndonjë njohjeje të nënkuptuar. Serbia, për shembull, nuk zbaton kufizime ndaj lirisë së lëvizjes së qytetarëve të Kosovës, ashtu siç BH këtë e bën ende.¹⁶ Mirëpo, për dallim nga BH, Greqia dhe Rumania i mbajnë Zyrat e tyre Ndërlidhëse që i raportojnë UNMIK-ut, përmes të cilit ato i kryejnë veprimtaritë e tyre diplomatike në Kosovë.

Sa i përket shteteve anëtare të UE-së të rajonit (atyre që e kanë njohur Kosovën), këto, nga aspekti i cilësisë, kanë marrëdhënie *shumë të mira* me Kosovën në rastin e Sllovenisë, dhe marrëdhënie *të mira* në rastet e Bullgarisë dhe të Kroacisë, si dhe marrëdhënie *pak intensive* me të gjitha këto sa i përket intensitetit. Krahasuar me shtetet e tjera në rajon, këto nuk janë në mesin e shteteve që e kanë njohur Kosovën menjëherë; ato e bënë këtë pas muajit të parë të shpalljes së pavarësisë. Marrëdhëniet diplomatike dhe marrëdhëniet në nivelin e ambasadorëve u vendosën pak kohë pas njohjes (jo menjëherë, siç kanë bërë disa shtete të tjera me të cilat Kosova ka marrëdhënie të shkëlqyera), dhe këto, marrë në tërësi, kanë mbajtur përfaqësim diplomatik në nivelin e ambasadorëve që nga koha kur i kanë emëruar ambasadorët e tyre të parë në Kosovë. Po ashtu, nga aspekti i numrit të marrëveshjeve, Kosova ka nënshkruar midis 5 dhe 10 marrëveshje me çdonjërin nga këto shtete anëtare të UE-së të rajonit që e kanë njohur atë. Ajo që i parandalon këto shtete më së shumti nga të paturit e marrëdhënieve *të shkëlqyera* me Kosovën, edhe pse ky nuk është aspekti i vetëm lidhur me këtë, janë pengesat që këto shtete anëtare të UE-së i zbatojnë për qytetarët e Kosovës. Duke e marrë parasysh që Sllovenia është anëtare e Zonës së Schengenit, dhe që Bullgaria dhe Kroacia duhet t'i zbatojnë rregullat e Schengenit, ato nuk mund të vendosin në mënyrë autonome dhe individuale për


¹⁶ Rumania është anëtare e UE-së që duhet t'u bindet rregullave të Schengenit.

t'i hequr kërkesat për viza për qytetarët e Kosovës. Marrëdhëniet *pak intensive* midis Kosovës dhe vendeve të tjera anëtare të UE-së përftohen, edhe nga aktiviteti politik, edhe nga ai ekonomik, midis shteteve, edhe pse aktiviteti ekonomik e luan një rol paksa më të rëndësishëm në përcaktimin e intensitetit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe këtyre shteteve anëtare të UE-së.

Është po ashtu evidente që në përgjithësi zyrtarët e Kosovës kanë bërë shumë më tepër vizita bilaterale në kryeqytetet e shteteve të rajonit sesa e kundërta. Kjo nuk vlen vetëm për Greqinë, ku zyrtarët e nivelit të lartë të saj Kosovën e kanë vizituar tre herë, ndërkohë që zyrtarët e lartë të Kosovës e kanë vizituar atë vetëm një herë që nga shpallja e pavarësisë, gjë kjo që është e habitshme duke e patur parasysh atë që Greqia nuk e ka njohur Kosovën. Aktiviteti më intensiv politik ka qenë midis Kosovës dhe Shqipërisë, dhe nga të gjitha takimet midis zyrtarëve të nivelit të lartë të Kosovës dhe të shteteve të tjera të rajonit (presidentë, kryeministra dhe ministra të jashtëm), rreth 30% kanë ndodhur midis atyre të Kosovës dhe të Shqipërisë. Pos kësaj, rreth 13% të të tërë aktivitetit politik në rajon ka qenë me Serbinë, ndërkohë që 12% është bërë si me Slloveninë, ashtu si edhe me Kroacinë, dhe 11% me Turqinë. Ngjashëm, pjesa më e madhe e aktivitetit ekonomik bilateral në rajon është zhvilluar midis Kosovës dhe Maqedonisë, Serbisë, Shqipërisë dhe Turqisë. Së fundi, duhet përmendur që, pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Kosovës dhe shteteve të rajonit, Kosovës iu desht më shumë kohë që të themelonte ambasada dhe të emëronte ambasadorë, se që iu desht shteteve të tjera të rajonit – Kosovës iu nevojitën të paktën gjashtë muaj deri në dy vjet shtesë që t'i emëronte ambasadorët e parë pasi që shtetet e rajonit e kishin bërë këtë në Prishtinë.

Së fundi, shumica e shteteve të rajonit ka po ashtu trupa dhe personel si pjesë të pranisë ndërkombëtare të sigurisë (KFOR) dhe të sundimit të ligjit (EULEX) në Kosovë. KFOR-i në datën 19 nëntor 2013 e ka patur një total prej 4,949 trupash,¹⁷ ku 942 trupa, apo 19% e tyre, vijnë nga shtetet e rajonit. Në këto 942 trupa të rajonit, Turqia merr pjesë me 394 trupa, vijuar nga Sllovenia dhe Greqia me 319 dhe 119 trupa respektivisht. EULEX-i e ka një total të personelit ndërkombëtar prej 1,178 vetash¹⁸, në mesin e të cilëve 230, apo 20%, janë nga shtetet e rajonit. Bullgaria merr pjesë me një personel prej 91 vetash, dhe vijohet nga Greqia dhe Rumania me një personel prej 37 vetash çdonjëra. Kështu, përderisa Bullgaria e ka numrin më të vogël të trupave në KFOR në mesin e shteteve të rajonit, kjo ka numrin më të madh të personelit në EULEX.

Prania në misionet ndërkombëtare në Kosovë



¹⁷ "Troop Numbers & Contribution Nations" ["Numri i trupave dhe kombet kontributore"], NATO, qasur më 22 dhjetor, 2013, <http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/troop-numbers-contributions.aspx>.

¹⁸ KIPRED, komunikim përmes e-mailit me zëdhënësin e EULEX-it, 7 nëntor, 2013.

1.3 Shtetet rajonale dhe subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës

Asistenca që Kosova e merr nga shtetet e rajonit në fuqizimin e legjitimitetit të saj ndërkombëtar varet nga qasja e tyre e përgjithshme dhe nga potenciali që ato e kanë për ta asistuar Kosovën lidhur me këtë çështje. Përmasa deri në të cilën disa nga shtetet e rajonit e sfidojnë legjitimitetin ndërkombëtar, varet, po ashtu, nga ajo se a e kanë njohur ato Kosovën, ku kjo varet po ashtu nga politika e tyre rajonale dhe nga lidhjet me Serbinë. Serbia është sfiduesi më i patundur i legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës. Edhe përkundrejt asaj që të dyja palët kanë hyrë në dialog më 8 mars 2011, me mirëbesim dhe me qëllim të përmirësimit të jetës së njerëzve dhe të rritjes së bashkëpunimit, Serbia ende vazhdon, ashtu siç ka vepruar që nga fillimi, ta sfidojë legjitimitetin dhe përfaqësimin ndërkombëtar kudo që të mundet dhe sa herë që t'i nevojitet. Disa muaj pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, më 8 tetor 2008,¹⁹ Serbia e dorëzoi në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (APKB) një rezolutë e cila i thërriste shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara ta përkrahnin Serbinë në kërkesën për vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës. Shqipëria është i vetmi vend në rajon që votoi kundër rezolutës,²⁰ ndërkohë që Bullgaria, Kroacia, Maqedonia dhe Sllovenia abstenuan që të gjithat. Nga ana tjetër, katër shtete të rajonit që e përkrahën kërkesën e Serbisë duke votuar në përkrahje të rezolutës së saj më 8 tetor 2008, ishin Greqia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia. Në një mënyrë ironike, një ditë pasi që Mali i Zi e përkrahu Serbinë në këtë sesion të APKB, ky e njohu Kosovën – me 9 tetor 2008.

Shtetet	Rezoluta e Serbisë për APKB (8 tetor 2008)	GJND (17 prill 2009) deklaratat e shkruara	GJND (24 korrik 2009) deklaratat shitesë	GJND (dhjetor 2009) dëgjimet gojore
Shqipëria	Votoi (kundër)	Po (përkrahje)	Po (përkrahje)	Po (përkrahje)
BHI	Bojkotoi	Jo	Jo	Jo
Bullgaria	Abstenoj	Jo	Jo	Po (përkrahje)
Kroacia	Abstenoj	Jo	Jo	Po (përkrahje)
Greqia	Votoi (në përkrahje)	Jo	Jo	Jo
Kosova	n/a	Po (përkrahje)	n/a	Po (përkrahje)
Maqedonia	Abstenoj	Jo	Jo	Jo
Mali i Zi	Votoi (në përkrahje)	Jo	Jo	Jo
Rumania	Votoi (në përkrahje)	Po (kundër)	Jo	Po (kundër)
Serbia	Votoi (në përkrahje)	Po (kundër)	Po (kundër)	Po (kundër)
Sllovenia	Abstenoj	Po (përkrahje)	Po (përkrahje)	Po (përkrahje)
Turqia	Bojkotoi	Jo	Jo	Jo

Kur kërkesa e Serbisë shkoi në GJND, kjo e caktoi afatin e fundit (17 prill 2009) deri në të cilin palët e interesuara mund t'i dërgonin qëndrimet e tyre të shkruara, dhe një afat tjetër të fundit (24 korrik 2009) deri në të cilin të gjitha palët e interesuara mund të dërgonin komente shitesë, si dhe afatin e fundit përfundimtar (pjesa e parë e dhjetorit 2009), në të cilin palët e interesuara mund të dilnin në seancën dëgjimore të GJND-së dhe t'i paraqesin pikëpamjet e tyre gojarisht. Pos vetë Kosovës, dy shtete të tjera të rajonit (Shqipëria dhe Sllovenia) kanë dorëzuar qëndrime të shkruara deri në afatin e

¹⁹ "Backing request by Serbia, General Assembly decides to seek International Court of Justice ruling on legality of Kosovo's independence" ["Në mbështetje të kërkesës së Serbisë, Asambleja e Përgjithshme vendos ta kërkojë vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës"], Plenari i gjashtëdhjetë e tretë i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, takimi i 22-të, 8 tetor 2008, qasur më 23 janar, 2014, <http://www.un.org/News/Press/docs/2008/ga10764.doc.htm>.

²⁰ Shtetet e Bashkuara ishin i vetmi shtet anëtar i KB që ka votuar kundër kësaj Rezolute.

fundit më 17 prill 2009 në përkrahje të ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Nga ana tjetër, pos Serbisë, ka qenë vetëm Rumania që deri në afatin e fundit më 17 prill 2009 dorëzoi qëndrim të shkruar kundër ligjshmërisë së pavarësisë së Kosovës. Kësisoj, shumica e shteteve të rajonit nuk dorëzuan qëndrime të shkruara. Sllovenia dhe Shqipëria ishin po ashtu të vetmet shtete të rajonit që dorëzuan komente pozitive shtesë deri në afatin e fundit të 24 korrikut 2009, ndërkohë që Serbia ishte i vetmi shtet që dorëzoi komente shtesë para kësaj date në përkrahje të kauzës së vet. Kur u mbajtën dëgjimet publike të dhjetorit 2009, kishte më tepër vende që i paraqitën gojarisht pikëpamjet e veta në favor të Kosovës, dhe këtu ishin të përfshira Shqipëria, Bullgaria, Kroacia dhe Sllovenia, ndërkohë që Rumania ishte i vetmi shtet i rajonit që përsëri e përkrahu Serbinë gjatë dëgjimit publik të dhjetorit 2009 në GJND.

Pos kësaj, shumica e shteteve të rajonit e përkrahën anëtarësinë e Kosovës në FMN dhe në Bankën Botërore, apo, në parim, të gjitha shtetet e rajonit që e kanë njohur Kosovën votuan në favor të anëtarësimit të Kosovës në këta dy trupa ndërkombëtarë. Gjatë sesionit votues për anëtarësinë e Kosovës në FMN që u mbajt më 3 maj 2009, Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Sllovenia dhe Turqia e përkrahën që të gjitha anëtarësimin e Kosovës në FMN, dhe, në fund, Kosova edhe u bë anëtare e këtij Fondi. Greqia dhe Rumania votuan kundër, Serbia e bojkotoi votimin, ndërsa BH abstenoj. Gjatë sesionit votues për anëtarësimin e Kosovës në Bankën Botërore, që u mbajt më 3 qershor 2009, të njëjtat vende që votuan në përkrahje të anëtarësimit të Kosovës në FMN, votuan po ashtu në favor të anëtarësimit të Kosovës në Bankën Botërore. Votat kundër, bojkotimet dhe abstenimet gjatë sesionit për anëtarësimin e Kosovës në Bankën Botërore ishin përsëri identike me ato të sesionit paraprak të mbajtur për rastin e FMN.

Pos përkrahjes së subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës dhe të përfaqësimit të saj në organizatat ndërkombëtare, Shqipëria dhe Turqia janë të vetmet vende në rajon që e luajnë një rol aktiv, i cili zhvillohet pothuaj në baza ditore, në përkrahjen e Kosovës për të fituar më tepër njohje. Përderisa që për Shqipërinë ky është një prioritet, ndikimi i saj në rajon dhe në botë është më i vogël se i Turqisë. Njohjet e Kosovës janë prioritete të Turqisë kur është fjala për politikën e saj rajonale. Duke e patur parasysh vendndodhjen e saj gjeografike, madhësinë e saj, qoftë si ekonomi, qoftë nga aspekti i popullatës, si dhe ndikimin politik që kjo mund ta ushtrojë në disa nga vendet e rajonit të afërt apo më të gjerë, si dhe në disa nga aktorët e tjerë në botë, Turqia e ka shfrytëzuar çdo mundësi për ta ndihmuar Kosovën për të fituar njohje të reja. Turqia ofron përkrahje të pakushtëzuar për Kosovën lidhur me këtë çështje, dhe, nëse është nevojitur, dhe sa herë që është nevojitur, kjo tashmë i ka ofruar Kosovës në një mënyrë të pakushtëzuar, një qasje në të tërë shërbimin e saj diplomatik dhe në pronat e

Shtetet	Anëtarësimi i Kosovës në FMN (3 maj 2009)	Anëtarësimi i Kosovës në Bankën Botërore (3 qershor 2009)
Shqipëria	Votoi (në përkrahje)	Votoi (në përkrahje)
BH	Abstenoj	Abstenoj
Bullgaria	Votoi (në përkrahje)	Votoi (në përkrahje)
Kroacia	Votoi (në përkrahje)	Votoi (në përkrahje)
Greqia	Votoi (kundër)	Votoi (kundër)
Kosova	n/a	n/a
Maqedonia	Votoi (në përkrahje)	Votoi (në përkrahje)
Mali i Zi	Votoi (në përkrahje)	Votoi (në përkrahje)
Rumania	Votoi (kundër)	Votoi (kundër)
Serbia	Bojkotoi	Bojkotoi
Sllovenia	Votoi (në përkrahje)	Votoi (në përkrahje)
Turqia	Votoi (në përkrahje)	Votoi (në përkrahje)

saj anembanë botës.²¹ Edhe përkundrejt faktit që disa shtete të rajonit e kanë njohur Kosovën, ato, në fakt, janë përpjekur ta sfidojnë legjitimitetin e saj rajonal dhe ndërkombëtar – veprime si këto nisur nga disa këto vende që kanë marrëdhënie më të mira me Serbinë, gjë kjo të cilën ky studim e shqyrton më në hollësi në vijim.

Së fundi, në dialogun e ndihmuar nga UE-ja midis Kosovës dhe Serbisë, të dyja palët kanë hyrë pjesërisht për shkak të qëllimit të përbashkët (d.m.th. të integritimit në UE në të ardhmen), dhe pjesërisht për përfundime të ndryshme që i presin (d.m.th., Kosova, nga njëra anë, dëshiron ta rrisë legjitimitetin e saj ndërkombëtar, duke e shfrytëzuar dialogun si një shembull të një aktori ndërkombëtar të përgjegjshëm, ndërkohë që Serbia, nga ana tjetër, dialogut i ka hyrë për ta sfiduar vetë legjitimitetin ndërkombëtar që Kosova përpiqet ta arrijë, apo që, mundësisht, t'i shtyjë fitimet e saj). Megjithatë, ia vlen të përmendet që të gjitha shtetet e rajonit e përkrahin dialogun, nëse jo për asgjë tjetër, atëherë të paktën meqë ky e ofron sigurinë dhe stabilitetin, të cilin, të paktën në afat të shkurtër, të gjitha shtetet e rajonit e dëshirojnë. Kosova nuk e ka marrë ndonjë përkrahje të hapur në dialog nga cilido shtet i rajonit që e përkrah atë në këtë proces. Kosovës nuk i është dhënë kurrfarë këshille strategjike apo ndonjë përkrahje alternative kur kjo, e shtyrë për muri, u detyrua ta negociojë rregullimin e vet të brendshëm me Serbinë, diçka kjo me të cilën shumica e shteteve të rajonit nuk pajtoheshin para se dialogu me Serbinë të fillonte, duke e kthyer kështu përkrahjen e tyre më tepër në një përkrahje retorike. Pavarësisht nga ajo se a është duke e sfiduar apo jo dialogu funksionimin e brendshëm të Kosovës, një rrezik ky të cilin rajoni dhe UE-ja mund të jenë duke e marrë, duke e krijuar një BH të re në Ballkan, Ambasadori i Turqisë në Kosovë i ka përmbledhur shpresat e bashkësisë ndërkombëtare që “UE-ja nuk mund t’ia lejojë vetes krijimin e një BH të re në rajon, dhe të një Qiproje të re në UE”;²² megjithatë, kjo nuk është shumë më tepër se shpresë.

1.4 Metodologjia

Ky punim shfrytëzon metoda të ndryshme për ta vlerësuar pozitën e Kosovës në rajon në përgjithësi, dhe marrëdhëniet e saj bilaterale me çdonjërin nga shtetet e rajonit në veçanti. Janë dy aspekte fundamentale që ky punim i vrojton kur i analizon marrëdhëniet bilaterale të Kosovës me shtetet e rajonit. I pari është cilësia e marrëdhënieve e cila vlerësohet duke i shqyrtuar aspektet në vijim:

1. **Vendosja e marrëdhënieve bilaterale** – kryesisht ajo se kur shteti X i rajonit i ka vendosur marrëdhëniet diplomatike me Kosovën?
2. **Përfaqësimi i shtetit X të rajonit në Kosovë** – kryesisht ajo nëse shteti X e ka themeluar, qoftë zyren ndërlidhëse, qoftë ambasadën në Kosovë, dhe kur ka ndodhur kjo?
3. **Përfaqësimi i Kosovës në shtetin X të rajonit** – kryesisht ajo nëse Kosova e ka themeluar, qoftë zyren ndërlidhëse, qoftë ambasadën, në shtetin X të rajonit, dhe kur ka ndodhur kjo?
4. **Vendosja e marrëdhënieve në nivel ambasadorësh** – kryesisht ajo se kur janë vendosur marrëdhëniet me shtetin X në nivel ambasadorësh?
5. **Njohja** – kryesisht ajo se kur shteti X i rajonit e ka njohur Kosovën?

²¹ Zyrtar i lartë politik turk, intervistë në Prishtinë, 7 tetor, 2013.

²² Zyrtar i lartë politik turk, intervistë në Prishtinë, 7 tetor, 2013.

6. **Numri i marrëveshjeve** – kryesisht ajo se sa marrëveshje bilaterale i ka nënshkruar Kosova me shtetin X të rajonit?
7. **Liria e lëvizjes për qytetarët e Kosovës** – kryesisht ajo se a u lejon shteti X i rajonit qytetarëve të Kosovës të lëvizin lirë (pa viza), dhe kur ka ndodhur kjo?
8. **Investimet e shtetit X të rajonit** – kryesisht ajo se sa ka investuar shteti X i rajonit në Kosovë në vjet në periudhën midis viteve 2008 dhe 2012?

Këto aspekte fundamentale janë vënë përballë kriterëve të treguara në tabelën në vijim për çdonjërin dhe të gjitha shtetet e rajonit, të cilat, kur të merren së bashku dhe pjestohen me numrin e aspekteve në shqyrtim, e japin cilësinë e marrëdhënieve bilaterale midis Kosovës dhe çdonjërit shtet në rajon:

Matrica e vlerësimit për cilësinë e marrëdhënieve midis Kosovës dhe shteteve të tjera të rajonit								
Pikë	Vendosja e marrëdhënieve diplomatike	Vendosja e marrëdhënieve në nivel ambasadorësh	Përfaqësimi në Kosovë	Përfaqësimi në vendin x	Njohja	Nr. i marrëveshjeve	Lejimi i lirisë së lëvizjes për qytetarët e R.K.	Investimet (në miliona €)
4	2008	2008	Ambasadë (mbi 4 vjet)	Ambasadë (mbi 4 vjet)	brenda 1 muaji	Më tepër se 15	2008-2009	mbi 25
3	2009	2009	Ambasadë (2-4 vjet)	Ambasadë (2-4 vjet)	brenda 6 muajsh	10-15	2010	15-24
2	2010	2010	Ambasadë (nën 2 vjet)	Ambasadë (nën 2 vjet)	brenda 12 muajsh	5-9	2011	5-14
1	2011	2011	Zyrë	Zyrë	brenda 24 muajsh	1-4	2012	2-4
0	pa marrëdh. dip	jo	Nuk ka Zyrë	Nuk ka Zyrë	Nuk është njohur	Nuk ka marrëveshje	Mohohet	nën 2

Kështu, cilësia e marrëdhënieve përcaktohet varësisht nga rezultati mesatar që i merr çdo shtet në rajon pasi të mbledhen pikët për çdonjërin aspekt fundamental dhe ato pjestohen me numrin e tërë të aspekteve në shqyrtim, bazuar nga renditjet në tabelën në vijim. Kështu, nëse marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe një shteti të caktuar të rajonit e marrin një rezultat mesatar prej 3.6, bazuar në aspektet e mësipërme, atëherë këto marrëdhënie përcaktohen si *të shkëlqyera*. Ngjashëm, nëse marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe një shteti të caktuar të rajonit e marrin rezultatin mesatar prej 1.5, bazuar në aspektet e mësipërme, atëherë këto marrëdhënie përcaktohen si *jo të këqija*, dhe kështu me radhë. Lidhur me këtë çështje, për rezultatet e hollësishme të çdo shteti shih Aneksin 2.

Pikë	Cilësia e marrëdhënieve
3.6-4.0	E shkëlqyer
3.1- 3.5	Shumë e mirë
2.1-3.0	E mirë
1.1-2.0	Jo e keqe
0.0-1.0	E dobët

Së dyti, e kemi intensitetin e marrëdhënieve që vlerësohet duke i hetuar aspektet fundamentale në vijim:

1. **Vizitat/takimet në nivel presidentësh** – kryesisht numri i vizitave/takimeve bilaterale²³ që janë bërë midis Presidentit(-ëve) të Kosovës dhe Presidentit(-ëve) të vendit X të rajonit.
2. **Vizitat/takimet në nivel kryeministrash** – kryesisht numri i vizitave/takimeve bilaterale që janë bërë midis Kryeministrit(-ave) të Kosovës dhe Kryeministrit(-ave) të shtetit X të rajonit.
3. **Vizitat/takimet në nivel të ministrave të jashtëm** – kryesisht numri i vizitave/takimeve që janë bërë midis Ministrit(-ave) të Jashtëm të Kosovës dhe Ministrit(-ave) të Jashtëm të shtetit X në rajon.
4. **Vëllimi i tregtisë** – kryesisht vëllimi i shkëmbimit tregtar midis Kosovës dhe shtetit X në rajon.

Ngjashëm me metodën e shfrytëzuar për ta vlerësuar cilësinë e marrëdhënieve, këto aspekte fundamentale të intensitetit të marrëdhënieve bilaterale janë të vëna përballë kriterëve të treguara në tabelën në vijim për çdonjërin dhe të gjitha shtetet në rajon, të cilat, kur të mirren si shumë dhe pjestohen me numrin e aspekteve të shqyrtuara, e japin intensitetin e marrëdhënieve bilaterale midis Kosovës dhe çdonjërit shtet të rajonit:

Matrica e vlerësimit të intensitetit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe shteteve të tjera të rajonit				
Pikë	Vizitat/takimet Presidenciale	Vizitat/takimet Kryeministrorë	Vizitat/takimet e Ministrave të Jashtëm	Vëllimi i tregtisë (në miliona €)
4	mbi 10	mbi 10	mbi 10	mbi 200
3	7-9	7-9	7-9	100-199
2	4-6	4-6	4-6	50-99
1	1-3	1-3	1-3	20-49
0	Pa vizita	Pa vizita	Pa vizita	nën 20

Kësisoj, intensiteti i marrëdhënieve përcaktohet varësisht nga rezultati mesatar që çdonjëri vend e merr pasi të mblidhen pikat për çdonjërin element dhe këto pjestohen me numrin e tërë të aspekteve, bazuar në rendet e treguara në tabelën në vijim. Kjo, për shembull, do të thotë që nëse marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe një vendi të caktuar të rajonit e marrin rezultatin mesatar prej 3.5 bazuar në aspektet e mësipërme, atëherë këto marrëdhënie përcaktohen si *shumë intensive*. Ngjashëm, nëse marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe një shteti të caktuar të rajonit e marrin rezultatin mesatar prej 1.5 bazuar në elementet e mësipërme, atëherë këto marrëdhënie përcaktohen si *pak intensive*, dhe kështu me radhë. Lidhur me këtë çështje, për rezultatet e hollësishme për çdonjërin prej shteteve shih Aneksin 3.

²³ Shënim: Gjatë analizimit të marrëdhënieve me Serbinë, për qëllime analitike, vizitat që janë bërë midis dy shteteve në Bruksel nuk janë marrë parasysh.

Pikë	Intensiteti i marrëdhënieve
3.1-4.0	Shumë Intensive
2.1-3.0	Intensive
1.0-2.0	Pak Intensive
0.0-0.9	Joaktive

Kjo metodologji shfrytëzohet së pari meqë elementet vijuese, kur të mirren bashkë, e ofrojnë një pamje të përafërt të asaj se si qëndrojnë marrëdhëniet bilaterale të Kosovës me çdonjërin nga vendet e rajonit. Kjo po ashtu mundëson të krahasohen cilësia dhe intensiteti i marrëdhënieve bilaterale të Kosovës me vendet e rajonit. Kësajsoj, matricat që janë shfrytëzuar si pjesë e kësaj metodologjie, nuk janë vetëm për qëllimet e analizimit të marrëdhënieve të Kosovës me rajonin, dhe kjo nuk e paragjykon cilësinë apo intensitetin e marrëdhënieve bilaterale të Kosovës për shtetet që janë jashtë rajonit që shqyrtohet në këtë studim.

Pos përcaktimit të *cilësisë* dhe *intensitetit* të marrëdhënieve midis Kosovës dhe çdonjërit shtet të rajonit, në një analizë që është e bazuar më kuantitativisht, me qëllim të përkrahjes së themeleve kuantitative të analizës, janë marrë parasysh, po ashtu, edhe aspekte të tjera nga këndvështrimi cilësor, të tilla si: prania e trupave dhe e personelit të misioneve ndërkombëtare në Kosovë, të tilla si KFOR-i dhe EULEX-i, nga shtetet e rajonit; diskutimi rreth çfarëdo çështjesh të hapura; diskutimi rreth mospajtimeve më komplekse; dhënia e asistencës në forumet rajonale dhe ndërkombëtare; pozita e Kosovës në politikat e jashtme dhe rajonale të vendeve të rajonit; deklaratat, e kështu me radhë.

Burimet kryesore të shfrytëzuara si pjesë e kësaj metodologjie janë: raportet e vendeve, marrëveshjet bilaterale, dokumentet zyrtare, intervistat, të dhënat e publikuara nga zyrat dhe institucionet relevante. Burimet primare të informatave për vizitat shtetërore dhe për vizitat dhe takimet e tjera zyrtare dhe jozyrtare të zyrtarëve të Kosovës me homologët e tyre në rajon, janë uebsajtat zyrtarë të Zyrave të Presidentëve (ZP), të Zyrave të Kryeministrave (ZK), dhe të Ministrive të Punëve të Jashtme (MPJ). Të gjitha këto institucione i botojnë rregullisht vizitat dhe takimet që zyrtarët e tyre të lartë i kanë, si në Kosovë, ashtu edhe jashtë saj.²⁴ Periudha e vizitave dhe e takimeve që i shqyrton ky punim i përfshin më tepër se pesë vite e gjysmë, d.m.th. nga 17 shkurti 2008 deri më 30 shtator 2013. Duhet theksuar që MPJ filloi t'i regjistrojë takimet dhe vizitat e veta në uebsajtin e saj, vetëm nga data 9 maj 2008, meqë kjo nuk ishte e themeluar me Shpalljen e Pavarësisë së 17 shkurtit 2008.

Vërejtje paraprake për metodologjinë:

- **Kufizimet:** Kur cilësia e marrëdhënieve përcaktohet midis *e shkëlqyer* dhe *e dobët*, ndërsa intensiteti i marrëdhënieve midis *shumë intensive* dhe *joaktive*, kjo nuk don të thotë që kjo është po ashtu e njëjtë me perceptimin e zyrtarëve shtetërorë të të dyja palëve. Për shembull, në disa nga intervistat me ambasadorët e disa prej vendeve rajonale të pranishëm në Kosovë, ata marrëdhëniet e shteteve të tyre me Kosovën i kanë përcaktuar si *të shkëlqyera* dhe *shumë intensive*, ku, nga ana tjetër, sipas metodologjisë që e shfrytëzon ky studim, ato dalin *shumë të mira* dhe *mesatarisht intensive*. Sa i përket kësaj, metodologjia e shfrytëzuar në përcaktimin e

²⁴ Zyra e Protokolit në Ministrinë e Punëve të Jashtme nuk i është përgjigjur kërkesës së KIPRED-it për ta marrë këtë informatë nga organi që, sipas ligjit përkatës, duhet ta ketë atë.

cilësisë dhe intensitetit të marrëdhënieve është e vlefshme vetëm nga këndvështrimi krahasues dhe vetëm në kontekstin e rajonit që e shqyrton ky studim.

- Burimet: Është marrë vërejtja që numri i vizitave dhe i takimeve të botuara në uebsajtet e Zyrave të Presidentëve (ZP), të Zyrave të Kryeministrave (ZKM) dhe të Zyrave të Ministrave të Punëve të Jashtme (MPJ) mund të mos jetë i kompletuar; megjithatë, duke marrë parasysh që kjo analizë e përfshin një periudhë më të gjatë se pesë vjet e gjysmë, informatat e shfrytëzuara nga këto uebsajte e ofrojnë një pamje realiste të trendeve dhe të krahasimeve midis vendeve. Në rastet kur ndonjë vizitë apo takim është gjetur përmes ndonjë metode tjetër hulumtuese, këto janë shqyrtuar dhe marrë parasysh po ashtu, mirëpo këto metoda shtesë e paraqesin vetëm një pjesë të vogël të informatës së tërë që është fituar përmes metodës fillestare – uebsajtet e ZP-ve, të ZKM-ve dhe të MPJ-ve.
- Periudha: Edhe pse ky punim e analizon periudhën që përfundon më 30 shtator 2013, në disa raste relevante, që janë të rëndësishme për mbushjen e ndonjë boshllëku të analizës, ky shfrytëzon informata edhe për periudhën më të fundit.

2 KOSOVA DHE SHTETET FQINJE

2.1 Politikat e jashtme dhe rajonale

Politikat dhe qëllimet e jashtme dhe rajonale të që të katër shteteve fqinje të Kosovës (Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë) kanë më tepër gjëra të përbashkëta se të kundërta; megjithatë, disa dallime mbeten. Ndër politikat dhe pikëpamjet që këto i kanë të përbashkëta është përqendrimi i tyre në promovimin dhe forcimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, megjithëse, nga politikat e tyre të jashtme dhe rajonale është e qartë që këta parametra mbeten të ndërlidhur ngushtë, dhe janë më tepër një ndërmarrje më reaksionare ndaj projekteve të integritit euroatlantik dhe të kushteve shoqëruese të tyre.

Pos politikës së tyre të “marrëdhënieve të mira fqinjësore” që fqinjët e Kosovës e kanë të përbashkët, shumica e tyre i japin një rëndësi dhe vëmendje shtesë ndonjë shteti të veçantë fqinj me të cilin mund ta kenë të përbashkët, qoftë identitetin kulturor, qoftë të kaluarën historike, apo prapaskenën, dhe për këtë arsye tentojnë që me të të mbajnë marrëdhënie të veçanta bilaterale krahasuar me shtetet e tjera fqinje. Për shembull, pos deklarimit që politika e saj e jashtme është të zhvillojë “marrëdhënie të mira me shtetet fqinje”, Kosova i jep rëndësi më të madhe marrëdhënieve të veta me Shqipërinë, duke e patur njërin nga dokumentet e veta të politikës së jashtme që thotë se “[b]ashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë e merr një vend të veçantë në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës”²⁵. Ngjashëm, pos zhvillimit të marrëdhënieve dhe të komunikimeve të mira me respekt të ndërsjellë me të gjithë fqinjët e vet, Mali i Zi ia bashkangjet “një rëndësi të veçantë [...] marrëdhënieve me Serbinë, që detyron marrëdhënie të partneritetit të barabartë dhe të respektimit të ndërsjellë”²⁶. Në politikën e vet rajonale, Shqipëria po ashtu i jep më tepër vëmendje çështjeve të veçanta në raport me shtetet fqinje të veçanta. Për shembull, Shqipëria synon ta luaj një rol aktiv për paqen dhe sigurinë rajonale duke e përkrahur “procesin e zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës”, dhe, në rastin e Maqedonisë, duke “e përkrahur Marrëveshjen e Ohrit, të cilin e njeh si të vetmen platformë për përparimin e Maqedonisë dhe të marrëdhënieve të mira, miqësore dhe fqinjësore midis dy vendeve”²⁷.

Fqinjët e Kosovës kanë të përbashkëta po ashtu edhe qëllime të tjera të politikës së jashtme. Integrimi në UE mbetet një qëllim kryesor dhe interes strategjik për të gjithë fqinjët e Kosovës në të ardhmen e menjëhershme njësoj si dhe në afat më të gjatë. Mirëpo, fqinjët e Kosovës përballen me sfida të ndryshme për arritjen e këtij synimi. Për shembull, për ta arritur qëllimin e përparimit drejt pranimit në UE, Shqipëria përqendrohet në ofrimin e “përkrahjes serioze për zhdukjen e krimit të organizuar dhe të trafikimit të paligjshëm, për çrrënjosjen e korrupsionit”, e kështu me radhë.²⁸ Maqedonia, nga ana tjetër, përballlet me pengesa që janë të një natyre pothuaj në tërësi të ndryshme nga ato me të cilat përballlet Shqipëria. Për më tepër, ndërkohë që Maqedonia është e përkushtuar ndaj projektit të hyrjes dhe të integritit të saj në UE, Greqia konsiderohet të jetë një pengesë në këtë proces meqë kjo e kushtëzon përparimin e saj, jo vetëm kah UE-ja, por, po ashtu, edhe kah NATO-

²⁵ “Kosovo Foreign Objectives” [“Qëllimet e jashtme të Kosovës”], Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, qasur më 26 tetor, 2013, <http://www.mfa-ks.net/repository/docs/Kosovoforeignobjectives.pdf>.

²⁶ “Foreign Policy” [“Politika e Jashtme”], MPJ, Mali i Zi.

²⁷ “Misioni i MPJ”, MPJ, Shqipëri.

²⁸ “Misioni i MPJ”, MPJ, Shqipëri.

ja, me modifikimin e emrit të saj të tashëm kushtetues, të cilin me sa duket Maqedonia nuk mund ta mbajë. Prandaj, zgjidhja e këtyre çështjeve të hapura me Greqinë është një qëllim tjetër kyç për politikën e jashtme dhe rajonale të Maqedonisë. Mali i Zi dhe Serbia integrimin në UE e mbajnë, po ashtu, si një prioritet të lartë; megjithatë, Serbia ende e ruan politikën “edhe UE-ja, edhe Kosova”²⁹ kur fjala është për trajtimin e qëllimit të saj për integrimin në UE dhe për kushtëzimin për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën dhe për ruajtjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore, nga njëra anë, dhe për mbrojtjen e sovranitetit dhe të integritetit territorial të saj, nga ana tjetër.³⁰

Një qëllim shtesë i politikës së jashtme në të cilin Serbia dallon, jo vetëm në krahasim me shtetet fqinje, por, po ashtu, edhe me shtetet e tjera të rajonit, është përkushtimi i saj ndaj NATO-s. Shqipëria tashmë është bërë anëtare e Aleancës, në prillin e vitit 2009,³¹ dhe Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova e kanë shprehur hapur qëllimin e tyre për t’iu bashkangjitur Aleancës – diçka që ato e mbajnë pranë përpjekjeve të tyre për t’iu bashkangjitur UE-së. Edhe pse Serbia, krahas Maqedonisë dhe Malit të Zi është një nga nënshkrueset e programit Partneriteti për Paqe (PpP) të NATO-s, kjo është deklaruar për ta mbajtur neutralitetin ushtarak.³² Çështja e Kosovës është edhe një herë faktor që e ka shtyrë Serbinë për ta mbajtur neutralitetin, posaçërisht ndaj NATO-s, i cili është shpallur më 2007, ndërkohë që i referohej “bombardimit të paligjshëm të Serbisë pa vendim të Këshillit të Sigurimit” nga ana e NATO-s, dhe “planit të refuzuar të Ahtisaarit i cili e përcakton që NATO-ja është ‘autoriteti final mbikëqyrës’ në ‘Kosovën e pavarur’”.³³ Veças Serbisë, anëtarësimi i plotë në NATO mbetet prioritet i politikës së jashtme të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Kosovës, dhe atë si qëllim në afat të shkurtër – para hyrjes në UE. Mali i Zi, për shembull, beson që “integrimi në NATO do ta përshpejtojë integrimin në UE”, dhe që integrimi në NATO është “i ndërlikuar ngushtë me integrimin e Malit të Zi në UE, meqë këto janë dy procese paralele dhe të përputhshme”.³⁴

Kur fjala vjen për shtetet partnere, apo marrëdhëniet bilaterale që e bartin një peshë të rëndësishme për çdonjërin nga shtetet fqinje të Kosovës, ato që të gjithat u japin prioritet marrëdhënieve bilaterale duke u bazuar në interesat e çdo shteti veçmas. Për shembull, të gjitha shtetet fqinje të Kosovës i konsiderojnë marrëdhëniet me SHBA-të si të veçanta dhe të një prioriteti të lartë strategjik. Për Shqipërinë, SHBA-të janë “aleat i pazëvendësueshëm i demokracisë së re shqiptare”.³⁵ Maqedonia është po ashtu e përkushtuar ndaj “forcimit të vazhdueshëm të strategjive të veta të partneritetit me SHBA-të”.³⁶ Mali i Zi dhe Serbia po ashtu i japin prioritet forcimit të mëtejme të marrëdhënieve me

²⁹ Milan Milenkovic, “Is there a change in Serbian foreign Policy” [“A ka ndryshuar politika e jashtme e Serbisë”], <http://www.transconflict.com/2013/02/is-there-a-change-in-serbian-foreign-policy-102/>

³⁰ “Security Issues” [“Çështjet e sigurisë”], Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë, qasur më 14 janar, 2014, <http://www.mfa.gov.rs/en/foreign-policy/security-issues>.

³¹ “Signatures of Partnership of Peace Framework Document” [“Dokumenti i nënshkrimeve të kornizës së Partneritetit për paqe”], NATO, qasur më 4 dhjetor, 2013, http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_82584.htm.

³² “Resolution on protection of sovereignty, territorial integrity and constitutional order of Serbia adopted, report from Government of Serbia” [“Rezoluta për mbrojtjen e sovranitetit, integritetit territorial dhe të rendit kushtetues të Serbisë është përvetësuar, raport nga Qeveria e Serbisë”], 26 dhjetor 2007, qasur më 24 dhjetor, 2013, <http://reliefweb.int/report/serbia/resolution-protection-sovereignty-territorial-integrity-and-constitutional-order>.

³³ “Resolution on protection of sovereignty, territorial integrity and constitutional order of Serbia adopted, report from Government of Serbia” [“Rezoluta për mbrojtjen e sovranitetit, integritetit territorial dhe të rendit kushtetues të Serbisë është përvetësuar, raport nga Qeveria e Serbisë”].

³⁴ “Foreign Policy” [“Politika e Jashtme”], MPJ, Mali i Zi.

³⁵ “Misioni i MPJ”, MPJ, Shqipëri.

³⁶ “Goals and Priorities” [“Qëllimet dhe prioritetet”], Ministria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë, qasur më 14 nëntor, 2013, <http://www.mfa.gov.mk/?q=node/411&language=en-gb>

SHBA-të, mirëpo ato i japin rëndësi të veçantë SHBA-ve po aq sa këtë e bëjnë edhe për partnerët e tyre të tjerë bilateral strategjik, të tillë si “katër shtyllat” e politikës së jashtme të Serbisë, që janë SHBA-të, UE-ja, Rusia dhe Kina.³⁷ Pas zgjedhjeve të përgjithshme në maj 2012, Qeveria e re e Serbisë e ka përfshirë po ashtu edhe Japoninë si interes strategjik për Serbinë, duke e riorganizuar listën e prioriteteve; megjithatë, qëllimet themelore të politikës së jashtme nuk kanë ndryshuar.³⁸ Nga aspekti i marrëdhënieve bilaterale dhe i lidhjeve strategjike, Mali i Zi ka qëllime të ngjashme me Serbinë, dhe, kësaj, përqendrohet në Rusinë dhe në Kinën, pos UE-së, NATO-s dhe SHBA-ve, në kontekstin e rritjes së marrëdhënieve bilaterale me aktorët global. Ajo që është e veçantë për qëllimet bilaterale të Malit të Zi lidhur me rajonin, është që ky i konsideron të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë si fqinje, përfshirë edhe vetë fqinjët e ish-Jugosllavisë, të tillë si Austria, Hungaria, Bullgaria dhe Greqia.³⁹

Sa i përket partnerëve kyç të Shqipërisë në politikën e saj të jashtme, pos procesit të integritimit në UE dhe lidhjeve të forta me SHBA-të, prioriteti i saj është po ashtu t’i mbajë lidhjet e ngushta me shtetet anëtare individuale të UE-së që konsiderohen si prioritete më të larta për Shqipërinë.⁴⁰ Shqipëria u jep prioritet marrëdhënieve të veta bilaterale me Italinë dhe Greqinë, dhe do ta ketë një përqendrim të veçantë në MB, Gjermaninë, Francën, Italinë, dhe Austrinë, me të cilën Shqipëria ka lidhje tradicionale. Pos Austrisë, Shqipëria mban lidhje tradicionale edhe me Turqinë, dhe “do të vazhdojë ta rrisë vullnetin e plotë politik të Shqipërisë për ngritjen e shkëmbimeve në të gjitha fushat”.⁴¹ Shqipëria, për më tepër, synon t’i forcojë dhe pasurojë marrëdhëniet edhe me shtete të tjera të tilla si Kina, Izraeli, Japonia, India, vendet e Lindjes së Afërt, dhe Kanadaja në fushën e tregtisë dhe ekonomisë, si dhe të politikës.⁴²

Është e qartë që janë të shumta politikat e jashtme dhe rajonale që fqinjët e Kosovës i kanë të përbashkëta. Megjithatë, janë disa politika unike të jashtme dhe rajonale që çdonjëri nga këto vende i ruan dhe që kanë të bëjnë me kontekstet, interesat, lidhjet tradicionale e kulturore, e kështu me radhë.

³⁷ Milan Milenkovic, “Is there a change in Serbian foreign Policy” [“A ka ndryshuar politika e jashtme e Serbisë”].

³⁸ Milan Milenkovic, “Is there a change in Serbian foreign Policy” [“A ka ndryshuar politika e jashtme e Serbisë”].

³⁹ “Foreign Policy” [“Politika e Jashtme”], MPJ, Mali i Zi.

⁴⁰ “Misioni i MPJ”, MPJ, Shqipëri.

⁴¹ “Misioni i MPJ”, MPJ, Shqipëri.

⁴² “Misioni i MPJ”, MPJ, Shqipëri.

2.2 Cilësia e marrëdhënieve me shtetet fqinje

2.2.1 Marrëdhëniet bilaterale me SHQIPËRINË

Në mesin e katër shteteve fqinje, Shqipëria është e vetmja me të cilën Kosova ka marrëdhënie bilaterale të shkëlqyera. Në të vërtetë, pos Turqisë, Shqipëria është i vetmi shtet me të cilin Kosova ka marrëdhënie të shkëlqyera. Këto marrëdhënie të shkëlqyera përftohen nga rezultati i tërësishëm që Shqipëria e merr në aspektet fundamentale të marrëdhënieve të veta bilaterale me Kosovën. Së pari, krahasuar me vendet e tjera fqinje, si dhe me ato të tërë rajonit, Shqipëria është një nga vendet e para që e njohën pavarësinë e Kosovës, dhe, në të vërtetë, njohja u depozitua një ditë pas Shpalljes së saj të Pavarësisë, më 18 shkurt, 2008.⁴³ Marrëdhëniet diplomatike u vendosën po ashtu në po atë ditë. Duhet theksuar që Shqipëria e emëroi Ambasadorin e saj të parë në Prishtinë (Islam Llauka) më 11 shkurt 2009,⁴⁴ afër një vit pasi që e njohu Kosovën, dhe, që nga atëherë, kjo e vazhdoi shërbimin e vet të pandërprerë në Prishtinë. Kosova, nga ana tjetër, e ka emëruar Ambasadorin e vet të parë në Tiranë (Gazmend Pulën) pas më tepër se një vjet e gjysmë pas Shpalljes së Pavarësisë. Kosova tashmë e kishte vendosur Z. Pulën si Charge d’Affaires më heret, në tetor 2008.⁴⁵ Për dallim nga përfaqësimi diplomatik i Shqipërisë në Prishtinë, përfaqësimi i Kosovës në nivel ambasadori ishte ndërprerë për më tepër se një vit e gjysmë; pasi që shërbimi i Z. Pulës përfundoi, në gushtin e vitit 2010, Kosova e emëroi Ambasadorin e ardhshëm (Sylejman Selimin) më 20 mars 2012.

Së dyti, Shqipëria po ashtu renditet e para ndër vendet fqinje të Kosovës, dhe e dyta në rajon, për nga numri i marrëveshjeve bilaterale që dy shtetet i kanë nënshkruar, dhe që janë 17 në total.⁴⁶ Pos kësaj, është po ashtu Memorandumi i Mirëkuptimit, Shtesa e Marrëveshjes, si dhe një tjetër për Rritjen e Bashkëpunimit që janë nënshkruar midis dy shteteve. Duke e marrë parasysh numrin e madh të marrëveshjeve që janë nënshkruar me Shqipërinë, në krahasim me numrin e marrëveshjeve me shtetet e tjera të rajonit, natyra e këtyre marrëveshjeve është mjaft e shumëllojshme, dhe këto shtrihen nga bashkëpunimi i sigurisë, bashkëpunimi në kufirin e përbashkët, dhe çështjet e ndryshme teknike. Megjithatë, është vetëm një marrëveshje që merret me bashkëpunimin e dy shteteve në fushën e edukimit.

Cilësia e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet fqinje

	Shteti	Pikë	Cilësia
	Turqia	4.00	E shkëlqyer
2	Shqipëria	3.88	E shkëlqyer
	Slovenia	3.25	Shumë e Mirë
4	Maqedonia	3.13	Shumë e Mirë
	Kroacia	2.63	E Mirë
	Bullgaria	2.75	E Mirë
7	Mali i Zi	1.88	Jo e Keqe
8	Serbia	0.75	E dobët
	Greqia	0.25	E dobët
	Rumania	0.13	E dobët
	BH	0.00	E dobët

⁴³ Njohjet e Republikës së Kosovës, Kosovo Thanks You [Kosova Ju Falënderon], faqe zyrtare e përkrahur nga MPJ e Kosovës, qasur më 6 janar, 2014, <http://www.kosovothanksyou.com/>

⁴⁴ “Lauka dekretohet ambasador i Shqipërisë në Kosovë”, 19 janar, 2009, <http://www.kosovapress.com/sq/arkiva/lauka-dekretohet-ambasador-i-shqiperise-ne-kosove-62541/?old=1>

⁴⁵ “First Kosovo Ambassadors Begin Missions” [“Ambasadorët e parë të Kosovës i fillojnë misionet”], qasur më 15 nëntor, 2013, <http://www.balkaninsight.com/en/article/first-kosovo-ambassadors-begin-missions>.

⁴⁶ Marrëveshjet ndërkombëtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, qasur më 20 nëntor, 2013, <http://gazetazyrtare.rks.gov.net/MN.aspx>.

Së fundi, ndër shtetet fqinje Shqipëria është në maje të listës së investitorëve në Kosovë, dhe është e treta në të tërë rajonin, pas Sllovenisë dhe Turqisë. Investimet mesatare vjetore të Shqipërisë në Kosovë midis viteve 2008-2012 janë mbi 16.2 milionë €. ⁴⁷ Pos pranisë diplomatike dhe të biznesit në Kosovë, Shqipëria është po ashtu i vetmi fqinj i Kosovës që i mban trupat e veta si pjesë e misionit të KFOR-it të udhëhequr nga NATO-ja, dhe këto janë 14 në total. ⁴⁸

2.2.2 Marrëdhëniet bilaterale me MAQEDONINË

Ndër katër vendet fqinje, Maqedonia ka marrëdhënie bilaterale *shumë të mira* me Kosovën, dhe kësaj është e renditur si fqinji i dytë i Kosovës, dhe është në vendin e katërt në rajon, nga aspekti i cilësisë së marrëdhënieve bilaterale me Kosovën. Ngjashëm me marrëdhëniet e *shkëlqyera* të Kosovës me Shqipërinë, marrëdhëniet *shumë të mira* me Maqedoninë përftohen nga rezultati i tërësishëm që Maqedonia e ka në aspektet fundamentale të marrëdhënieve të veta bilaterale me Kosovën. Së pari, për dallim nga vendet e tjera të rajonit, shumica e të cilave e kanë njohur Kosovën, ose menjëherë, ose brenda 6 muajve të parë, Maqedonia e njohu Kosovën më 9 tetor 2008, rreth 8 muaj pasi që kjo e shpalli pavarësinë e vet, gjë kjo që Maqedoninë e bën njërin nga vendet e fundit në rajon, dhe të 50-in në botë, që e njohu Kosovën. ⁴⁹ Vonesa në njohjen e Kosovës ishte rezultat i mendimeve të ndryshme të zgjatura; Maqedonia frikësohej se Serbia mund t'i prishë keq marrëdhëniet me të, meqë ish-Presidenti i Serbisë, Boris Tadiq i kishte thënë Presidentit të atëhershëm të Maqedonisë, Branko Crvenkovskit që njohja e Kosovës do të thoshte “ndërhyrje në punët e brendshme [të Serbisë] dhe që kjo gjithsesi do t'i përkeqësonte marrëdhëniet [e tyre]”. ⁵⁰ Kjo u bë e evidente kur, si reagim ndaj njohjes së Kosovës, Serbia e dëboi Ambasadorin e Maqedonisë në Beograd, ⁵¹ edhe pse kjo ishte një praktikë e rëndomtë e Serbisë në fillim me pothuaj çdo shtet që e njohte Kosovën. ⁵² Po ashtu, në një analizë që u bë në vitin 2008, pasi që Kosova e kishte shpallur pavarësinë e vet, 60% të maqedonasve ishin kundër njohjes së Kosovës nga ana e Maqedonisë, kështu që ishte po ashtu edhe një trysni publike e supozuar dhe këmbëngulëse në Qeverinë nga bashkësia maqedonase. ⁵³

Maqedonia duket sikur ishte po ashtu nën “trysni” nga aleatët e vet perëndimorë për të lëvizur përpara me njohjen. ⁵⁴ Duke e marrë parasysh që kërkesat e tilla bëheshin nga vendet të cilat Maqedonia tashmë i kishte përcaktuar të jenë në interesin e politikës së vet të jashtme, dhe atë kryesisht nga vendet anëtare të UE-së dhe të NATO-s, Maqedonia, më 9 tetor 2008 vendosi ta njohte Kosovën; megjithatë, kjo u përpoq, por pa sukses, që njohjen ta kushtëzonte me demarkacionin e kufirit midis dy vendeve. Pos vonimit të njohjes, u desht mjaft kohë para se Maqedonia t'i vendoste marrëdhëniet diplomatike dhe marrëdhëniet në nivel ambasadorësh me Kosovën, dhe të cilën,

⁴⁷ “Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [“Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare”], KIPRED, 26-29.

⁴⁸ “Key facts and figures” [“Faktet dhe shifrat kyçe”], KFOR, 30 nëntor, 2012, qasur më 21 janar, 2014, http://www.nato.int/kfor/structur/nations/placemap/kfor_placemat.pdf.

⁴⁹ Shih vendet që e kanë njohur Kosovën në, <http://www.kosovothanksyou.com/>.

⁵⁰ “When will Macedonia Recognize Kosovo” [“Kur do ta njohë Maqedonia Kosovën?”], qasur më 19 janar, 2014, <http://www.balcanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Macedonia/When-Will-Macedonia-Recognize-Kosovo-43368>.

⁵¹ “Serbia Expels Macedonian, Montenegrin Envoys Over Kosovo” [“Serbia dëbon të dërguarin maqedonas dhe atë malazez lidhur me Kosovën?”], Deutsche Welle (DW), 10 tetor, 2008, <http://www.dw.de/serbia-expels-macedonian-montenegrin-envoys-over-kosovo/a-3704625-1>.

⁵² Ibid.

⁵³ Fq.47, “The Independence of Kosovo and the Consolidation of Macedonia” [“Pavërsia e Kosovës dhe konsolidimi i Maqedonisë”], Zhidas Daskalovski dhe Dane Taleski në, <http://www.isn.ethz.ch/Digital-Library/Publications/Detail/?ots591=0c54e3b3-1e9c-be1e-2c24-a6a8c7060233&lng=en&id=109310>

⁵⁴ “When will Macedonia Recognize Kosovo”, [“Kur do ta njohë Maqedonia Kosovën?”], qasur më 19 janar, 2014, <http://www.balcanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Macedonia/When-Will-Macedonia-Recognize-Kosovo-43368>.

përsëri, u përpoq ta bënte të kushtëzuar nga puna në demarkacionin e kufirit.^{55dhe56} Pasi që doli e suksesshme për ta patur marrëveshjen për Demarkacionin Fizik të Kufirit, Maqedonia vendosi marrëdhënie diplomatike me Kosovën, më 18 tetor 2009,⁵⁷ datë kjo kur u nënshkrua marrëveshja e demarkacionit, dhe që është një vit pas njohjes zyrtare të Kosovës.⁵⁸ E njëjta analizë që tregonte pakënaqësi në mesin e 60% të maqedonasve lidhur me njohjen e Kosovës, tregonte po ashtu që 95% e shqiptarëve të Maqedonisë ishin në favor të asaj që Maqedonia ta njohte Kosovën.⁵⁹ Si rezultat i kësaj, dy partitë kryesore politike të shqiptarëve në Maqedoni ushtronin trysni në zyrtarët shtetërorë maqedonas për ta përshpejtuar njohjen.^{60dhe61}

Maqedonisë iu desht po ashtu më shumë kohë për ta emëruar Ambasadorin e vet në Prishtinë. Një vit e gjysmë pas njohjes, më 1 janar 2010, Maqedonia vendosi ta emëronte Ambasadorin e vet të parë në Prishtinë (Stojan Karajanov).⁶² Pas përfundimit të mandatit të Z. Karajanov në korrik 2013,⁶³ ambasadori i ri i Maqedonisë në Prishtinë nuk është emëruar ende. Këtu duhet të themi që Maqedonia e kishte mbajtur praninë e saj në Kosovë madje edhe para se ta njohte Kosovën, dhe, madje, edhe para se Kosova ta shpallte pavarësinë e vet. Kjo e mbante praninë e vet, së pari, përmes Zyres Tregtare dhe Ekonomike, dhe më pas, përmes Zyres së vet Ndërlidhëse të Republikës së Maqedonisë në Kosovë. Nga ana tjetër, Kosovës iu deshtën më tepër se dy vjet e gjysmë pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve, ta emëronte Ambasadorin e vet të parë në Maqedoni (Ylber Hysa), dhe kjo këtë e bëri më 25 maj 2012.⁶⁴ Para emërimit të Z. Hysës, Kosova praninë e vet në Maqedoni e ruante përmes Chargé d.Affaires, Z. Skender Dervishit, që ishte emëruar në mars 2010.

Së dyti, është numri i marrëveshjeve që Maqedonisë i ndihmon më së shumti në marrëdhëniet e mira bilaterale me Kosovën. Maqedonia renditet e dyta midis vendeve fqinje të Kosovës, dhe e treta në rajon me numrin e marrëveshjeve bilaterale që i ka nënshkruar me Kosovën, dhe që janë 16 në total.⁶⁵ Natyra e këtyre marrëveshjeve është mjaft e shumëllojshme; marrëveshjet lidhur me bashkëpunimin ekonomik, si dhe ato për sigurinë dhe sundimin e ligjit, janë ato që në masën më të madhe e karakterizojnë natyrën e marrëveshjeve midis Kosovës dhe Maqedonisë. Marrëveshjet në fushën e kulturës dhe të mjekësisë janë po ashtu të pranishme. Së fundi, në mesin e vendeve fqinje, Maqedonia është investuesi i dytë më i madh në Kosovë, dhe është pas Shqipërisë, dhe është

⁵⁵ "Report: Macedonia, Kosovo to agree on border demarcation, diplomatic relations soon" ["Raport: Maqedonia dhe Kosova do të pajtohen së shpejti për demarkacionin e kufirit dhe për marrëdhëniet diplomatike"], 16 tetor, 2009, <http://macedoniaonline.eu/content/view/full/8576/2/>

⁵⁶ "Marrëdhëniet diplomatike Kosovë-Maqedoni pas mbarimit të demarkacionit", 21 gusht, 2009,

<http://www.albeu.com/shqiperi/marredheniet-diplomatike-kosove-maqedoni-pas-mbarimit-te-demarkacionit/12259/>

⁵⁷ KIPRED, burim nga Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës, dhjetor 2013.

⁵⁸ Shih Marrëveshjen në, <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/shqip-179.pdf>

⁵⁹ Fq.47, "The Independence of Kosovo and the Consolidation of Macedonia" ["Pavarësia e Kosovës dhe konsolidimi i Maqedonisë"], Zhidas Daskalovski dhe Dane Taleski <http://www.isn.ethz.ch/Digital-Library/Publications/Detail/?ots591=0c54e3b3-1e9c-be1e-2c24-a6a8c7060233&lng=en&id=109310>

⁶⁰ "PDSH: Urgjentisht të njihet pavarësia e Kosovës", 29 shtator, 2008 në, <http://www.telegrafi.com/lajme/pdsh-urgjentisht-te-njihet-pavaresia-e-kosoves-2-2330.html>

⁶¹ "When will Macedonia Recognize Kosovo" ["Kur do ta njohë Maqedonia Kosovën"],

<http://www.balkanicaucaso.org/eng/Regions-and-countries/Macedonia/When-Will-Macedonia-Recognize-Kosovo-43368>

⁶² Shih biografinë e Ambasadorit në, <http://www.missions.gov.mk/prishtina/embassy/biography-of-ambassador/>

⁶³ Presidentja Jahjaga takohet me Stojan Karajanov <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,2971>

⁶⁴ "Skender Dervishi, Ambasador i Kosovës në Shkup", <http://web.kosovalbaner.com/vm/2010/03/skender-dervishi-ambasador-i-kosoves-ne-shkup/>

⁶⁵ Shih të gjitha Marrëveshjet Ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në: <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/MN.aspx>

investuesi i pestë në mesin e vendeve të tjera të rajonit. Investimet mesatare vjetore të Maqedonisë në Kosovë midis viteve 2008-2012 janë afër 2.5 milion €. ⁶⁶

2.2.3 Marrëdhëniet bilaterale me MALIN E ZI

Në mesin e katër shteteve fqinje, Mali i Zi ka marrëdhënie bilaterale me Kosovën që janë vetëm *jo të këqija*, dhe, kësaj, ky, sa i përket cilësisë së marrëdhënieve bilaterale me Kosovën, është i renditur i treti ndër katër fqinjët e Kosovës, dhe vetëm i shtati në rajon. Ngjashëm me marrëdhëniet *e shkëlqyera* dhe *shumë të mira* të Kosovës me Shqipërinë dhe Maqedoninë respektivisht, marrëdhëniet *jo të këqija* me Malin e Zi përftohen nga rezultati i tërësishëm që Mali i Zi e arrin në aspektet fundamentale të marrëdhënieve të veta bilaterale me Kosovën. Së pari, për dallim nga vendet e tjera të rajonit, shumica e të cilave Kosovën e kanë njohur, ose menjëherë, ose brenda 6 muajsh, Mali i Zi Kosovën e ka njohur më 9 tetor 2008, rreth 8 muaj pasi që kjo e ka shpallur pavarësinë e vet, gjë kjo që Malin e Zi e bën, njësoj si Maqedoninë, njërin nga vendet e fundit të rajonit, dhe të 49-in në botë që e ka njohur Kosovën. ⁶⁷ Duket sikur njohja nga Mali i Zi dhe Maqedonia ka ardhur në një lëvizje të koordinuar, meqë që të dyja vendet përballëshin me një “krizë marrëdhëniesh” të ngjashme me Serbinë, që Malin e Zi e kërcënonte, njësoj si edhe Maqedoninë, që marrëdhëniet do të përkeqësohen nëse Mali i Zi e njeh Kosovën. Mali i Zi, për dallim nga Maqedonia, kishte marrëdhënie madje edhe më të avancuara me Serbinë, meqë ky ishte shkëputur nga federata e shpërndarë me Serbinë vetëm dy vite para se ta njohte Kosovën. Për më tepër, serbët në Malin e Zi janë etnia e tretë më e madhe dhe këta paraqesin afër 30% të popullatës. ⁶⁸

Së dyti, Mali i Zi e njohu Kosovën vetëm një ditë pasi që e përkrahu Serbinë dhe Rezolutën e saj në APKB e cila thërriste që ligjshmëria e pavarësisë së Kosovës të rishikohej nga GJND-ja. ⁶⁹ Njohja nga Mali i Zi nuk u mirëprit në Serbi, dhe këtu, njësoj si edhe me Maqedoninë dhe me shtetet e tjera që e kishin njohur Kosovën, Serbia e tërhoqi Ambasadorin e saj dhe Ministri i Jashtëm i Serbisë i asaj kohe, Vuk Jeremiç, tha që Ambasadori malazez në Beograd “nuk ishte i mirëseardhur edhe më tutje”. ⁷⁰ Pos kësaj, opozita pro-serbe në Mal të Zi organizoi protesta kundër qeverisë, e cila u përgjigj që njohja e Kosovës “nuk është kundër Serbisë, por është për të ardhmen tonë”. ⁷¹ Me sa duket, Mali i Zi, njësoj si dhe Maqedonia, ishte nën trysni nga ana e shteteve kyçe të UE-së dhe të NATO-s, dhe gjykuar nga realiteti në terren, Mali i Zi e zgjodhi, edhe pse jo me vullnet të plotë, shtegun evropian. ⁷²

Malit të Zi iu desht më shumë se Maqedonisë për t’i vendosur marrëdhëniet diplomatike me Kosovën, të cilën e bëri më 15 janar 2010, pothuaj një vit e gjysmë pasi që e njohu Kosovën. Mali i Zi nuk e ka kushtëzuar njohjen e Kosovës apo vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Mirëpo, ky e ka kushtëzuar emërimin e Ambasadorit të saj në Kosovë, që ishte në pritje që nga vendosja e

⁶⁶ “Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [“Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare”], 59-61.

⁶⁷ Recognitions of the Republic of Kosovo [Njohjet e Republikës së Kosovës], qasur më 6 janar 2014, <http://www.kosovothankyou.com/>.

⁶⁸ “Census of population, households and dwellings in Montenegro 2011” [“Regjistrimi i popullatës, familjeve dhe banesave në Mal të Zi, 2011”], Zyra Statistikore e Malit të Zi, No. 83, korrik 12, 2013, qasur më 16 janar, 2014, [http://www.monstat.org/userfiles/file/popis2011/saopstenje/saopstenje\(1\).pdf](http://www.monstat.org/userfiles/file/popis2011/saopstenje/saopstenje(1).pdf)

⁶⁹ “Why did Montenegro recognize independence of Kosovo” [“Pse Mali i Zi e njohu Kosovën?”], Blogactiv, 25 tetor, 2008, qasur më 2 janar, 2014, <http://montenegro.blogactiv.eu/2008/10/25/why-did-montenegro-recognize-independence-of-kosovo/>.

⁷⁰ “Montenegro, Macedonia recognize Kosovo statehood” [“Mali i Zi dhe Maqedonia e njohin shtetësinë e Kosovës?”], qasur më 3 dhjetor, 2013, http://usatoday30.usatoday.com/news/world/2008-10-09-1157695074_x.htm.

⁷¹ “Montenegro, Macedonia recognize Kosovo statehood” [“Mali i Zi dhe Maqedonia e njohin shtetësinë e Kosovës?”].

⁷² Why did Montenegro recognize independence of Kosovo” [“Pse Mali i Zi e njohu Kosovën?”].

marrëdhëniet diplomatike, me njohjen e malazezëve që jetojnë në Kosovë si një komunitet me të drejta të plota kushtetutare me ato që i gëzojnë komunitetet e tjera në Kosovë.⁷³ Mali i Zi e emëroi Chargé d’Affairs (Radovan Miljaniq) më 30 korrik 2013, dhe pret që të ndodhin amandamentimet kushtetutare në Kosovë ashtu që marrëdhëniet diplomatike t’i ngritë në nivel ambasadorësh. Deri në shtator 2013, edhe përkundrejt disa premtimeve, amandamentimet nuk kanë ndodhur,⁷⁴ mirëpo këto priten deri në fundin e vitit 2013.⁷⁵ Nga ana tjetër, Kosova nuk e ka emëruar ende të dërguarin e vet, dhe as nuk e ka hapur ambasadën e vet në Mal të Zi.

Së treti, Mali i Zi renditet i treti ndër shtetet fqinje të Kosovës, dhe i teti në rajon, me numrin e marrëveshjeve bilaterale që i kanë nënshkruar dy shtetet, dhe totali i tyre është 3.⁷⁶ Në fakt, në mesin e shteteve në rajon që e kanë njohur Kosovën, Mali i Zi është në fundin e listës sa i përket numrit të marrëveshjeve të nënshkruara me Kosovën. Marrëveshjet kanë të bëjnë me bashkëpunimin në dogana dhe me regjistrat themelore të personave për qëllimet administrative. Kosova ende duhet ta nënshkruaj marrëveshjen për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, një proces ky që tashmë ka filluar.⁷⁷ Janë planifikuar për t’u diskutuar edhe një varg marrëveshjesh të tjera midis Kosovës dhe Malit të Zi, që kanë të bëjnë me fushat e ekonomisë dhe të infrastrukturës, të tilla si: projektet në hekurudha dhe në autostrada, njësoj si dhe investimet në turizëm.⁷⁸

2.2.4 Marrëdhëniet/kontaktet bilaterale me SERBINË

Serbia është i vetmi shtet ndër fqinjët e Kosovës, dhe ndër katër vendet në të tërë rajonin që nuk e njeh Kosovën. Për këtë arsye, Serbia dhe Kosova nuk kanë kurrfarë marrëdhëniesh bilaterale, dhe cilësia e marrëdhëniet, e shprehur nga aspekti i kontakteve në nivelet e ndryshme, mbetet *e dobët*. Marrëdhëniet *e dobëta* të Kosovës me Serbinë përftohen nga rezultati i tërësishëm që Serbia e arrin në aspektet fundamentale të marrëdhëniet/kontakteve të saj me Kosovën. Kushtetuta aktuale e Serbisë e përvetësuar në vitin 2006, pasi që Mali i Zi u shkëput prej saj, ende e merr Kosovën si një krahinë të saj dhe sipas kësaj Kushtetute “autonomia substanciale e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë do të rregullohet me një ligj të veçantë që do të përvetësohet në pajtim me diskutimet e parapara për amandamentimin e Kushtetutës”.⁷⁹ Serbia e ka kuptuar që mbajtja e Kosovës si pjesë e kornizës së saj të tashme ligjore ashtu siç është përcaktuar në Kushtetutën e saj nuk është realiste; kjo nuk është për shkak të vullnetit të Serbisë, por më tepër për shkak të një numri rrethanash rajonale dhe ndërkombëtare, të tilla si: së pari, prania e trupave të Forcës së Kosovës e udhëhequr nga NATO-ja (KFOR-i), e cila e ka përgjegjësinë për mbrojtjen e territorit të Kosovës, por që është e pranishme sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara (KSKB) e cila e njeh sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën; së dyti, kjo e bën të pamundur për Serbinë që t’i zbatojë

⁷³ “Kosovo must recognize Montenegrins” [“Kosova duhet t’i njohë malazezët”], qasur më 4 dhjetor, 2013,

http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2009&mm=12&dd=31&nav_id=64150.

⁷⁴ “The issue of Montenegrin citizens in Kosovo is considered as technical issue and not an intentional stalling” [“Çështja e qytetarëve malazezë në Kosovë konsiderohet si një çështje teknike, jo si ndonjë ndalim i qëllimshëm”], qasur më 4 dhjetor, 2013,

<http://www.balkaninsight.com/en/article/montenegro-to-strengthen-diplomatic-relations-with-kosovo>.

⁷⁵ “Montenegro to boost diplomatic ties with Kosovo” [“Mali i Zi duhet ngritur lidhjet e veta me Kosovën”], qasur më 4 dhjetor, 2013, <http://www.balkaninsight.com/en/article/montenegro-to-strengthen-diplomatic-relations-with-kosovo>.

⁷⁶ Marrëveshjet ndërkombëtare, Gazeta Zyrtare e Kosovës.

⁷⁷ “Montenegro and Kosovo start demarcation process” [“Mali i Zi dhe Kosova e fillojnë procesin e demarkacionit”], qasur më 4 dhjetor, 2013, <http://www.balkaninsight.com/en/article/montenegro-launches-border-demarcation-with-kosovo>.

⁷⁸ “Kosovo and Montenegro aim to strengthen economic cooperation” [“Kosova dhe Mali i Zi synojnë ta forcojnë bashkëpunimin ekonomik”], qasur më 6 dhjetor, 2013,

http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2012/01/18/feature-02 and <http://mzhe.rks-gov.net/?page=2,42,661>.

⁷⁹ Neni 182, Kushtetuta e Serbisë, qasur më 24 nëntor, 2013, http://www.srbija.gov.rs/cinjenice_o_srbiji/ustav_odredbe.php?id=225.

dispozitat e saj kushtetuese, përfshirë forcën, për ta kthyer krahinën e saj ashtu siç është e përcaktuar në Kushtetutën e saj; së treti, duke e patur parasysh që Serbia e ka përcaktuar anëtarësinë e vet në UE si njërin nga prioritetet e veta më të larta, ajo është duke u kushtëzuar nga kjo e fundit për ta gjetur një zgjidhje kompromise, dhe, faktikisht, e ka ndarë Kosovën nga Serbia në procesin e saj të vlerësimit të hyrjes në UE, d.m.th., liberalizimi i vizave për Serbinë është i efektshëm vetëm për territorin që e përjashton Kosovën, dhe të gjitha kërkesat e UE-së për Serbinë kanë të bëjnë vetëm për strukturën e saj të tashme territoriale pa Kosovën.

Pos synimeve të veta për anëtarësinë në UE, Serbia e ruan edhe një qëllim tjetër (kryesor) të politikës së jashtme, i cili është “mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Serbisë, dhe gjetja e zgjidhjes kompromise lidhur me Kosovën dhe Metohinë duke e fituar përkrahjen më të gjerë të mundshme për qëndrimet e Republikës së Serbisë në tubimet multilaterale”.⁸⁰ Në dritën e këtyre dy qëllimeve, që duken kundërshtuese, të politikës së saj të jashtme, Serbia e ka përvetësuar një politikë të jashtme retorike “edhe UE-ja, edhe Kosova” të cilën vazhdon ta mbajë edhe më tutje.

Brenda më tepër se tre viteve pas Shpalljes së Pavarësisë, Kosova dhe Serbia kanë vazhduar t'i ndjekin qëllimet e politikave të jashtme të veta, ku e para ndjek njohje të reja dhe e forcon legjitimitetin ndërkombëtar, ndërsa e dyta ecën rrugës së vet duke u përpjekur të gjejë partnerë që do t'i ndalnin përpjekjet e Kosovës. Një nga përpjekjet e para të mëdha të Serbisë për t'i ndalur ndërmarrjet diplomatike të Kosovës për të fituar më tepër njohje ishte Rezoluta e KB-ve të cilën ajo e përpiloi për ta kërkuar vendimin këshillues të GjND-së për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës. Kjo është përvetësuar nga APKB më 8 tetor 2008.⁸¹ Një javë pas opinionit këshillues të GjND-së të 22 korrikut 2010 që Kosova nuk e kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare,⁸² Serbia më 28 korrik 2010 APKB ia dorëzoi edhe një draft rezolutë tjetër që thërriste për negociata të reja lidhur me statusin e Kosovës, të cilën shumica e shteteve anëtare të UE-së dhe SHBA-të e kundërshtuan.⁸³ Megjithatë, një rezolutë tjetër kompromise e bashkë-sponsorizuar nga Serbia dhe UE-ja iu dorëzua dhe u përvetësua nga APKB-ja më 9 shtator 2010, e cila, për dallim nga draft-rezoluta paraprake e dorëzuar nga Serbia, “e mirëpriste gatishmërinë e Unionit Evropian për ta ndihmuar dialogun midis Serbisë dhe Kosovës rreth shpalljes unilaterale të pavarësisë së krahinës”.⁸⁴ Ky ishte fillimi i fundit për përleshjet e pavarura diplomatike të Kosovës dhe të Serbisë rreth statusit të Kosovës, dhe rreth tre vjet pas Deklaratës së Pavarësisë, Kosova dhe Serbia ia filluan dialogut më 8 mars 2011.⁸⁵

⁸⁰ “Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin Multilateral”, Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë, qasur më 15 nëntor, 2013, <http://www.mfa.gov.rs/en/foreign-policy/multilateral-issues>.

⁸¹ “Backing request by Serbia, General Assembly decides to seek International Court of Justice ruling on legality of Kosovo’s independence” [“Duke e mbështetur kërkesën e Serbisë, Asambleja e Përgjithshme vendos ta kërkojë vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë rreth ligjshmërisë së pavarësisë së Kosovës”], Asambleja e Përgjithshme.

⁸² “Accordance with international law of the unilateral declaration of independence in respect of Kosovo (Request for Advisory Opinion)” [“Pajtueshmëria me të drejtën ndërkombëtare e shpalljes unilaterale të pavarësisë lidhur me Kosovën (Kërkesë për Opinion Këshillues)”, 10 tetor, 2008, qasur më 24 nëntor, 2013, <http://www.ici-pcij.org/docket/index.php?p1=3&p2=4&k=21&case=141&code=kos&p3=0>.

⁸³ “Serbia submits Kosovo draft to UN GA” [“Serbia ia dorëzon draftin për Kosovën APKB”], qasur më 4 dhjetor, 2013, http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2010&mm=07&dd=28&nav_id=68748.

“Adopting consensus resolution, General Assembly acknowledges world court opinion on Kosovo, welcomes European Union readiness to facilitate process of dialogue” [“Duke e përvetësuar rezolutën e konsensusit, Asambleja e Përgjithshme e pranon opinionin e gjykatës botërore për Kosovën, dhe e mirëpret gatishmërinë e Unionit Evropian për ta ndihmuar procesin e dialogut”], Takimi i 120-të i Kombeve të Bashkuara dhe i gjashtëdhjetë e katërt plenar i Asamblesë së Përgjithshme, 9 shtator, 2010, qasur më 6 janar 2014, <http://www.un.org/News/Press/docs/2010/ga10980.doc.htm>.

⁸⁵ “Kosovo and Serbia meet in Brussels for UE-backed talks” [“Kosova dhe Serbia takohen në Bruksel në bisedimet e mbështetura nga UE-ja”], qasur më 20 janar, 2014, <http://www.bbc.co.uk/news/world-europe-12672846>.

Kjo është hera e parë që zyrtarët e Kosovës dhe të Serbisë janë takuar pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Dialogu vazhdon ende; megjithatë, faza e tij e parë që zgjati deri në tetorin 2012, e emërtuar si ‘dialogu teknik’ i dha 10 Konkludime midis dy palëve.⁸⁶ Ndërkohë që nga 19 tetori 2012 e këtej, dialogu shkoi në nivelin e kryeministrave, të parët që u mbajtën në këtë nivel midis Kosovës dhe Serbisë, një proces ky që u emërtua ‘dialogu politik’ i dha 15 pika të “Marrëveshjes së Parë rreth Parimeve që e Udhëheqin Normalizimin e Marrëdhënieve” më 19 prill 2013.⁸⁷ Natyra e konkludimeve të arritura gjatë fazës së parë të dialogut është e shumëllojshme, nga liria e lëvizjes, librat e gjendjes civile, bashkëpunimi në kufirin e përbashkët, dhe përfaqësimi ‘i modifikuar’ i Kosovës në organizatat dhe forumet rajonale.

Parimet kryesore të marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë të arritura në dialogun e ndihmuar nga UE-ja midis Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçit, dhe Kryeministrit të Serbisë, Ivica Dačićit, nga ana tjetër, përfshijnë çështje më të ndjeshme që kanë të bëjnë me pjesën veriore të Kosovës dhe Bashkësisë/Asociacionit të Komunave Serbe të Kosovës në Kosovë. Serbia e ruajti praninë e vet në këtë pjesë të Kosovës që nga viti 1999, dhe atë edhe e forcoi pasi që Kosova e shpalli pavarësinë e vet si dhe pasi që Kosova u përpoq të intervenonte dhe ta merrte kontrollin mbi dy vendkalimet kufitare me Serbinë në veri në korrikun e vitit 2011. Marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë nuk është një marrëveshje bilaterale i cila i nënshtrohet të drejtës ndërkombëtare. UE-ja, përmes rëndesës së procesit të vet të hyrjes në të, përpiqet ta luajë rolin e garantuesit të kësaj marrëveshjeje. Kosova është vetëm një palë në marrëveshje që e ka miratuar atë me 2/3 në Kuvend, dhe si e tillë, marrëveshja nuk është aq e qëndrueshme sa do të kishte qenë sikur atë ta kishte miratuar edhe Serbia.

Vendosja e kontakteve midis dy palëve gjithsesi mund ta ketë zvogëluar tendosjen e cila ka ekzistuar midis tyre dhe mund ta ketë ulur mundësinë për ndonjë tjetër konflikt brenda Kosovës apo midis Kosovës dhe Serbisë. Rëndësia e hyrjes në UE gjithsesi mund ta ketë luajtur një rol në shtytjen e Serbisë që përfundimisht të bëjë ndryshime praktike në qëndrimin e saj ndaj Kosovës. Megjithatë, pas dy vitesh e gjysmë të kontakteve dhe negociatave, Serbia nuk e ka bërë as edhe një hap të vetëm drejt ndryshimit të retorikës së vet politike lidhur me Kosovën, dhe as që e ka dhënë ndonjë tregues që në fund do të ndërmarrë hapa në njohjen e realitetit në terren – e lëre më në bërjen e ndryshimeve kushtetuese që do ta njihnin Kosovën. Pas arritjes së marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënieve, dhe duke e marrë parasysh që implementimi i saj po vazhdon ngadalë, Serbia pritet ta aktivizojë Nenin 182 të Kushtetutës së vet, i cili e përcakton që statusi i Kosovës “do të rregullohet me një ligj të veçantë”⁸⁸ apo që më vonë u bë i njohur si “E Drejta Kushtetuese” me të cilën pritet se Serbia do të dalë, ku do të bëhen ndryshime ligjore lidhur me Kosovën. Mirëpo, pritet që ndryshimet kushtetuese do të pasqyrojnë më tepër ndryshimet që kanë ndodhur në terren lidhur me statusin e përmirësuar të serbëve të Kosovës për të cilin Kosova dhe Serbia e kanë arritur

⁸⁶ Raport i KIPRED-it “The Analysis of the Implementation of the Technical Agreements between Kosovo and Serbia” [“Analizë e implementimit të marrëveshjeve teknike midis Kosovës dhe Serbisë”],

http://www.kipred.org/advCms/documents/45012_Implementation_of_technical_agreements_Kosovo_and_Serbia.pdf.

⁸⁷ “First Agreement of principles governing the normalization of relations” [“Marrëveshja e Parë për parimet që do ta udhëheqin normalizimin e marrëdhënieve”], qasur më 16 janar, 2013, <http://friendsofkosovo.com/2013/04/19/first-agreement-of-principles-governing-the-normalization-of-relations/>.

⁸⁸ Kushtetuta e Serbisë, Neni 182, http://www.srbija.gov.rs/cinjenice_o_srbiji/ustav_odredbe.php?id=225.

marrëveshjen, sesa me ndryshimet që Serbinë do ta bënin të dukej se është duke hequr dorë nga Kosova.

Së fundi, shumica e ulët e investimeve të Serbisë në Kosovë kontribuon edhe më tepër për marrëdhëniet/kontaktet e dobëta midis dy shteteve. Vlera mesatare e investimeve vjetore të Serbisë në Kosovë për periudhën 2008-2012 është rreth 1.4 milionë €. ⁸⁹ Megjithatë, Serbia derdh një sasi të rëndësishme të parave për komunat serbe në Kosovë, që është rreth 500 milionë € në vit, apo 30% e buxhetit të Kosovës. ⁹⁰

2.2.5 Çështjet bilaterale shtesë të Kosovës me fqinjët e vet

Liria e lëvizjes për qytetarët e Kosovës në vendet e tjera, dhe mungesa rezultuese e pengesave për lëvizje, është një aspekt tjetër fundamental që i kontribuon cilësisë së marrëdhënieve bilaterale midis shteteve. Sa i përket fqinjëve të Kosovës, që të gjithë ata kanë pikë të larta në këtë aspekt fundamental. Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi asnjë herë nuk kanë zbatuar pengesa në lëvizjen e qytetarëve të Kosovës, as para, dhe as pas Shpalljes së Pavarësisë. ⁹¹ Maqedonia dhe Mali i Zi, të cilave iu deshtën rreth 8 muaj për ta njohur Kosovën, i pranuan pasaportat e Kosovës madje edhe para se ta njihnin shtetësinë e saj. Serbia e hoqi pengesën e saj për hyrjen e qytetarëve të Kosovës tre muaj pas Shpalljes së Pavarësisë, gjë kjo që ishte rezultat i marrëveshjes për lirinë e lëvizjes që u arrit midis këtyre dy palëve më 2 korrik 2011 si pjesë e ‘dialogut teknik’. ⁹² Sidoqoftë, fqinjët e Kosovës zbatojnë pengesa të tjera të tilla si premiumet e sigurimit, të cilat në rastin e Serbisë ende janë më të shtrenjta, dhe zbaton çmim *segregativ*, ndërkohë që ka çmime shumë më të ulëta për regjistrimet e makinave të UNMIK-ut se për regjistrimet e makinave të lëshuara nga autoritetet e Republikës së Kosovës.

2.2.6 Fqinjët në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës

Duke e vështruar rolin e shteteve fqinje të Kosovës në forcimin e legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës, shohim që ky është një aspekt tjetër fundamental që i kontribuon rezultatit që çdonjëri nga këto shtete e merr nga aspekti i cilësisë së marrëdhënieve të tij bilaterale me Kosovën. Shqipëria është i vetmi shtet fqinj i Kosovës që e ka përkrahur rastin e Kosovës para GjND-së. Shqipëria e ka paraqitur një qëndrim të shkruar përkrahës më 17 prill 2009, dhe ka ofruar komente përkrahëse shtesë më 24 korrik 2009. Për më tepër, Shqipëria e ka shfrytëzuar po ashtu mundësinë për ta paraqitur një qëndrim gojor gjatë dëgjimit publik të dhjetorit 2009 në GjND, ku përfaqësuesit e saj deklaruan që “nuk ka asnjë rregull të të drejtës ndërkombëtare që e ndalon secesionin”, dhe që “do të ishte një shkelje e vrazhdë e të drejtës ndërkombëtare nëse intervenimi i shteteve të treta, me forcë, apo tjetërfare, do të ishte vendimtar për shpalljen e pavarësisë. Mirëpo, në rastin e Kosovës, kjo nuk ishte kështu”. ⁹³ Shqipëria e ka përkrahur Kosovën po ashtu në rastin e anëtarësimit të saj në FMN

⁸⁹ “Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [“Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare”], fq. 59-61.

⁹⁰ Shih, Policy Center, Kosovo How much does it cost? [Kosova, Sa kushton?], <http://www.policycenter.info/latest.html>.

⁹¹ “Visas for Kosovo citizens” [“Vizat për qytetarët e Kosovës”], qasur më 16 janar, 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,70>.

⁹² EU Press Statement, EU facilitated dialogue: three agreements Brussels [Deklaratë për shtyp e UE-së, Dialogu i ndihmuar nga UE-ja: Bruksel, tri marrëveshje], 2 korrik 2011, në, http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/123383.pdf.

⁹³ “ICJ hears further Kosovo arguments” [“GjND-ja dëgjon argumentet e mëtejme për Kosovën”], qasur më 14 janar, 2014, <http://www.balkaninsight.com/en/article/icj-hears-further-kosovo-arguments>.

dhe në Bankën Botërore, duke votuar për anëtarësimin e saj në të dyja institucionet më 3 maj 2009 dhe 2 korrik 2009 respektivisht.⁹⁴

Pos kësaj, Shqipëria është i vetmi shtet fqinj i Kosovës që i jep resurset e veta diplomatike për lobimin për pavarësinë e Kosovës dhe për rritjen e numrit të njohjeve të saj.⁹⁵ Për shkak të pamundësisë së Kosovës për të marrë pjesë në shumë gara sportive ndërkombëtare dhe për ta fituar anëtarësinë në federatat ndërkombëtare sportive, Shqipëria i ka hapur dyert e veta për sportistë të shumtë kosovarë për ta përfaqësuar Shqipërinë dhe për të garuar nën flamurin e saj.⁹⁶ Në mesin e disa aspekteve të tjera që i kontribuojnë marrëdhënieve të shkëlqyera bilaterale midis Kosovës dhe Shqipërisë, është fakti që shumica dërrmuese në të dyja shtetet e kanë të përbashkët identitetin, gjuhën, kulturën dhe historinë, dhe si rezultat i kësaj është një debatim i vazhdueshëm në rrjedhje e sipër në qarqet e gjera të akademisë, të shoqërisë civile dhe të politikbërësve lidhur me identitetin e përbashkët dhe perspektivat e ardhshme të veçanta midis dy shteteve.⁹⁷ Pos asaj që ka parti politike në të dyja anët e kufirit që e promovojnë integrimin politik (njësimin) midis dy shteteve, madje edhe politikanët e rrymës së përgjithshme e përkrahin integrimin institucional në fusha të tilla si ekonomia, politikat qeveritare, dhe në fusha të tjera.⁹⁸

Nga ana tjetër, Maqedonia dhe Mali i Zi nuk kanë dorëzuar kurrfarë deklaratash të shkruara deri në afatin përfundimtar të 17 prillit 2009, dhe as komente shtesë në afatin përfundimtar të 24 korrikut 2009, të përcaktuar nga GJND-ja,⁹⁹ dhe as nuk kanë paraqitur çfarëdo qëndrimesh gojore gjatë dëgjimeve publike të dhjetorit 2009 para GJND-së. Këto kanë mbetur të heshtura përgjatë këtij rasti meqë ato nuk donin t'i komprometonin edhe më tepër marrëdhëniet e tyre me Serbinë duke e dhënë ndonjë opinion pozitiv për Kosovën, ndërkohë që dhënia e ndonjë opinioni negativ do të ishte e palogjikshme duke e patur parasysh që ato tashmë e kishin njohur shtetin e ri. Po ashtu, njësoj si Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi e kanë përkrahur që të dyjat anëtarësinë e Kosovës në FMN dhe në Bankën Botërore, duke votuar për anëtarësimin e saj më 3 maj 2009 dhe më 3 korrik 2009 respektivisht.¹⁰⁰

Nga ana tjetër, edhe përkundrejt asaj që Maqedonia e ka njohur Kosovën, dhe edhe përkundrejt asaj që Kosova dhe Serbia ishin pajtuar lidhur me modelin e përfaqësimit të Kosovës në forumin rajonal të 24 shkurtit 2012, Maqedonia u përpoq ta sfidonte legjitimitetin ndërkombëtar të Kosovës kur vendosi që të mos ia bënte thirrjen Kosovës për samitin e 16 të PBEJL (Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore) që u mbajt në Ohër më 1 dhe 2 korrik 2013, dhe i cili udhëhiqej nga

⁹⁴ Burim i KIPRED-it në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, , dhjetor 2013.

⁹⁵ “UN, Rama: Recognize the Kosovo independence” [“KB, Rama: Njiheni pavarësinë e Kosovës”], Kryeministria e Shqipërisë, qasur më 14 janar, 2014, <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/okb-rama-ndertimi-rilindjes-sfida-ime-njihni-pavaresine-e-kosoves&page=1> dhe <http://www.kohaditore.com/?page=1,14,160318>.

⁹⁶ “Kosovarja Majlinda Kelmendi do ta përfaqësojë Shqipërinë në Lojrat Olimpike”, qasur më 14 janar, 2014, <http://www.gazetatema.net/web/2012/05/25/kosovarja-majlinda-kelmendi-do-perfaqesoje-shqiperine-ne-lojrat-olimpike/>.

⁹⁷ “Kosovo struggles to forge an identity” [“Kosova lufton për ta forcuar identitetin”], qasur më 16 janar, 2014, http://www.nytimes.com/2007/12/17/world/europe/17kosovo.html?_r=0.

⁹⁸ Shih deklarinë e Behgjet Pacollit në Kuvendin e Shqipërisë, <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,6,1649>

⁹⁹ “Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence by the Provisional Institutions of Self-Government of Kosovo” [“Pajtimi me të Drejtën Ndërkombëtare i shpalljes unilaterale të pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës”], Deklaratë për shtyp e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, No. 2009/17, 21 prill, 2009, qasur më 4 janar, 2014, <http://www.icj-cj.org/docket/files/141/15125.pdf>.

¹⁰⁰ Burim i KIPRED-it nga Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, dhjetor 2013.

Maqedonia.¹⁰¹ Arsyet prapa vendimit të Maqedonisë për të mos e ftuar Kosovën, sipas zyrtarëve të Maqedonisë, ishin “që ishin më tepër se një shtet që i bënë vërejtje kësaj, edhe pse kjo ishte kundër vullnetit të FYROM-it që ta ftonte Kosovën në Samit”.¹⁰² Sipas Presidentit të Maqedonisë, Gjorge Ivanov, disa nga shtetet e rajonit që nuk e kanë pranuar Kosovën nuk donin që ajo të ishte e pranishme, dhe këto i përfshinin shtetet si Serbia, BH, Rumania dhe Greqia.^{103dhe104dhe105} Si rezultat i zemërimit që pasoi, Greqia ishte shteti i parë që u tërhoq nga takimi, mirëpo kjo nuk ishte për shkak të Kosovës, por, me sa duket, ishte një mundësi e mirë për ta vënë Maqedoninë në një pozitë të pakëndshme – duke e patur parasysh grindjen e tyre të kahmotshme lidhur me çështjen e emrit.¹⁰⁶ Bullgaria e vijoi këtë menjëherë, duke qenë shteti i dytë i rajonit që u tërhoq nga takimi, dhe kjo nuk dha kurfarë arsyesh për vendimin e vet.¹⁰⁷ Një zyrtar i lartë i shërbimit diplomatik deklaroi që Bullgaria në parim e përkrah në tërësi pjesëmarrjen e Kosovës në të gjitha nismat rajonale.¹⁰⁸ Dy vende të tjera, Shqipëria¹⁰⁹ dhe Kroacia, këtë e vijuan menjëherë, duke e braktisur mbledhjen në protestë të drejtpërdrejtë kundër vendimit të Maqedonisë për të mos e ftuar Kosovën në samit.¹¹⁰ Si rezultat i gjithë kësaj, Presidenti i Maqedonisë u mbështet për muri dhe e anuloi të tërë samitin, në të cilin ishte planifikuar të takoheshin presidentët e të gjitha shteteve të rajonit, duke deklaruar që “fatkeqësisht, u ngritën paragjykimet e vjetra ballkanike, dhe Maqedonia nuk duhet ta paguaj për këtë. Për më tepër, ky duhet të jetë një sinjal për UE-në që ta kuptojë realitetin e rajonit”.¹¹¹

Marrëdhëniet midis Kosovës dhe Maqedonisë janë të ndikuara po ashtu edhe nga politikat vendëse të Maqedonisë ndaj bashkësisë shqiptare në Maqedoni – nga zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit. Në muajt e parë të vitit 2012, Maqedonia u përball me ato që mund të konsiderohen si tendosjet më të këqija ndëretnike që nga viti 2001. Më 28 shkurt 2012, dy shqiptarë u vranë nga një oficer i policisë së Maqedonisë në Gostivar.¹¹² Më 7 mars 2012, pesë veta të tjerë të kombësisë shqiptare u rrahën në një autobus të Shkupit. Kjo kulmoi me sulmet hakmarrëse dhe me rrahjen e një të moshuari dhe disa të rinjëve maqedonas në rrugë nga shqiptarët e Maqedonisë, si rezultat i të cilës pasuan më shumë

¹⁰¹ “Media accreditation – 16th SEECP Summit (Ohrid), and 11th Regional Forum of the “Dialogue among Civilizations” [“Akreditimi i mediave – Samiti i 16 i PBEJL (Ohër), dhe Forumi i 11 Rajonal i ‘Dialogut ndërmjet qytetërimeve’”], Presidenti i Maqedonisë, 17 maj, 2013, qasur më 18 dhjetor, 2013, <http://www.president.gov.mk/en/media-centre/press-releases/2103.html>.

¹⁰² “President Ivanov cancels the proceedings of Ohrid Summit” [“Presidenti Ivanov e braktis mbledhjen e Samitit të Ohrit”], qasur më 3 shkurt, 2014, <http://www.balkan.eu.com/president-ivanov-cancels-proceedings-ohrid-summit/>.

¹⁰³ Serbia, Romania, BiH and Greece blocked the participation of Kosovo in the Ohrid Summit” [“Serbia, Rumania, BH dhe Greqia e bllokuan pjesëmarrjen e Kosovës në Samitin e Ohrit”], qasur më 4 shkurt, 2014, <http://www.balkan.eu.com/serbia-romania-bih-greece-blocked-participation-kosovo-ohrid-summit/>.

¹⁰⁴ “Dështon Samiti i Ohrit”, qasur më 2 shkurt, 2014, <http://gazetadita.al/bojkoti-anulon-samitin-e-ohrit/>.

¹⁰⁵ “Kosova mungon, Samiti i Ohrit dështon”, qasur më 2 shkurt, 2014, <http://www.panorama.com.al/2013/05/29/mungesat-ivanov-anulon-samitin-e-ohrit/>.

¹⁰⁶ “Macedonia scraps regional presidential summit” [“Maqedonia e prish samitin rajonal presidencial”], qasur më 3 shkurt, 2014, <http://www.balkaninsight.com/en/article/macedonia-calls-off-regional-presidential-summit>.

¹⁰⁷ “Heads of states and governments of the region absent in the Ohrid Summit” [“Krerët e shteteve dhe të qeverive të rajonit mungojnë në Samitin e Ohrit”], qasur më 4 shkurt, 2014, <http://www.balkan.eu.com/heads-states-governments-region-absent-ohrid-summit/>.

¹⁰⁸ Bobi Bobev (Ambasador, Ambasada e Bullgarisë në Kosovë), intervistë në Prishtinë, 3 tetor, 2013.

¹⁰⁹ “Albanian President explains his decision not to take place in the SEECP Summit in Ohrid” [“Presidenti i Shqipërisë e shpjegon vendimin e vet për të mos marrë pjesë në Samitin e PBEJL-së në Ohër”], qasur më 15 janar, 2014, <http://www.balkan.eu.com/albanian-president-explains-decision-place-seeep-summit-ohrid/>.

¹¹⁰ “Josipovic won't attend SEECP Summit because Kosovo not invited” [“Josipović nuk do ta përcjellë Samitin e PBEJL-së meqë nuk është ftuar edhe Kosova”], qasur më 15 janar, 2014, <http://dalje.com/en-croatia/josipovic-wont-attend-seeep-summit-because-kosovo-not-invited/470088>.

¹¹¹ “President Ivanov cancelled the SEECP Summit and the Forum of the Dialogue among Civilizations” [“Presidenti Ivanov e ndërpreu Samitin e PBEJL-së dhe Forumin për Dialogun ndërmjet Qytetërimeve”], qasur më 16 janar, 2014, <http://www.president.gov.mk/en/media-centre/press-releases/2142-2013-05-29-14-33-35.html>.

¹¹² Burime të KIPRED-it pohojnë që oficeri i policisë maqedonase shkrepri armën pasi që u sulmua.

arrestime, ndërkohë që incidentet vazhduan në baza ditore.¹¹³ Këto u vijuan nga disa protesta anëmbanë vendit, edhe nga shqiptarët, edhe nga maqedonasit, të cilët brohoritnin parulla nacionaliste kundër njëri-tjetrit.¹¹⁴ Si rezultat i këtyre veprimeve, njerëz të shumtë në Kosovë ishin të mendimit që Maqedonia nuk është e ndershme ndaj bashkësisë së vet shqiptare, dhe si pasojë, më 17 mars 2013, Ambasada e Maqedonisë në Prishtinë u sulmua me një koktej mollotov, duke e ndikuar deri në një masë cilësinë e marrëdhënieve që i kanë dy shtetet.

Duke e patur parasysh që Serbia është i vetmi shtet fqinj që nuk e ka njohur Kosovën, kjo është po ashtu edhe i vetmi shtet në mesin e fqinjëve, si dhe në mesin e shteteve të tjera në rajon, që në mënyrën më të fuqishme e sfidon subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Pos që është përpjekur ta sfidojë Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës në KB, Serbia vazhdon të angazhohet posaçërisht në ndërmarrjet e veta diplomatike me shtetet që ende nuk e kanë njohur Kosovën. Edhe përkundrajt asaj që të dyja shtetet janë në kontakt të vazhdueshëm në nivel kryeministrash, dhe që kanë hyrë në dialog për “ta promovuar bashkëpunimin dhe për të arritur progres në rrugën drejt Unionit Evropian dhe për përmirësimin e jetës së njerëzve”,¹¹⁵ Serbia është angazhuar vazhdimisht në lobimin kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.^{116dhe117}

Serbia e ka shfrytëzuar çdo mundësi për ta bojkotuar anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe është përpjekur në mënyrë të vazhdueshme për ta sfiduar subjektivitetin e saj ndërkombëtar. Serbia është shteti i vetëm fqinj i Kosovës që e ka dhënë një deklaratë të shkruar negative më 17 prill 2009 para GjND-së; kjo është e vetmja në të tërë rajonin, madje edhe në mesin e shteteve mospranuese të Kosovës në rajon, që e ka dhënë një deklaratë shtesë negative duke e përkrahur kauzën e vet para GjND-së, më 24 korrik 2009, dhe, e qartë, e ka bërë një deklaram negativ gojor gjatë dëgjimit publik para GjND-së në dhjetorin 2009 për ligjshmërinë e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Rezervimet, deklaramet dhe vërejtjet e Serbisë lidhur me anëtarësimin e Kosovës në FMN, të bëra më 17 gusht 2009 ishin të përpiluara në një mënyrë të tillë që Serbia argumentonte që “deklarata e Republikës së Serbisë lidhur me pranimin e qëllimshëm të të ashtuquajturës ‘Republikë e Kosovës’ në Nenet e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar [...] Republika e Serbisë deklaronte që veprimet e nënshkrimit dhe të depozitimit të instrumentit të qëllimshëm të pranimin të Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar nga ana e përfaqësuesve të të ashtuquajturës ‘Republikë e Kosovës’ janë shkelje të drejtës ndërkombëtare dhe në veçanti e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Rrjedhimisht, këto janë të pavlefshme dhe të pafuqishme dhe pa kurrfarë efekti ligjor. Krahina Autonome e Kosovës dhe

¹¹³ “The wave of inter-ethnic incidents in Macedonia” [“Valë e incidentesh ndëretnike në Maqedoni”], qasur më 4 shkurt, 2014, <http://balkans.aljazeera.net/makale/talas-meduetnickih-incidentata-u-makedoniji>

¹¹⁴ Shpend Kursani dhe Ilir Deda, “Autonomy for the Northern part of Kosovo: Unfolding scenarios and regional consequences” [“Autonomia për pjesën Veriore të Kosovës: Shpalosja e skenareve dhe pasojat rajonale”], KIPRED Nr 2012/05, korrik 2012, http://www.kipred.org/advCms/documents/46046_Autonomy%20for%20the%20northern%20part%20of%20Kosovo%20-%20Unfolding%20scenarios%20and%20regional%20consequences.pdf.

¹¹⁵ “Adopting consensus resolution, General Assembly acknowledges world court opinion on Kosovo, welcomes European Union readiness to facilitate process of dialogue” [“Duke e përvetësuar rezolutën e konsensusit, Asambleja e Përgjithshme e pranon opinionin e gjykatës botërore për Kosovën, dhe e mirëpret gatishmërinë e Unionit Evropian për ta ndihmuar procesin e dialogut”], Mbledhja plenare e Asamblesë së Përgjithshme.

¹¹⁶ “Serbia to lobby against Prishtina’s membership in international organizations” [“Serbia duhet të llojë kundër anëtarësisë së Prishtinës në organizatat ndërkombëtare”], qasur më 5 shkurt, 2014, <http://www.balkan.eu.com/serbia-lobby-pristinas-membership-international-organizations/>.

¹¹⁷ Serbia’s, stern diplomacy rearguard action over Kosovo” [“Veprimi praparojë rreth Kosovës i diplomacisë së rreptë të Serbisë”], The Telegraph Blog, qasur më 24 dhjetor, 2013, <http://blogs.telegraph.co.uk/news/charlescrawford/100164810/serbias-stern-diplomatic-rearguard-action-over-kosovo/>.

e Metohisë është pjesë e Republikës së Serbisë që për momentin është nën administrimin e Kombeve të Bashkuara në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë (1999)”¹¹⁸ Prandaj, Serbia i bojkotoi votimet për anëtarësimin e Kosovës në FMN dhe në Bankën Botërore të 3 majit 2009 dhe të 3 korrikut 2009 respektivisht.

Së fundi, dialogu i ndihmuar nga UE-ja midis Kosovës dhe Serbisë, në të cilin Kosova ka hyrë me shpresa që ta forcojë legjitimitetin e vet ndërkombëtar duke e rritur numrin e njohjeve dhe të anëtarësimeve në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, nga njëra anë, dhe në të cilin Serbia ka hyrë me shpresë që do ta zgjidhë çështjen e statusit përfundimtar të Kosovës përmes negociatave, nuk është përkrahur njëjtë nga të gjitha vendet fqinje. Der më tash, në mesin e shteteve fqinje të Kosovës, Shqipëria ka qenë një nga përkrahësit më të fuqishëm të këtyre negociatave. Megjithatë, në këto negociata, Shqipëria nuk ka shkuar përtej ofrimit të një përkrahjeje retorike, që don të thotë që nuk ka patur konsultim strategjik midis Kosovës dhe Shqipërisë rreth qasjes ndaj dialogut apo rreth përcaktimit të vijave të kuqe. Kjo mund të vërehet në disa aspekte. Së pari, disa muaj para fillimit të negociatave midis dy shteteve, zyrtarët e lartë të Shqipërisë e kanë inkurajuar dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, mirëpo në kushte të statuseve reciproke, si shtete sovraane, meqë Shqipëria konsideronte që kjo do të jetë një qasje e shëndetshme për paqen dhe stabilitetin rajonal.¹¹⁹ Kosova nuk hyri në negociata me një status reciprok, dhe Shqipëria vazhdoi ta përkrahte atë pa ofruar ndonjë përkrahje konkrete që do ta mundësonte dialogun në baza reciproke.

Së dyti, para se dialogu të fillonte më 8 mars 2011, zyrtarët e lartë të Kosovës i informuan zyrtarët e lartë të Shqipërisë që në bisedime asnjë herë nuk do të diskutohej statusi i Kosovës apo integriteti i saj territorial¹²⁰ dhe që ky do të jetë një dialog teknik në të cilin do të diskutoheshin çështjet teknike me qëllim që të lehtësohet jeta e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe e qytetarëve të Republikës së Serbisë, gjë të cilën Shqipëria e përkrahu.¹²¹ Kosova filloi t'i negocionte çështjet e veta të brendshme dhe rirregullimin e vet dhe shkoi përtej lehtësimit të jetës së qytetarëve në të dyja anët e kufirit, dhe dialogu politik i cili kulmoi me Marrëveshjen e Parë për Normalizimin e Marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë dolën që të kenë të bëjnë vetëm me çështjet e brendshme të Kosovës, dhe Shqipëria këtë e përkrahu pa ndonjë këshillë alternative për Kosovën.¹²² Shqipëria vetëm vazhdonte ta merrte qëndrimin e Kosovës dhe të argumentonte që dialogu është i mirë për Kosovën dhe për integritet euroatlantike të saj.^{123and124}

¹¹⁸ “Agreement of the IMF” [“Marrëveshja e FMN”], Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës, qasur më 20 janar, 2014, <http://www.minbuza.nl/en/key-topics/treaties/search-the-treaty-database/1945/12/006615.html?printpart=reservations>

¹¹⁹ Fjala e Bamir Topit në takimin e udhëheqësve rajonalë në Prevallë/Prizren, më 26 korrik 2010, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1149>.

¹²⁰ Deklaratë e Presidentit Pacolli në takimin me Sali Berishën më 21 mars 2011, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,1648> dhe deklaratë e Presidentes Jahjaga në takimin me Presidentin Topi më 29 maj, 2011, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1808>.

¹²¹ “President Atifete Jahjaga met and discussed with many heads of states participating at the Summit of Central European leaders” [Presidentja Atifete Jahjaga takohet dhe diskuton me krerët të shumtë të shteteve që merrnin pjesë në Samitin e udhëheqësve të Evropës Qendrore], qasur më 20 dhjetor, 2013, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1815> dhe <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1808>.

¹²² Takimi midis Thaçit dhe MPJ Aldo Bumci më 24 prill 2013, qasur më 20 dhjetor, 2013, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,3504>.

¹²³ Deklaratë e Ministrisë të Punëve të Jashtme Hoxhaj në takimin me Ministrin e Punëve të Jashtme Bumci më 24 prill 2013, qasur më 20 dhjetor, 2013, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,4,1665&offset=1>.

¹²⁴ Deklaratë e Jahjagës në takimin me Ministrin e Punëve të Jashtme Aldo Bumci më 25 prill 2013, qasur më 20 dhjetor, 2013, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,2848>.

Maqedonia dhe Mali i Zi, si dy vende të tjera fqinje të Kosovës, nga ana tjetër, nuk ishin, as aq entuziaste sa ishte Shqipëria lidhur me dialogun, dhe as nuk u përpoqën të jipnin pohime të mëdha lidhur me këtë çështje. Edhe Maqedonia, edhe Mali i Zi e kishin një përkrahje të përgjithshme për zgjidhjen e problemeve përmes negociatave, dhe është Kosova ajo që ka qenë më aktive në informimin e fqinjve të vet në takimet e ndryshme lidhur me progresin e dialogut.¹²⁵ Sa i përket Maqedonisë dhe Malit të Zi, dialogu midis Kosovës dhe Serbisë përmendëj përgjithësisht në formate multilaterale si një çështje që do të kalonte pa ndonjë theks të veçantë.¹²⁶

2.3 Intensiteti i marrëdhënieve me shtetet fqinje

2.3.1 Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Shqipëria

Në mesin e katër shteteve fqinje, Shqipëria është i vetmi me të cilin Kosova ka marrëdhënie bilaterale *shumë intensive*. Në fakt, Shqipëria është i vetmi shtet në të tërë rajonin me të cilin Kosova ka marrëdhënie *shumë intensive*. Këto marrëdhënie shumë intensive përftohen nga aktiviteti i tërësishëm bilateral midis Kosovës dhe Shqipërisë nga aspekti i takimeve dhe vizitave në nivelet presidenciale, kryeministrorë dhe të ministrave të jashtëm, njësoj si dhe nga ai i aktiviteteve ekonomike dhe tregtare midis dy shteteve. Që nga Shpallja e Pavarësisë në shkurt 2008, janë bërë rreth 40 vizita dhe takime të ndërsjella në të dyja anët e kufirit. Kosova ka qenë paksa më aktive në bërjen e vizitave në Shqipëri në nivelet e sipërpërmendura, se e anasjellta. Brenda një periudhe pak më të gjatë se pesë vjet (midis

	Shteti	Pikë	Intensiteti
1	Shqipëria	3.75	Shumë Intensive
	Turqia	2.25	Intensive
3	Maqedonia	2.00	Pak Intensive
	Kroacia	2.00	Pak Intensive
	Slovenia	2.00	Pak Intensive
	Bullgaria	1.00	Pak Intensive
	Greqia	1.00	Pak Intensive
8	Serbia	1.00	Pak Intensive
9	Mali i Zi	0.75	Joaktive
	BH	0.50	Joaktive
	Rumania	0.00	Joaktive

17 shkurtit 2008 dhe 30 shtatorit 2013), janë bërë 16 vizita presidenciale, nga të cilat 11 janë bërë në Shqipëri dhe 5 në Kosovë. Që nga momenti kur e mori postin më 7 prill 2011, Presidentja e tashme e Kosovës, Atifete Jahjaga, u takua me Presidentët e Shqipërisë më tepër se të gjithë pararendësit e saj së bashku, 7 herë në total brenda rreth dy vitesh e gjysmë të shërbimit të saj.¹²⁷ Pos takimeve bilaterale, Presidentët e Kosovës dhe të Shqipërisë janë takuar po ashtu në takimet multilaterale në New York, në sesionet e Kombeve të Bashkuara, si dhe në takimet dhe forumet e tjera rajonale. Në tërësi, presidentët e Kosovës e kanë vizituar Shqipërinë dy herë më shumë se e anasjellta.

Kur fjala vjen te takimet dhe vizitat qeveritare, është bërë një total prej 23 takimesh brenda periudhës prej më tepër se pesë vitesh (midis 17 shkurtit 2008 dhe 30 shtatorit 2013). Trembëdhjetë nga takimet qeveritare janë bërë në nivel kryeministror, dhe 10 të tjera në nivel të ministrave të jashtëm. Të gjitha takimet në nivelin kryeministror, pos njërit prej tyre, janë bërë midis Kryeministrit të tashëm të Kosovës, Hashim Thaçit, që ka qenë Kryeministër që nga koha kur Kosova e shpalli

¹²⁵ “President Jahjaga received a delegation of the Parliamentary Committee on European Integration of Macedonia” [“Presidentja Jahjaga e pranoi delegacionin e Komitetit Parlamentar për Integrimin Evropian të Maqedonisë”], qasur më 21 dhjetor, 2013, <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.2878>.

¹²⁶ “Presidents Sejdiu, Topi, Ivanov and Vujanovic held a press conference after the meeting in Vlora” [“Presidentët Sejdiu, Topi, Ivanov dhe Vujanoviq e japin një konferencë për shtyp pas takimit në Vlorë”], qasur më 22 dhjetor, 2013, <http://www.president-ksgov.net/?page=2.6.416>, <http://www.president-ksgov.net/?page=2.6.1149>.

¹²⁷ Shih të gjitha takimet, qasur më 24 nëntor, 2013, <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.846>, <http://www.president-ksgov.net/?page=2.6.415>, <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.1263>, <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.1516>, <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.1647>, <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.454>, <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.2417>, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2.9.3042>.

pavarësinë, dhe ish-Kryeministrit të Shqipërisë, i cili e humbi postin e vet nga Edi Rama në zgjedhjet e fundit të përgjithshme të korrikut 2013.¹²⁸ Edi Rama, Kryeministri i tashëm i Shqipërisë e ka vizituar Kosovën më 13 shtator 2013, një kohë të shkurtër pasi që e mori postin.¹²⁹ Kryeministri e Kosovës e ka vizituar Shqipërinë 7 herë, ndërkohë që kryeministri i Shqipërisë e ka vizituar Kosovën 6 herë; pos kësaj, ata janë takuar edhe në takimet multilaterale.

Për dallim nga takimet presidenciale dhe kryeministore, në të cilat Kosova ka qenë më aktive në vizitat e bëra në Shqipëri, në rastin e takimeve dhe vizitave në nivelin e ministrave të jashtëm, Shqipëria ka qenë më aktive në vizitat e bëra në Kosovë. Gjatë periudhës prej pak më shumë se pesë vitesh, ministrat e jashtëm të Shqipërisë e kanë vizituar Kosovën 6 herë, ndërkohë që ministrat e jashtëm të Kosovës Shqipërinë e kanë vizituar dy herë, dhe kanë ndodhur edhe dy takime të tjera shtesë në formatin multilateral.¹³⁰

Natyra e takimeve midis zyrtarëve të lartë të Kosovës dhe të Shqipërisë është më tepër ekonomike si dhe politike. Këto takime intensive kanë përfshirë po ashtu çështje lidhur me problemet e përbashkëta me të cilat përballen të dyja shtetet, dhe në veçanti bashkëpunimin që duhet të bëhet për të përparuar në fushën e luftës kundër kontrabandës ndërkufitare dhe krimit të organizuar, të cilat janë po ashtu ndër kushtet që të dyja shtetet duhet t'i plotësojnë ashtu që të përparojnë në procesin drejt hyrjes në UE.¹³¹

Pos veprimtarisë tejet intensive bilaterale nga aspekti i vizitave dhe takimeve midis dy shteteve, vëllimi tregtar është një aspekt tjetër që i kontribuon mbajtjes së marrëdhënieve tejet intensive. Vëllimi mesatar tregtar vjetor brenda periudhës 2008-2012 ka qenë rreth 110 milionë €, dhe ky ka qenë vazhdimisht në rritje; 80 milionë në vitin 2008, dhe deri në rreth 150 milionë në vitin 2010, dhe kjo rritje vazhdon.¹³² Prandaj, është e qartë që marrëdhëniet tejet intensive bilaterale midis Kosovës dhe Shqipërisë janë rezultat i angazhimeve intensive, si politike, ashtu edhe ekonomike; edhe pse, aktiviteti politik është dukshëm më i fuqishëm se ai ekonomik.

2.3.2 Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Maqedonia

Në mesin e katër shteteve fqinje, Maqedonia me Kosovën ka marrëdhënie bilaterale vetëm *pak intensive*. Këto marrëdhënie pak intensive përftohen nga aktiviteti i tërësishëm bilateral midis Kosovës dhe Maqedonisë nga aspekti i takimeve dhe vizitave në nivelet presidenciale, kryeministore dhe të ministrave të jashtëm – që nuk janë bindëse për vende fqinje – si dhe nga ai i aktivitetit ekonomik dhe tregtar midis dy shteteve. Që nga Shpallja e Pavarësisë në shkurt 2008, janë bërë rreth 11 vizita dhe takime nga të dyja anët e kufirit, dhe kjo është vetëm afër çerekut të vizitave dhe takimeve të ndërsjella që janë bërë midis Kosovës dhe Shqipërisë. Njësoj si dhe në rastin e Shqipërisë, zyrtarët e

¹²⁸ Shih të gjitha takimet, qasur më 24 nëntor, 2013, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,256>, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,3733>, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,652>.

¹²⁹ “Kryeministri Hashim Thaçi e pranon Kryeministrin e Shqipërisë Edi Ramën”, qasur më 24 nëntor, 2013, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,3752>.

¹³⁰ Shih të gjitha takimet, qasur më 24 nëntor, 2013, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,4,44&offset=1>, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,4,1483&offset=3>, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,654>, and <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,2848>.

¹³¹ “Kryeministri Thaçi e pret Ministrin e Brendshëm të Shqipërisë, Bujar Nishanin: Prioritetet tona të përbashkëta në luftën kundër krimit të organizuar”, qasur më 25 nëntor, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,220>.

¹³² Publikimet për tregtinë e jashtme, Zyra e Kryeministrit, Agjencioni Kosovar për Statistika, qasur më 20 janar, 2014, http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/14-tregtia-e-jashtme.

Kosovës kanë bërë më shumë vizita në Maqedoni se e anasjelltë. Kjo pjesërisht ka të bëjë me faktin që një numër i vizitave janë bërë midis zyrtarëve të Kosovës dhe përfaqësuesve të komunitetit shqiptar në Maqedoni.

Brenda periudhës pak më të gjatë se pesë vjet (midis 17 shkurtit 2008 dhe 30 shtatorit 2013), janë bërë vetëm 3 vizita presidenciale, nga të cilat 2 janë bërë në Maqedoni dhe vetëm 1 në Kosovë; megjithatë asnjëra nga vizitat presidenciale për nga natyra nuk ka qenë bilateralisht vetëm zyrtare.¹³³ Ndërkohë që një nga takimet e para presidenciale midis Kosovës dhe Maqedonisë do të ndodhte në Shkup, kjo e fundit e ndryshoi karakterin e vizitës nga zyrtare në jozyrtore, dhe si reagim, Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, e anuloi takimin.¹³⁴ Shumica e takimeve midis zyrtarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë kishte karakter multilateral, apo, më parë, trelateral, ku homologët e Shqipërisë ishin po ashtu të pranishëm në shumicën e takimeve që ishin bërë midis Kosovës dhe Maqedonisë. Për shembull, në vitin 2009, gjatë vizitës Maqedonisë, Presidenti i Kosovës ishte i shoqëruar edhe nga Presidenti i Shqipërisë.¹³⁵ Po ashtu, e vetmja vizitë që ndodhi në vitin 2010 në Kosovë në nivelin presidencial midis dy shteteve, ishte e një natyre trelaterale, meqë Presidenti i Maqedonisë ishte i shoqëruar po ashtu nga Presidenti i Shqipërisë.¹³⁶

Kur kemi të bëjmë me takimet dhe vizitat qeveritare, brenda periudhës pak më të gjatë se pesë vjet (midis 17 shkurtit 2008 dhe 30 shtatorit 2013) kanë ndodhur vetëm 8 takime. Njësoj si te vizitat presidenciale, vizitat kryeministore, për shembull, ishin, ose jozyrtare, ose private, ose të një natyre multilaterale. Ishin vetëm dy vizita në nivel kryeministor, dhe që të dyjat ishin bërë nga Kryeministri i Kosovës; e para ishte një vizitë jozyrtare në vitin 2009, ku ai u takua me zyrtarë politikë shqiptarë, dhe e dyta ishte një vizitë jozyrtare në Shkup, së bashku me Kryeministrin e Shqipërisë, në shënim të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, ku ata u takuan me zyrtarë politikë shqiptarë në Maqedoni që ishin duke e kremtuar këtë ngjarje edhe vetë.¹³⁷ Nga ana tjetër, Kryeministri i Maqedonisë, që ishte i vetmi në këtë post që nga Shpallja e Pavarësisë në vitin 2008, Nikolla Gruevski, asnjë herë nuk e bëri asnjë vizitë në Kosovë. Një vizitë zyrtare ishte e planifikuar për nëntorin e vitit 2012, por kjo u shty, siç u tha, për shkak të mospërputhjes me orarin sipas kabinetit të Kryeministrit të Kosovës.¹³⁸ Mirëpo, Gruevski është i njohur për prirjet politike kah e djathta e theksuar, dhe shumë herë ai është parë, dhe është akuzuar, për albanofobi.¹³⁹ Për shembull, gjatë vargut të tashëm të bllokadave midis dy shteteve, Zëvendës Kryeministri i Kosovës, Hajredin Kuçi ka pohuar që “Gruevski është streha e fundit e nacionalizmit që ka mbetur në rajon. Madje edhe ata në Beograd kanë ndryshuar.”¹⁴⁰ Njësoj si edhe me vizitat presidenciale, është e qartë që Maqedonia ka patur marrëdhënie më skeptike dhe

¹³³ President of the Republic of Kosovo, News and Events, [Presidenti i Republikës së Kosovës, Lajme dhe Ngjarje] në, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6>

¹³⁴ <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,685>.

¹³⁵ “Sejdiu, Topi e Ivanov takohen në Ohër, diskutojnë për bashkëpunimin rajonal”, në <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,324>.

¹³⁶ “President Atifete Jahjaga was on a private visit to Macedonia, there where no official meetings or statements” [“Presidentja Atifete Jahjaga ishte në një vizitë private në Maqedoni, nuk kishte takime apo deklarata zyrtare”], qasur më 25 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1797>.

¹³⁷ Shih vizita në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,162> dhe <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,3234>

¹³⁸ “PM Gruevski skips the visits in Prishtina” [“Kryeministri Gruevski e shmang vizitën në Prishtinë”], qasur më 15 janar, 2014, <http://www.albaniapress.com/lajme/18321/Kryeministri-Nikolla-Gruevski-anashkalon-vizitat-ne-Prishtine.html>.

¹³⁹ “PM Gruevski skips the visits in Prishtina”, [“Kryeministri Gruevski e shmang vizitën në Prishtinë”], qasur më 15 janar, 2014, <http://zhurnal.mk/content/?id=1351704903>

¹⁴⁰ Deklaratë e Zëvendës Kryeministrit Hajredin Kuçi në Info Magazine Show. Klan Kosova, 10 shtator, 2013 <http://www.klankosova.tv/index.php/informacion/info-magazine?start=95>

më të përmbajtura kur puna ishte te përparimi i marrëdhënieve më intensive dhe më të hapura midis dy shteteve.

Ministrat e jashtëm të të dyja shteteve janë takuar gjashtë herë, nga tre herë në çdonjërin anë të kufirit. Vizita e fundit e Ministrit të Punëve të Jashtme të Maqedonisë është bërë më 21 tetor 2011, dhe që nga atëherë nuk ka patur ndonjë vizitë tjetër, ndërkohë që Ministri i Jashtëm i Kosovës e ka vizituar Maqedoninë për herë të fundit më 24 korrik 2013.¹⁴¹ Çështjet më të diskutuara midis zyrtarëve në të dyja anët e kufirit janë pak a shumë çështje që kanë të bëjnë me prioritetet dhe qëllimet përkatëse të politikave të jashtme. Kësisoj, zyrtarët në të dyja anët e kufirit i theksojnë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe qëllimin e përbashkët për integrimin euroatlantik, si dhe asistencën që Maqedonia mund ta ofrojë me mësimet e mësuara sa i përket liberalizimit të vizave.¹⁴² Janë bërë po ashtu edhe takime të formatit multilateral midis palëve dhe këtu vazhdimisht ritheksohen politikat dhe qëllimet përkatëse të jashtme dhe rajonale të tyre.

Është evidente që marrëdhëniet pak intensive përftohen nga aktiviteti tejet i ulët midis dy shteteve; megjithatë, ajo që e ruan intensitetin e marrëdhënieve bilaterale në këtë nivel janë marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare. Maqedonia është partneri i parë tregtar i Kosovës, dhe kjo i tejkalon 350 milionë € në vit.¹⁴³

2.3.3 Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Mali i Zi

Në mesin e katër shteteve fqinje, Mali i Zi nuk ka marrëdhënie shumë intensive me Kosovën; marrëdhëniet mbeten pak a shumë *joaktive*. Në të vërtetë, Kosova ka marrëdhënie më intensive me tetë shtetet e tjera të rajonit, përfshirë Greqinë dhe Serbinë si vende mosnjohëse, sesa me fqinjin Malin e Zi. Marrëdhëniet joaktive përftohen nga mosaktiviteti i përgjithshëm bilateral midis Kosovës dhe Malit të Zi nga aspekti i takimeve dhe vizitave në nivelet presidenciale, kryeministore dhe të ministrave të jashtëm – të cilat nuk janë bindëse për një vend fqinj, si dhe nga aktiviteti ekonomik dhe tregtar midis dy shteteve. Që nga Shpallja e Pavarësisë në shkurtin 2008, janë bërë vetëm 6 vizita dhe takime të ndërsjella në të dyja anët e kufirit, që është pothuaj dy herë më pak se me Maqedoninë, dhe rreth 7 herë më pak se ato me Shqipërinë. Takimet janë bërë në mënyrë të barabartë – 3 herë në të dyja anët e kufirit.

Brenda periudhës pak më të gjatë se pesë vjet (midis 17 shkurtit 2008 dhe 30 shtatorit 2013), janë bërë vetëm dy vizita presidenciale, nga të cilat një është bërë në Mal të Zi dhe tjetra në Kosovë. Takimi i parë që u bë në nivel presidencial ishte më 2010, kur Presidenti i Malit të Zi Filip Vujanović¹⁴⁴ e vizitoi Kosovën; ndërkaj, Presidenti i Kosovës e vizitoi Malin e Zi në vitin 2012, më tepër se katër vjet e gjysmë pas shpalljes së pavarësisë.¹⁴⁵

¹⁴¹ Shih vizitat në <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,2414> and <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,1304&offset=60>

¹⁴² <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,451&offset=1>.

¹⁴³ “Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [“Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare”], KIPRED, 26-29.

¹⁴⁴ “President Sejdiu holds bilateral meetings with Presidents Ivanov, Topi and Vujanovic” [“Presidenti Sejdiu bën takime bilaterale me presidentët Ivanov, Topi dhe Vujanović”], qasur më 13 nëntor, 2013, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1149>.

¹⁴⁵ “Sejdiu: Kosovo and Montenegro have European perspective” [“Sejdiu: Kosova dhe Mali i Zi kanë perspektivë evropiane”], qasur më 13 nëntor, 2013, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,666>.

Kur fjala është për takimet dhe vizitat qeveritare, është bërë një total prej vetëm 4 takimesh brenda periudhës pak më të gjatë se pesë vjet. Një nga to ishte në nivel kryeministral, kur Kryeministri i Kosovës e vizitoi Malin e Zi në korrik 2010¹⁴⁶ që ishte hera e parë dhe e fundit deri më tash, ndërkaq, vizitë zyrtare në Kosovë nga Kryeministri i Malit të Zi nuk ka patur. Ngjashëm, Ministri i Jashtëm i Kosovës e ka vizituar Malin e Zi dy herë, një herë¹⁴⁷ në qershor 2011,¹⁴⁸ dhe një herë në janar 2011.¹⁴⁹ Ndërkaq, Ministri i Jashtëm malazet e ka vizituar Kosovën vetëm një herë në maj 2011.¹⁵⁰

Ngjashëm me çështjet që janë diskutuar me Maqedoninë, çështjet në rendin e ditës midis Kosovës dhe Malit të Zi kanë të bëjnë me qëllimet e përbashkëta për procesin e integritimit euroatlantik si dhe me zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore. Disa çështje të hapura që janë diskutuar po ashtu, janë ato të demarkacionit të kufirit, të cilin të dy ministrat e jashtëm në njërin nga takimet u pajtuan ta kompletojnë deri në fundin e vitit 2013,¹⁵¹ njësoj si dhe të njohjes së malazetëve si një komunitet me të gjitha të drejtat kushtetutare, të barabarta me komunitetet e tjera në Kosovë.¹⁵²

Ajo që i kontribuon më tutje marrëdhënieve jo aq aktive të Kosovës me Malin e Zi është intensiteti i ulët i marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare. Mali i Zi është partneri tregtar i 10-të i Kosovës në mesin e të gjitha shteteve të rajonit, menjëherë mbi Rumaninë.¹⁵³ Vëllimi mesatar total tregtar brenda viteve 2008-2012 ishte përafërsisht 19 milionë €. ¹⁵⁴ Vëllimi më i ulët tregtar brenda kësaj periudhe ishte në vitin 2010 – përafërsisht 15 milionë €, ndërsa, ai më i larti ishte në vitin 2012 – përafërsisht 27 milionë €. ¹⁵⁵

2.3.4 Intensiteti i marrëdhënieve/kontakteve bilaterale – Kosova dhe Serbia

Edhe përkundrejt asaj që Serbia nuk e ka njohur Kosovën dhe është njëri nga shtetet që e sfidon ekzistencën si dhe legjitimitetin e saj ndërkombëtar në çdo hap, Kosova dhe Serbia kanë ruajtur marrëdhënie/kontakte *pak intensive*. Serbia nga aspekti i intensitetit të marrëdhënieve/kontakteve të saj me Kosovën renditet më mirë vetëm se Mali i Zi, BH dhe Rumania, dhe është në nivel të njëjtë me Greqinë dhe Bullgarinë. Veças nga marrëdhëniet/kontaktet intensive në nivel multilateral, dhe nga kontaktet kryesisht intensive qeveritare në Bruksel si pjesë e dialogut të ndihmuar nga UE-ja, nga aspekti bilateral nuk ka patur çfarëdo qoftë kontaktesh, as zyrtare, as private, midis zyrtarëve të Kosovës dhe të Serbisë. Shumica dërrmuese e vizitave midis dy palëve ndodhën në Bruksel, edhe

¹⁴⁶ “Prime Minister Hashim Thaçi met with the former Prime Minister of Montenegro, Milo Gjukanović, and the Prime Minister of Albania, Sali Berisha” [“Kryeministri Hashim Thaçi u takua me ish Kryeministrin e Malit të Zi, Milo Gjukanović, dhe me Kryeministrin e Shqipërisë, Sali Berisha”], qasur më 15 nëntor, 2013, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,2156>.

¹⁴⁷ Gjatë vizitës së parë të Z. Hoxhaj, në takim nuk kishte flamur të Kosovës, dhe gjatë deklaratës për shtyp kishte protesta kur Z. Hoxhaj foli në gjuhën shqipe.

¹⁴⁸ “Hoxhaj and Rocen sign three cooperation agreements” [“Hoxhaj dhe Rocen i nënshkruajnë tre marrëveshje bashkëpunimi”], qasur më 20 nëntor, 2013, <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,833&offset=1>.

¹⁴⁹ “Ministri Hoxhaj vizitë zyrtare në Mal të Zi”, qasur më 22 nëntor, 2013, <http://www.indeksonline.net/?PageID=2&LajmID=13540>

¹⁵⁰ “Reciprocal support between Kosovo and Montenegro for integration” [“Përkrahja reciproke midis Kosovës dhe Malit të Zi për integritet”], qasur më 15 nëntor, 2013, <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,782&offset=1>.

¹⁵¹ “Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi brenda këtij viti”, qasur më 20 nëntor, 2013, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,4,1802&offset=2>

¹⁵² “Presidentja Jahjaga meets the Minister of Foreign Affairs of Montenegro, Rocen” [“Presidentja Jahjaga takohet me Ministrin e Punëve të Jashtme të Malit të Zi, Rocen”], qasur më 20 nëntor, 2013, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,1801>.

¹⁵³ “Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [“Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare”], KIPRED.

¹⁵⁴ “Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [“Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare”], KIPRED, 26-29.

¹⁵⁵ Publikimet për tregtinë e jashtme, Zyra e Kryeministrit, Agjencioni Kosovar i Statistikës, qasur më 20 janar, 2014, http://esk.rks.gov.net/publikimet/cat_view/14-tregtia-e-jashtme.

përkundrejt disa vizitave të herëpashershme private të zyrtarëve të Serbisë në Kosovë për qëllime fetare dhe politike, kur ata takoheshin me përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë.¹⁵⁶

Brenda periudhës prej pak më shumë se pesë vitesh (midis 17 shkurtit 2008 dhe 30 shtatorit 2013), apo, më konkretisht, brenda 2 vitesh e gjysmë kur janë vendosur kontaktet midis dy palëve, në nivelin presidencial, kryeministrot dhe të ministrave të jashtëm kanë ndodhur rreth 17 takime. Nga të gjitha këto takime, 16 janë bërë midis kryeministrave të të dyja shteteve, takime këto që ndodhën që të gjithat në Bruksel, dhe brenda një periudhe prej vetëm një viti (midis tetorit 2012 dhe shtatorit 2013). Para se të fillonte dialogu, Serbia kishte refuzuar të ulej në çfarëdo takimi multilateral, rajonal apo ndërkombëtar, në të cilin do të merrte pjesë edhe Kosova. Kjo vazhdoi madje edhe pasi që dialogu ndërmjet dy palëve kishte filluar – deri kur u arrit marrëveshja për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal të Kosovës më 24 shkurt 2012.¹⁵⁷ Kjo marrëveshje, megjithatë, është treguar se nuk mund ta garantojë gjithmonë pjesëmarrjen e Serbisë, meqë prania e Kosovës është kundërshtuar nga Serbia mbi bazën që Kosova nuk është e përfaqësuar me të tërë fusnotën për të cilën ata gjoja se ishin pajtuar. Paaftësia e kësaj marrëveshjeje për ta garantuar zgjidhjen e mospajtimeve midis palëve, si dhe paaftësia e UE-së për ta garantuar zbatimin e marrëveshjes, ishte treguar më së miri kur Maqedonia nuk e ftoi Kosovën në Samitin e PBEJL-së që u mbajt në Ohër me 1 dhe 2 korrik 2013, me gjasë për shkak të Serbisë dhe të disa vendeve të tjera mosnjohëse të rajonit. Telashet e Kosovës lidhur me përfaqësimin rajonal, si dhe kundërshtimet e vazhdueshme të Serbisë lidhur me përfaqësimin e Kosovës si palë në forumet dhe organizatat rajonale ndodhnin ndërkohë që dialogu midis kryeministrave, si dhe në nivele të tjera teknike të qeverisjes, ishte në rrjedhje e sipër.

Ajo që i kontribuon marrëdhënieve *pak intensive* midis Kosovës dhe Serbisë, në mungesë të marrëdhënieve bilaterale në nivelin politik, është vëllimi i shkëmbimit tregtar. Serbia është partneri i dytë tregtar i Kosovës, menjëherë pas Maqedonisë. Vëllimi vjetor i tregtisë midis dy shteteve ka qenë duke u rritur vazhdimisht, dhe në vitin 2012 ka arritur rreth 292 milionë €. ¹⁵⁸

¹⁵⁶ Zyra e UE-së në Kosovë është kontaktuar lidhur me vizitat private të zyrtarëve serbë që kanë ndodhur në Kosovë, mirëpo deri në kohën e publikimit të këtij raporti nuk është marrë përgjigje nga ajo.

¹⁵⁷ “Serbia Leaves Regional Summit over Kosovo” [“Serbia e braktis samitin rajonal për shkak të Kosovës”], Balkan Insight, 21 maj, 2008, <http://www.balkaninsight.com/en/article/serbia-leaves-regional-summit-over-kosovo>.

¹⁵⁸ “Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [“Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare”], KIPRED, 26-29.

3 KOSOVA DHE VENDET E TJERA MOSNJOHËSE TË RAJONIT

3.1 Politikat e jashtme dhe rajonale

Vendet e rajonit që janë mosnjohëse të Kosovës përvetësojnë politika të ndryshme rajonale dhe të jashtme. Janë disa aspekte politike që këto i kanë të përbashkëta, mirëpo, për dallim nga vendet fqinje, shtetet mosnjohëse të rajonit kanë më tepër aspekte të politikës rajonale dhe të jashtme që janë të ndryshme nga njëri-tjetri. Arsyet kryesore për këtë janë të dyfishta. Së pari, duke patur vendndodhje të ndryshme gjeografike (BH në Ballkanin Perëndimor, Rumania në pjesën lindore të Ballkanit, Greqia në pjesën jugore të tij, ndërkaq, Serbia këtu përjashtohet meqë është shqyrtuar më heret), mosnjohësit e Kosovës në rajon nuk kanë kufij të përbashkët me njëri-tjetrin, dhe si të tillë, politikat e tyre rajonale dhe të jashtme jipen pas rrethanave të tyre të drejtpërdrejta fqinjësore dhe rajonale. Së dyti, politikat e tyre rajonale dhe të jashtme dallojnë meqë nga katër mosnjohësit e rajonit, dy janë shtete anëtare të UE-së, dhe kësaj udhëheqin politika tejet të ndryshme, dhe nuk i kanë të përbashkëta ambicjet dhe prioritetet e BH-ës për integrim në UE, për shembull, e të cilat do të diskutohen në këtë pjesë të këtij studimi.

Çdonjëri nga mosnjohësit e Kosovës në rajon promovon bashkëpunim me fqinjët e vet të drejtpërdrejtë. Për shembull, BH e promovon bashkëpunimin me fqinjët e vet të drejtpërdrejtë, më në veçanti me Kroacinë, Serbinë dhe Malin e Zi “në baza të interesit të përbashkët dhe parimeve të barazisë, të respektimit të ndërsjellë dhe të respektimit të sovranitetit dhe të integritetit territorial”.¹⁵⁹ Qëllim tjetër rajonal i BH-ës është t’i “intensifikojë aktivitetet bilaterale drejt vendeve në rajon me të cilat marrëdhëniet e tilla nuk janë vendosur ende”.¹⁶⁰ Marrëdhëniet bilaterale midis BH-ës dhe Kosovës nuk janë vendosur ende, dhe, edhe pse kjo do ta plotësonte njërin nga qëllimet e politikës së jashtme të BH-ës, kjo duket se nuk do të materializohet, meqë BH, përmes Republikës Serbe, e përcjell udhëheqjen e Serbisë sa herë që fjala vjen për Kosovën.

Greqia, për shembull, duke qenë njëri nga vendet rajonale si dhe njëri nga mosnjohësit e rajonit, i cili në të njëjtën kohë është anëtar, edhe i UE-së, edhe i NATO-s, e ka një politikë rajonale që, në përgjithësi, shkon kah konsolidimi i stabilitetit dhe të sigurisë në rajon.¹⁶¹ Për më tepër, synimi fundamental i Greqisë për rajonin është përfshirja e Ballkanit në institucionet evropiane dhe euroatlantike.¹⁶² Qëllim i Greqisë është që këto synime t’i arrijë përmes përfshirjes së rajonit në sa më shumë organizata rajonale dhe forume multilaterale që të jetë e mundshme.¹⁶³ Nga ana tjetër, Rumania, edhe pse është një shtet rajonal që është anëtar i UE-së dhe NATO-s, ka prioritetet e tjera kur krahasohet me Greqinë. Prioritetet rajonale të Rumanisë përqendrohen kryesisht në rajonin e Detit të Zi si dhe në përfshirjen e fqinjëve të vet të drejtpërdrejtë, Moldavisë, në nismat rajonale si dhe në procesin e pranimit në UE.¹⁶⁴ Synim i Rumanisë është që fqinjëritë e vet të drejtpërdrejtë ta mbajë stabile dhe të sigurtë duke i ndihmuar fqinjët e vet lindorë përmes institucioneve dhe politikave të

¹⁵⁹ “Basic Directions of BiH Foreign Policy” [“Drejtimet themelore të Politikës së Jashtme të BH-ës”].

¹⁶⁰ “Basic Directions of BiH Foreign Policy” [“Drejtimet themelore të Politikës së Jashtme të BH-ës”].

¹⁶¹ “Western Balkans” [“Ballkani Perëndimor”], Ministria e Punëve të Jashtme e Greqisë, qasur më 4 dhjetor, 2013, <http://www.mfa.gr/en/foreign-policy/regional-policy/western-balkans.html>.

¹⁶² “Ballkani Perëndimor”, MPJ, Greqi.

¹⁶³ “Ballkani Perëndimor”, MPJ, Greqi.

¹⁶⁴ “Chapter 21 – Romania’s Foreign Policy” [“Kapitulli 21 – Politika e Jashtme e Rumanisë”], Ministria e Punëve të Jashtme e Rumanisë, qasur më 6 dhjetor, 2013, <http://www.mae.ro/en/node/2144>.

UE-së, apo, më në veçanti, kjo synon ta bëjë këtë përmes Politikave Evropiane të Fqinjërisë dhe të Rritjes, si dhe nismave të tjera të jashtme multilaterale në kuadrin e UE-së.¹⁶⁵ Rumania po ashtu e përkrah perspektivën evropiane për shtetet e tjera në Ballkan që mbeten ende jashtë UE-së, përfshirë këtu edhe Moldavinë.¹⁶⁶

Sa i përket interesave të veçanta të politikave të jashtme të mosnjohësve të Kosovës, BH, për shembull, e mban synimin e vet për të qenë pjesë e strukturave euroatlantike, dhe e përqendron politikën e vet të jashtme në fuqitë kyçe në sistemin ndërkombëtar, si dhe në rajonet dhe organizatat e tjera multilaterale që janë në interesin e BH-ës. Synim i tanishëm i politikës së jashtme të saj është që ta mbrojë dhe ta implementojë në tërësi Marrëveshjen e Dejtonit – Marrëveshjen e Përgjithshme për Paqen, dhe që kësaj t'i zhvillojë marrëdhëniet bilaterale, dhe më në veçanti me “vendet anëtare të Bordit të Këshillit Mbikëqyrës të Implementimit të Paqes [si] SHBA-të, Federatën Ruse, Britaninë e Madhe, Francën, Kinën dhe vendet e tjera anëtare të Këshillit të Sigurimit të KB, [dhe] vendet anëtare të Unionit Evropian”.¹⁶⁷ Pos kësaj, BH synon të zhvillojë marrëdhënie bilaterale me “vendet anëtare të Organizatës së Konferencës Islamike dhe me vendet e tjera që në një mënyrë domethënëse i kontribuojnë rindërtimit dhe zhvillimit të BH-ës”.¹⁶⁸

Interesat e politikës së jashtme të Greqisë mbeten siguria dhe stabiliteti i të tërë Mesdheut, i zonave të Ballkanit dhe të Detit të Zi, të cilat, për Greqinë, janë të ndërthurrura.¹⁶⁹ Si e tillë, duke qenë shtet anëtar i UE-së, Greqia përpiket t'i shfrytëzojë institucionet dhe politikat e saj për t'i arritur disa nga qëllimet e politikës së vet të jashtme. Institucionet dhe politikat e UE-së janë të një interesi të veçantë për Greqinë kur fjala vjen për stabilizimin e fqinjërisë së vet (periferi evropiane) përmes integritetit në UE.¹⁷⁰ Nga aspekti i marrëdhënieve bilaterale dhe çështjeve të hapura, Greqia ia jep një rëndësi të veçantë marrëdhënieve të veta me FYROM-in (Maqedoninë), Turqinë dhe Qipron, ku këto dy të fundit janë duke u drejtuar përmes partneritetit të Greqisë me Turqinë në mekanizmat kolektiv të mbrojtjes që i ofron NATO-ja.¹⁷¹ Ngjashëm me Greqinë, Rumania përpiket t'i shfrytëzojë dhe t'i shtjerrojë sa më tepër që të jetë e mundshme benefitet që i ofron anëtarësia e saj në UE dhe në NATO për arritjen e qëllimeve të politikës së jashtme. Synimet e Rumanisë janë t'i forcojë marrëdhëniet e veta bilaterale me të gjitha Shtetet Anëtare të UE-së, por më në veçanti me vendet e Evropës Qendrore të tilla si “Hungaria, Polonia, Republika Çeke, Sllovakia, Shtetet Baltike dhe Bullgaria”.¹⁷² Rumania, si edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor i jep një hapësirë të rëndësishme Shteteve të Bashkuara në rendin e ditës së politikës së saj të jashtme, dhe synim i saj është ta ruajë partneritetin strategjik me SHBA-të, dhe të vendosë lidhje sa më të forta ekonomike dhe investive që të jetë e mundshme.¹⁷³ Së fundi, prioritetet e politikës së jashtme shkojnë përmes oqeanëve në shtetet në shfaqje, të tilla si Kina, India, Brazili, si dhe fuqitë e ngritura ekonomike të tilla si Japonia dhe Korea Jugore.¹⁷⁴

¹⁶⁵ “Chapter 21 – Romania’s Foreign Policy” [“Kapitulli 21 – Politika e Jashtme e Rumanisë”], MPJ, Rumani.

¹⁶⁶ “Chapter 21 – Romania’s Foreign Policy” [“Kapitulli 21 – Politika e Jashtme e Rumanisë”], MPJ, Rumani.

¹⁶⁷ “Basic Directions of BiH Foreign Policy” [“Drejtimet themelore të Politikës së Jashtme të BH-ës”].

¹⁶⁸ “Basic Directions of BiH Foreign Policy” [“Drejtimet themelore të Politikës së Jashtme të BH-ës”].

¹⁶⁹ “The Foreign Policy of Greece” [“Politika e Jashtme e Greqisë”], Ministria e Punëve të Jashtme e Greqisë, qasur më 17 dhjetor, 2013, http://video.minpress.gr/wwwminpress/aboutgreece/aboutgreece_foreign_policy.pdf.

¹⁷⁰ “The Foreign Policy of Greece” [“Politika e Jashtme e Greqisë”], MPJ, Greqi.

¹⁷¹ “The Foreign Policy of Greece” [“Politika e Jashtme e Greqisë”], MPJ, Greqi.

¹⁷² “Chapter 21 – Romania’s Foreign Policy” [“Kapitulli 21 – Politika e Jashtme e Rumanisë”], MPJ, Rumani.

¹⁷³ “Chapter 21 – Romania’s Foreign Policy” [“Kapitulli 21 – Politika e Jashtme e Rumanisë”], MPJ, Rumani.

¹⁷⁴ “Chapter 21 – Romania’s Foreign Policy” [“Kapitulli 21 – Politika e Jashtme e Rumanisë”], MPJ, Rumani.

3.2 Cilësia e marrëdhënieve me mosnjohësit e tjerë në rajon

3.2.1 Marrëdhëniet/kontaktet bilaterale me BH

BH është një nga katër shtetet e rajonit që nuk e njohin Kosovën si shtet të pavarur. Për këtë arsye BH dhe Kosova nuk kanë vendosur kurrfarë marrëdhëniesh bilaterale, dhe cilësia e marrëdhënieve të tyre, në tërësi, mbetet *e dobët*. Marrëdhëniet e dobëta të Kosovës me BH-ën përftohen nga rezultati i tërësishëm që BH e merr në aspektet fundamentale të marrëdhënieve/kontakteve të veta me Kosovën. Si pasojë e mosnjohjes, nuk ka marrëdhëni diplomatike midis dy shteteve, dhe, për këtë arsye, nuk ka, as prani diplomatike, as ndonjë përfaqësim në çfarëdo niveli në asnjërin nga dy shtetet, duke e bërë BH-ën mosnjohësin e vetëm në rajon që nuk ka kurrfarë pranie diplomatike në Kosovë.¹⁷⁵ Marrë në përgjithësi, BH është ndër vendet mosnjohëse me të cilat Kosova i ka marrëdhëniet më të dobëta, e cila, si rezultat, BH-ën e vë në fundin e listës së shteteve në të tërë rajonin sa i përket cilësisë së marrëdhënieve/kontakteve të veta me Kosovën.

Në mesin e mosnjohësve të rajonit, BH është i vetmi shtet që marrëdhëniet e veta me Kosovën i përcakton pothuaj në tërësi përmes lenteve të Serbisë. Mirëpo, të gjithë aktorët politikë në BH nuk e mbajnë të njëjtin qëndrim ndaj Kosovës. I vetmi përfaqësues bllokues në Presidencën e BH-ës është përfaqësuesi serb, ndërkohë që përfaqësuesit boshnjakë dhe kroatë e kanë mbajtur qëndrimin e tyre përkrahës ndaj pavarësisë së Kosovës, ku përfaqësuesi kroat ka deklaruar që ai “e përkrah integritetin dhe sovranitetin e Kroacisë dhe të Serbisë pa Kosovën”, gjë që i ka bërë plot veta t’i ngritin vetullat dhe e ka nxitur një mori reaksionesh në mesin e përfaqësuesve serbë.¹⁷⁶ Duke e patur parasysh që vendimet e saj për politikën e jashtme merren nga Presidenca e cila përbëhet nga përfaqësuesit e tre popujve përbërës të BH-ës (boshnjak, serb dhe kroat), dhe e kërkon miratimin e të tre përfaqësuesve, njohja, apo, të paktën, zbutja e marrëdhënieve midis Kosovës dhe BH-ës nuk ndodhë, për shkak të vetos së përfaqësuesit serb në Presidencë. Pozita e përfaqësuesit serb në Presidencë ndaj statusit final të Kosovës nuk nxitet nga ndonjë interes strategjik i BH-ës si të tërë, por është në pajtim me interesat e Serbisë.¹⁷⁷ Kësisoj, mosnjohja e Kosovës nga ana e BH-ës është më tepër rezultat i etno-politikës në rajon, se i ndonjë interesi të fortë të këtij shteti.

Cilësia e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet mosnjohëse të rajonit

Shteti	Pikë	Cilësia
Turqia	4.00	E shkëlqyer
Shqipëria	3.88	E shkëlqyer
Slovenia	3.25	Shumë e Mirë
Maqedonia	3.13	Shumë e Mirë
Kroacia	2.63	E Mirë
Bullgaria	2.75	E Mirë
Mali i Zi	1.88	Jo e Keqe
8 Serbia	0.75	E dobët
9 Greqia	0.25	E dobët
10 Rumania	0.13	E dobët
11 BH	0.00	E dobët

Në pajtim me politikën e Serbisë ndaj Kosovës, përfaqësuesit e serbëve të BH-ës në nivelin e Presidencës së saj, si dhe ata në Republikën Serbe, vazhdimisht do të tërheqin paralele midis pavarësisë së Kosovës dhe statusit “që mund të ndryshohet” të RS. Për serbët e BH-ës pavarësia e Kosovës shoqërohet me mundësinë për autonomi më të madhe për RS në shkëmbim, dhe, për këtë

¹⁷⁵ Rumania dhe Greqia i mbajnë Zyrat Ndërlidhëse në Prishtinë, ndërkohë që Serbia e mban Zyrтарin Ndërlidhës në Prishtinë, të vendosur në Zyrat e UE-së në Kosovë.

¹⁷⁶ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], International Conference to Launch Position Papers on Kosovo’s Relation with EU and Regional Non-Recognising Countries [Konferenca Ndërkombëtare do të nisë Punime të Qëndrimeve për marrëdhëniet e Kosovës me UE-në dhe me vendet rajonale mosnjohëse, 157, <http://kfos.org/wp-content/uploads/2012/04/Kosovo-Calling-ENG.pdf>.

¹⁷⁷ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 157-158.

arsye, serbët e BH-ës fuqinë e vet të vetos dhe mundësinë për të vendosur për çështjet e politikës së jashtme i mbajnë si një atu për ta përmirësuar statusin e tyre, nëse ndodhin lëvizje drejt njohjes së Kosovës.¹⁷⁸ Madje edhe Kryeministri i Serbisë, Vojislav Koshtunica, ka deklaruar që çkado qoftë që i jipet Kosovës, duhet të kompensohet ndaj RS.¹⁷⁹ Kjo bëhet edhe më evidente me faktin që BH nuk e ndryshon qëndrimin e vet ndaj Kosovës në tërësi çdo herë që Serbia e ndryshon atë; për shembull, janë disa marrëveshje të arritura midis Kosovës dhe Serbisë, ndër të cilat Serbia i njej dokumentet e udhëtimit të Kosovës, dokumentet e tjera të ndryshme, diplomat e universitetit, dhe të cilat BH nuk i ka përcjellur.¹⁸⁰ Mirëpo, UE-ja përpiqet ta ndikojë BH që ta ndryshojë qëndrimin e vet ndaj Kosovës, pos atë për njohje, apo që, të paktën, të veprojnë në pajtim me marrëveshjet që Serbia i ka arritur me Kosovën, por kjo nuk sjell ndonjë dobi. Arsyet për këtë janë të dyfishta. Së pari, UE-ja nuk ia ka dalë t'i bindë shtetet e veta mospranuese që të veprojnë në pajtim me marrëveshjet që Serbia i ka arritur me Kosovën (d.m.th., Rumaninë, Qipron, Spanjën, Sllovakinë dhe Greqinë – marrëdhëniet e tyre me Kosovën sa i përket cilësisë nuk janë as për së afërmi në nivelin e cilësisë së marrëdhënieve që Serbia i ka me Kosovën). Së dyti, UE-ja nuk ia ka dalë ta ndikojë elitën politike të BH-ës që të marrë, madje edhe qëllime “më të buta”, si pjesë e politikës së vet të kushtëzimit për t'u reformuar së brendshmi në shkëmbim për përfitime në procesin e pranimit; kësaj, shanset për UE-në që të jetë një palë kredibile në bindjen e BH-ës për ta ndryshuar qëndrimin e vet madje edhe fare pak ndaj Kosovës mbeten fare të dobëta.

Politika e BH-ës lidhur me lëvizjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës është diçka që i kontribuon më tutje cilësisë së dobët të marrëdhënieve midis dy shteteve. Pas Shpalljes së Pavarësisë dhe përvetësimit të pasaportave të reja të Republikës së Kosovës, autoritetet e BH-ës e kanë ndaluar lëvizjen për çdo qytetar të Kosovës që e ka pasaportën e re të Kosovës. Mosnjohja e pasaportave ishte e ndërlidhur me mosnjohjen e Kosovës si shtet.¹⁸¹ U nevojiti një trysni e madhe e UE-së në Ministrinë e Jashtme të BH-ës, ashtu që kjo ta shqyrtonte, dhe që më vonë ta përvetësonte, më tepër se dy vite pas Shpalljes së Pavarësisë, vendimin që do ta lejonte hyrjen e qytetarëve të Kosovës me pasaporta të reja, vetëm kur këta qytetarë të merrnin pjesë në “nisma të caktuara rajonale, për shembull në takimet e Këshillit Rajonal për Bashkëpunim, që është në Sarajevë”.¹⁸² Vendimi i marrë nga autoritetet e BH-ës më 8 maj 2010, e lejonte MPJ-në të lëshonte viza për qytetarët e Kosovës që kishin pasaporta të reja vetëm në raste të veçanta të cilat janë “të një interesi të veçantë për BH-ën”; dhe përmes kësaj, të gjitha aplikimet duhen të miratohen nga Këshilli i Ministrave të BH-ës.¹⁸³ Megjithatë, kjo nuk ndodhi deri më 8 mars 2012 (më tepër se 8 muaj pasi që Kosova dhe Serbia ishin pajtuar për lirinë e lëvizjes së njerëzve midis dy shteteve), kur Këshilli i Ministrave të BH-ës vendosi të lëshonte viza për qytetarët e Kosovës përmes ambasadave të veta në rajon, kësaj here pa kushtin paraprak që aplikimi duhet ta plotësonte sa i përket “interesit të veçantë për BH-ën”.¹⁸⁴ Kosova, nga ana tjetër, nuk zbaton kurfarë kufizimesh për hyrjen e qytetarëve të BH-ës në Kosovë.¹⁸⁵

¹⁷⁸ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 155.

¹⁷⁹ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 159.

¹⁸⁰ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 155.

¹⁸¹ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 155-161.

¹⁸² “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 161.

¹⁸³ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 161.

¹⁸⁴ “Bosnja nis lëshimin e vizave për Kosovarët”, qasur më 28 janar, 2014, <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,1583>.

¹⁸⁵ “Who doesn't need visa?” [“Kush nuk ka nevojë për viza?”], MPJ, Kosovë, qasur më 14 janar, 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=2,87>.

Së fundi, krahasuar me mosnjohësit e tjerë të cilët kanë vendosur, të paktën ndonjë lloj kontakti me Kosovën dhe, si rezultat i kësaj, kanë vendosur bashkëpunim në fusha të ndryshme përmes memorandumëve të mirëkuptimit, asgjë e këtij lloji nuk ndodhi asnjë herë me BH-ën.^{186dhe187}

3.2.2 Marrëdhëniet/kontaktet bilaterale me GREQINË

Greqia është një tjetër nga katër shtetet e rajonit që nuk e njohin Kosovën si shtet i pavarur. Për këtë arsye, Greqia dhe Kosova nuk kanë vendosur kurfarë marrëdhëniesh bilaterale, dhe cilësia e marrëdhënieve të tërësishme mbetet *e dobët*. Marrëdhëniet e dobëta të Kosovës me Greqinë përftohen nga rezultati i tërësishëm që Greqia e merr në aspektet fundamentale të marrëdhënieve/kontakteve të saj me Kosovën. Edhe pse e dobët, cilësia e marrëdhënieve të tërësishme midis Kosovës dhe Greqisë është më e mirë se marrëdhëniet e Kosovës me dy vendet e tjera mosnjohëse, domethënë, BH-ën dhe Rumaninë. Për dallim nga BH, Greqia e mban praninë e vet diplomatike përmes Zyres Ndërlidhëse, dhe është e përfaqësuar në nivelin e Zyrtares Ndërlidhëse. Kosova, nga ana tjetër, nuk ka ndonjë prani diplomatike në Greqi, gjë kjo që është për t'u habitur, meqë Greqia nuk e ka parandaluar në asnjë mënyrë praninë e mundshme të Kosovës në Athinë përmes Zyres Ndërlidhëse; mungesa e pranisë diplomatike të Kosovës në Greqi është më tepër për shkak të vendimit të Kosovës që të mos e vendosë një zyre të tillë ende. Autoritetet greke e kanë pohuar qartë që, po t'u kërkohet, ata do ta japin akreditimin për një prani diplomatike të Kosovës, jo si një ambasadë, por si një Zyre Ndërlidhëse.¹⁸⁸

Për dallim nga rasti i BH-ës, marrëdhëniet dhe pozita e Greqisë ndaj Kosovës nuk varen në tërësi dhe nuk janë të krijuara përmes lenteve të Serbisë. Qëndrimi zyrtar i Greqisë për Kosovën vendoset para së gjithash në pajtim me rendin e saj të ditës të politikës së jashtme për rajonin, i cili është stabiliteti i rajonit më të gjerë.¹⁸⁹ Prandaj, Greqia nuk e ka ndonjë politikë të rreptë dhe izolacioniste ndaj Kosovës, dhe, kësajsoj, kjo përpiket ta ruajë një barazpeshë korrekte midis Serbisë dhe Kosovës, për të cilën Greqia beson se i kontribuon stabilitetit rajonal.¹⁹⁰ Ruajtja e barazpeshës midis Prishtinës dhe Beogradit është e rëndësishme për Greqinë për shkak të ambicjeve të saj për të qenë një aktor i rëndësishëm rajonal. Me qëllim që ta mbajë këtë barazpeshë, Greqia, pak a shumë, e ka mbajtur politikën e vet ndaj Kosovës dhe Serbisë në pajtim me aktorët e tjerë kryesorë ndërkombëtarë, jo nga aspekti i statusit të Kosovës, por nga aspekti i asaj për të cilën Greqia beson se i kontribuon stabilitetit rajonal – e cila është dialogu i ndihmuar nga UE-ja midis Kosovës dhe Serbisë.¹⁹¹ Zyrarët e Greqisë tashmë e kanë deklaruar që ata “e përkrahin në tërësi dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës, që do të ndihmohet nga UE-ja, në pajtim me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të KB-ve të 9 shtatorit 2010, i cili është marrë pas Opinioneve të Këshillues relevant – të lëshuar më 22 korrik 2010 – nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë”.¹⁹²

¹⁸⁶ “Memorandum of understanding between the Kosovo accreditation directorate and Romanian accreditation association” [“Memorandum i mirëkuptimit midis drejtorisë kosovare të akreditimit dhe asociacionit rumun të akreditimit”], qasur më 8 janar, 2014, <http://www.mti-ks.org/en-us/Ministry-Trade-and-Industry-activities/Memorandum-of-Understanding-between-the-Kosovo-Accreditation-Directorate-and-Romanian-Accreditation-Association-2612-2612>.

¹⁸⁷ “Cooperation with Romania starts” [“Nis bashkëpunimi me Rumaninë”], qasur më 8 janar, 2014, <http://grid.al/read/news/155905558/2473996/nis-bashkepunimi-me-rumanine>.

¹⁸⁸ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 103.

¹⁸⁹ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 112.

¹⁹⁰ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 105.

¹⁹¹ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 105.

¹⁹² “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 113.

Duke e patur parasysh që interesimi parësor i Greqisë është stabiliteti rajonal, dialogu midis Kosovës dhe Serbisë e ka zbutur çfarëdo qoftë urgjence për Greqinë për ta njohur Kosovën, të cilën zyrtarët e Kosovës kanë qenë duke e shfrytëzuar si një argument për të grumbulluar sa më tepër njohje që të jetë e mundshme. Dialogu midis Kosovës dhe Serbisë e ka relaksuar politikën rajonale të Greqisë, meqë dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit është në pajtim me qëndrimin zyrtar të Greqisë për Kosovën, i cili është ai i mosnjohjes, dhe që çështjet e tilla, d.m.th problemet si ai midis Kosovës dhe Serbisë “kanë nevojë të zgjidhen përmes diplomacisë dhe konsensusit”.¹⁹³ Interesimi i Greqisë për stabilitetin rajonal pasqyrohet po ashtu në politikën e saj, jo vetëm ndaj Kosovës, por edhe në të. Misioni i saj zyrtar në Kosovë është ta ndërtojë një mjedis të stabilitetit me respektim për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ndërkohë që kontribuon për përmirësimin e marrëdhënieve ekonomike, për mbrojtjen e pakicave, dhe për respektimin e trashëgimisë kulturore dhe fetare të cilat janë prioritete të larta, pa e ndryshuar vendimin politik të një shteti që nuk e njeh Kosovën.¹⁹⁴

Marrë në tërësi, Greqia gradualisht dhe në mënyrë të qetë e ka vendosur praninë dhe veprimtarinë e saj në Kosovë. Prania diplomatike greke në Kosovë është trashëguar nga prania e saj paraprake në Prishtinë e cila është quajtur Zyra e Asistencës Humanitare Helene (ZAHH), që u themelua vonë në vitet 90, gjatë luftës në Kosovë.¹⁹⁵ Kur pas kësaj në Kosovë u vendos UNMIK-u, ZAHH u transformua në Zyren Ndërlidhëse, e cila u vendos nën jurisdikcionin e Ambasadës Greke në Beograd. Zyra Ndërlidhëse e Greqisë në Kosovë i raportonte drejtpërdrejt Ambasadës Greke në Beograd deri në vitin 2005, kur ata vendosën t’i ‘raportohen’ (një shprehje tjetër kjo për akreditimin) UNMIK-ut, që është struktura të cilën ende e mbrojnë edhe mospranuesit tjerë të pranishëm në Kosovë.

Në pajtim me politikën e vet mosnjohëse, por që po ashtu është jo-izolacioniste dhe përfshirëse, prania e Greqisë në Kosovë ka qenë aktive. Duke marrë parasysh që Greqia, së bashku me UE-në, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë e konsiderojnë si një prioritet kryesor,¹⁹⁶ Zyrtar Ndërmjetësues grek në Prishtinë, Dimitris Moschopoulos, e ka marrë për detyrë të veprojë si Ndërmjetës i UE-së për çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore.¹⁹⁷ Pos kësaj, prania greke në Kosovë nuk është e kufizuar vetëm në praninë diplomatike; Greqia po ashtu e ruan një total prej 118 trupash në KFOR,¹⁹⁸ dhe një total prej 37 trupash në EULEX.

Faktorë të tjerë që i kontribuojnë marrëdhënieve të dobëta midis Kosovës dhe Greqisë, janë edhe liria e kufizuar e lëvizjes që zbatohet për qytetarët e Kosovës përmes aplikimit të vizave, njësoj si edhe në anëtarët e tjerë të Unionit Evropian dhe të zonës së Schengenit.¹⁹⁹ Nga ana tjetër, Kosova nuk ka zbatuar asnjë herë kufizime të lëvizjeve për qytetarët e Greqisë.²⁰⁰ Po ashtu, nuk ka kurrfarë

¹⁹³ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 105.

¹⁹⁴ Shih Zyra Ndërlidhëse e Republikës Helene në Prishtinë në, <http://www.mfa.gr/missionsabroad/en/pristina-en/>.

¹⁹⁵ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”].

¹⁹⁶ “Greece stance – Kosovo” [“Qëndrimi i Greqisë – Kosova”], qasur më 14 janar, 2014, <http://www.mfa.gr/en/blog/greece-bilateral-relations/kosovo/>.

¹⁹⁷ “Political relations” [“Marrëdhëniet politike”], MPJ, Greqi, qasur më 14 janar, 2014, <http://www.mfa.gr/missionsabroad/en/pristina-en/bilateral-relations/political-relations.html>.

¹⁹⁸ “Key facts and figures” [“Faktet dhe shifrat kyçe”], KFOR, 30 nëntor, 2012, qasur më 21 janar, 2014, http://www.nato.int/kfor/structur/nations/placemap/kfor_placemat.pdf.

¹⁹⁹ “Vizat për qytetarët e Kosovës”, MPJ, Kosovë, qasur më 20 nëntor, 2013, <http://www.mfa-ks.net/?page=1.70>.

²⁰⁰ “Kush nuk ka nevojë për viza”, MPJ, Kosovë, qasur më 20 nëntor, 2013, <http://www.mfa-ks.net/?page=2.157>.

marrëveshesh apo memorandumesh të nënshkruara midis dy shteteve, dhe investimet e Greqisë në Kosovë të cilat për periudhën midis viteve 2008-2012 në mesatare janë 1.3 milionë € në vit, fare të pakta në krahasim me shtetet e tjera në rajon me të cilat Kosova ka marrëdhënie më të mira.²⁰¹

3.2.3 Marrëdhëniet/kontaktet bilaterale me RUMANINË

Rumania është një tjetër nga katër shtetet e rajonit që nuk e njeh Kosovën si shtet të pavarur. Për këtë arsye, Rumania dhe Kosova nuk kanë vendosur kurrfarë marrëdhëniesh bilaterale, dhe cilësia e tërësishme e marrëdhënieve mbetet *e dobët*. Marrëdhëniet e dobëta të Kosovës me Rumaninë përftohen nga rezultati i tërësishëm që Rumania e merr në aspektet fundamentale të marrëdhënieve/kontakteve të veta me Kosovën. Edhe pse e dobët, cilësia e tërësishme e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Rumanisë është fare pak më e mirë se marrëdhëniet e Kosovës me BH-ën. Për dallim nga BH, për shembull, dhe njësoj me Greqinë, Rumania e mban praninë e vet diplomatike përmes Zyres Ndërlidhëse të saj, dhe është e përfaqësuar në nivelin e Zyrtarit Ndërlidhës. Kosova, nga ana tjetër, nuk e ka ndonjë prani diplomatike në Rumani, dhe, për dallim nga Greqia, nuk ka patur raste në të cilat Rumania i ka ofruar Kosovës ta hapë Zyren Ndërlidhëse. Mirëpo, për dallim nga Greqia, Rumania nuk e ka trashëguar Zyren Ndërlidhëse nga prania e vet paraprake në Kosovë, por e ka themeluar nën mandatin e KB në Kosovë.²⁰²

Për vendimin e tashëm të Rumanisë për t'u rreshtuar me Serbinë lidhur me rastin e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, dhe për qëndrimin e tashëm të saj negativ ndaj njohjes së Kosovës, mund të përmenden disa arsye. Së pari, janë lidhjet tradicionale dhe historike me Serbinë. Rumunët konsiderojnë se kanë një histori të përbashkët me Serbinë në kontekstin e luftës së përbashkët kundër Perandorisë Osmane dhe mbrojtjes së rajonit kundër pushtimit të tij të mëtutjeshëm nga osmanët.²⁰³ Së dyti, është feja e përbashkët ortodokse, e cila është e rëndësishme në kontekstin rumun.²⁰⁴ Po ashtu, zyrtarët rumunë tashmë e kanë përvetësuar "brejtjen e ndërgjegjes" në lidhjet e tyre ndaj Serbisë, sepse, kur NATO-ja ishte duke planifikuar ta bombardonte Serbinë në vitin 1999, Rumunia e kishte ndjekur me përpikëri interesin e vet shtetëror, i cili ishte anëtarësimi potencial në NATO që aleatët kyç ishin të gatshëm t'ia ofrojnë Rumanisë, sikur kjo ta ofronte përkrahjen logjistike dhe politike, si dhe të lejonte shfrytëzimin e hapësirës së saj ajrore gjatë bombardimit, të cilën, në atë kohë, Rumania edhe e përvetësoi.²⁰⁵ Prandaj, Rumania nuk donte t'ia jipte një goditje tjetër Serbisë, si një partneri tradicional, duke e njohur Kosovën. Kjo ndjenjë e brejtjes së ndërgjegjes e çon lidhjen e Rumanisë me Serbinë edhe më tutje, kështu që Rumania është një përkrahëse e patundur për anëtarësimin e Serbisë në Unionin Evropian, meqë Rumania Serbinë e konsideron si shtet kyç për stabilitetin rajonal.²⁰⁶

Një arsye tjetër që Rumania e konsideron të rëndësishme në themel të qëndrimit të vet për Kosovën është çështja e Transnistrisë, një territor moldav në të cilin autoritetet e saj e kanë një sovranitet të kufizuar për shkak të ndikimit rus; njësoj si dhe për shkak të Transilvanisë, një rajon në Rumani me

²⁰¹ "Direct investments in Kosovo" ["Investimet e drejtpërdrejta në Kosovë"], Banka Qendrore e Kosovës, qasur më 23 janar, 2014, https://docs.google.com/viewer?url=http%3A%2F%2Fwww.bqk-kos.org%2Frepository%2Fdocs%2Ftime_series%2F34%2520Foreign%2520direct%2520investments%2520-%2520by%2520country.xls.

²⁰² "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 51-91.

²⁰³ "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 51-91.

²⁰⁴ "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 51-91.

²⁰⁵ "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 51-91.

²⁰⁶ "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 51-91.

shumicë hungareze, dhe në të dyja këto raste Rumania frikësohet që Kosova do të shërbejë si precedent për secesionin e tyre të mundshëm.²⁰⁷ Për shembull, Presidenti i Rumanisë deklaroi që ai është kundër pavarësisë së Kosovës me qëllim që ta mbrojë Rumaninë nga precedenti që një njohje e tillë do ta krijonte për Transnistri.²⁰⁸ Kjo nuk kishte qenë një nga arsyet që Rumania i kishte shfrytëzuar më parë, mirëpo, ndërkohë që ndjenjat nacionaliste hyjnë në lojë, dhe ndërkohë që pakica hungareze ka parashtruar pareshtur pretendimet për më tepër autonomi, kjo Rumaninë e ka vënë në një pozitë të vështirë.²⁰⁹

Ajo që është e veçantë për marrëdhëniet e Rumanisë me Kosovën është që, edhe pse cilësia e marrëdhënieve midis dy shteteve është e dobët, dhe më e keqe se ajo e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Greqisë, dhe madje edhe më e keqe se ajo midis Kosovës dhe Serbisë, që të dyja këto mosnjohëse të Kosovës, elita politike në Rumania është e përçarë lidhur me statusin e Kosovës. Nga njëra anë, Presidenti i Rumanisë, Traian Băsescu, është kundër njohjes së Kosovës dhe më i kujdesshëm lidhur me këtë çështje.²¹⁰ Në fakt, Presidenti Băsescu, që është rizgjedhur në vitin 2009 dhe do të shërbejë deri më 2014, është një nga disa zyrtarët, dhe i vetmi në nivel të lartë, miratimi i të cilit nevojitet për ta ndryshuar qëndrimin ndaj Kosovës. Ai e ka parashtruar qëndrimin e tij të fortë për Kosovën disa herë. Më 2 korrik 2008, pesë muaj pasi që Kosova e shpalli pavarësinë e vet, në një intervistë pas Samitit të NATO-s, Presidenti Băsescu deklaroi që Rumania e ka një qëndrim të qartë për të mos e njohur Kosovën, dhe që “ky do të jetë qëndrimi jonë në një afat shumë të gjatë”.²¹¹ Po ashtu, më 1 shtator 2010, disa muaj pasi që GJND-ja e dha mendimin e vet për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës, në mbledhjen vjetore të ambasadorëve rumunë, Presidenti Băsescu deklaroi që Rumania nuk do ta njohë Kosovën dhe që palët duhet t’i zgjidhin mospajtimet përmes negociatave.²¹² Më vonë, në vizitën e tij Beogradit, më 1 nëntor 2011, Presidenti Băsescu e përsëriti që “në këtë moment nuk është as edhe një kusht i vetëm nën të cilin Rumania do ta njohë Kosovën”.²¹³ Vendimi i Presidentit në çështjet e politikës së jashtme, të tilla si njohja e Kosovës, është suprem sipas Kushtetutës së Rumanisë, e cila, në emër të Rumanisë, Presidentit i mundëson “të vendosë traktatet ndërkombëtare të negociuara nga Qeveria, dhe që ato më pastaj t’ia dorëzojë Parlamentit për ratifikim, brenda një afati kohor të arsyeshëm”.²¹⁴ Kështu, pajtimi i Presidentit është filtri i parë të cilin njohja e Kosovës duhet ta kalojë, para se të kalojë në degën legjislative për t’u miratuar.

Nga ana tjetër, Kryeministri i zgjedhur rishtas, Victor Ponta, që zyrtarisht duhet të shërbejë deri në vitin 2016, është një nga zyrtarët e parë të nivelit të lartë të Rumanisë që e përkrah hapur dhe fuqishëm pavarësinë e Kosovës. Qëndrimi i Kryeministrit Ponta për Kosovën ka të bëjë me një

²⁰⁷ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 51-91.

²⁰⁸ “President Basescu says Romania not to recognize Kosovo independence” [“Presidenti Basescu thotë që Rumania nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës”], qasur më 20 janar, 2014, <http://m.hotnews.ro/stire/2390491>

²⁰⁹ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 62.

²¹⁰ “Romania very close to recognise Kosovo” [“Rumania shumë afër njohjes së Kosovës”], qasur më 20 janar, 2014, <http://www.kosovo-news.com/2013/06/romania-very-close-to-recognize-kosovo/>.

²¹¹ Shih video intervistën me Traian Basescu, Presidenti i Rumanisë, qasur më 12 janar, 2014, <http://www.nato.int/docu/speech/2008/s080630b.html>.

²¹² “Basescu: Romania will not recognize Kosovo as an independent state” [“Basescu: Rumania nuk do ta njohë Kosovën si shtet i pavarur”], qasur më 12 janar, 2014, <http://www.kosovocompromise.com/cms/item/topic/en.html?view=story&id=3006§ionId=1>.

²¹³ “Basescu in Belgrade: No way Romania can recognize Kosovo” [“Basescu në Beograd: Rumania kursesi nuk mund ta njohë Kosovën”], qasur më 12 janar, 2014, http://www.novinite.com/view_news.php?id=133553.

²¹⁴ Ibid.

politikë me pragmatike që ai planifikon ta udhëheqë në UE dhe në rajon. Kryeministri Ponta dëshiron të veprojë në pajtim me realitetin në terren, dhe prandaj përpiqet që politikën e jashtme të Rumanisë ta rreshtojë me shumicën e partnerëve të vet evropianë dhe euroatlantikë që tashmë e kanë njohur Kosovën. Më 4 korrik 2013, pak më pak se një vit nga marrja e pozitës së Kryeministrit, Z. Ponta deklaroi që duhet të ketë një koordinim institucional, para së gjithash midis Parlamentit, Qeverisë dhe Presidentit, ashtu që të krijohet një qëndrim përfundimtar për Kosovën, i cili, në parim, është që ajo të njihet.²¹⁵ Kohëve më të fundit, më 13 tetor 2013, në takimin e tij me Nënkryetarin e SHBA-ve, Joe Biden, Kryeministri Ponta e siguroi Z. Biden që qëndrimi i Rumanisë për Kosovën mund të ndryshojë në vitin 2015.²¹⁶ Kryeministri Ponta nuk aludoi në ndonjë arsye të veçantë se pse pikërisht viti 2015 do të ishte viti për ndryshimin e pozitës së Rumanisë, mirëpo, kjo mund të ketë lidhje me përfundimin e mandatit të Presidentit të tashëm dhe me mundësinë që ai të mos jetë në gjendje të rizgjedhet përsëri. Ministri i Jashtëm i Rumanisë, Titus Korlancean, po ashtu ka dhënë indikacione që Rumania duhet t'i shikojë nga afër përfundimet e dialogut të ndihmuar nga UE-ja midis Kosovës dhe Serbisë dhe duhet të reagojë në pajtim me realitetin që do të krijohet në terren si rezultat.²¹⁷

Qëndrimi i Rumanisë ndaj Kosovës, megjithatë, nuk mund të shikohet vetëm si çështje e parimeve të Rumanisë në respektimin e të drejtës ndërkombëtare dhe të fqinjit të vet Serbisë, meqë Rumania nuk është një aktor i veçantë në rajon, dhe, ashtu siç iu desht ta kuptonte, nuk mund t'i injorojë rrethanat rajonale dhe ndërkombëtare që i rrethojnë interesat e saj dhe interesat e aleatëve të saj. Rumania dëshiron që politikën e veta rajonale dhe të jashtme t'i rreshtojë vazhdimisht me aleatët e vet të NATO-s dhe me shumicën e shteteve anëtare të Unionit Evropian; kjo ishte më e evidentja kur Presidenti Băsescu vendosi t'i bashkangjitej Serbisë në bojkotimin e Samitit të Varshavës të Presidentëve të Evropës Qendrore dhe Juglindore në maj të vitit 2011, ku planifikohej të ishte edhe Presidenti i SHBA-ve, Barack Obama.²¹⁸ Vendimi i Presidentit Băsescu për të mos marrë pjesë kishte të bënte pikërisht me faktin që Polonia kishte vendosur që në këtë samit ta ftonte po ashtu edhe Presidentin e Kosovës, Atifete Jahjagën. Kjo lëvizje e Presidentit Băsescu nuk u mirëprit në vendin e tij madje edhe nga ata që nuk e përkrahin njohjen e Kosovës, me pretekstin se me këtë Rumania është duke bërë veprime kundër aleatëve të vet kryesorë, të tillë si SHBA-të dhe shtete anëtare kyçe të UE-së, për një çështje të një relevance më të ulët të pjesëmarrjes së Kosovës në samit.

Për shkak të mungesës së marrëdhënieve diplomatike, Kosova dhe Rumania nuk kanë marrëveshje bilaterale. Megjithatë, bashkëpunimi në disa fusha është vendosur përmes nënshkrimit të disa memorandumeve, mirëpo kjo ka ndodhur midis institucioneve të ndryshme në shtetet përkatëse. Për shembull, Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) e ka nënshkruar një memorandum të mirëkuptimit (MMK) me RENAR – Asociacionin e Akreditimit të Rumanisë.²¹⁹ Një MMK tjetër

²¹⁵ "Romania very close to recognizing Kosovo" ["Rumania shumë afër njohjes së Kosovës"], qasur më 13 janar, 2014, <http://www.kosovo-news.com/2013/06/romania-very-close-to-recognize-kosovo/>.

²¹⁶ "Romania could recognize Kosovo in 2015" ["Rumania mund ta njohë Kosovën në vitin 2015"], qasur më 13 janar, 2014, http://www.b92.net/eng/news/region.php?yyyy=2013&mm=10&dd=23&nav_id=88092.

²¹⁷ "Romania toward recognizing Kosovo" ["Rumania drejt njohjes së Kosovës"], qasur më 13 janar, 2014, <http://www.botasot.info/kosova/213592/romania-drejt-njohjes-se-kosoves/>.

²¹⁸ "Warsaw summit faces boycott" ["Samiti i Varshavës përballet me bojkotim"], qasur më 11 dhjetor, 2013, <http://www.ft.com/intl/cms/s/0/434af2ca-8705-11e0-92df-00144feabdc0.html>.

²¹⁹ "Memorandum of Understanding between the Kosovo Accreditation Directorate and Romanian Accreditation Association" ["Memorandumi i Mirëkuptimit midis Drejtorisë Kosovare të Akreditimit dhe Asociacionit Rumun të Akreditimit"], qasur më 13 janar, 2014, <http://www.mti-ks.org/en-us/Ministry-Trade-and-Industry-activities/Memorandum-of-Understanding-between-the-Kosovo-Accreditation-Directorate-and-Romanian-Accreditation-Association-2612-2612>.

është nënshkruar në fushën e zhvillimit ekonomik në Bukuresht.²²⁰ Faktorë të tjerë që i kontribuojnë marrëdhënieve të dobëta midis Kosovës dhe Rumanisë, njësoj si edhe me Greqinë dhe me shtetet e tjera anëtare të UE-së, është liria e kufizuar e lëvizjes që zbatohet për qytetarët e Kosovës përmes aplikimit të vizave, njësoj si edhe te anëtarët e tjerë të Unionit Evropian dhe të zonës së Schengenit. Nga ana tjetër, Kosova nuk ka zbatuar asnjë herë kufizime për lëvizjen e qytetarëve të Rumanisë. Mirëpo, ka patur përmirësime të vogla në vitet e fundit që nga Shpallja e Pavarësisë, kur Rumania vendosi që, në fakt, t'i njohë pasaportat e Kosovës dhe t'u lejojë qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë me vizat e Schengenit, gjë që nuk vlente më parë.

Pos kësaj, prania e Rumanisë në Kosovë nuk është e kufizuar vetëm në praninë diplomatike; Rumania po ashtu e mban një total prej 59 trupash në KFOR²²¹ dhe një total prej 37 trupash në EULEX.²²² Lidhur me këtë duhet përmendur që Rumania e ka mbajtur një prani më të madhe deri në kohët e fundit, mirëpo kjo vendosi t'i tërhiqte pjesën më të madhe të trupave të veta, posaçërisht të atyre që kanë qenë pjesë e EULEX-it. Kur EULEX-i u bë në tërësi operacional, në dhjetor 2010, 60 oficerë rumunë të policisë dhe 115 xhandarë i ndërruan uniformat e tyre nga ato të UNMIK-ut në ato të EULEX-it.²²³ Prania rumune në mekanizmat e sigurisë së Kosovës nuk ka qenë e mirëpritur në Kosovë, meqë oficerët rumunë të policisë e patën pësuar një goditje kur policët e tyre, nën mandatin e UNMIK-ut, i vranë dy qytetarë të Kosovës të kombësisë shqiptare në protestat e organizuara nga Lëvizja Vetëvendosje.²²⁴ Prandaj, ka patur po ashtu protesta në Prishtinë kur Koloneli i Xhandarmerisë Rumune, Marian Petre, u emërua në krye të Departamentit të Policisë Speciale të EULEX-it në vitin 2011.²²⁵

3.2.4 Mosnjohësit rajonalë në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës

Përkrahja dhe kundërshtimi i BH-ës ndaj legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës është një faktor që në masë të madhe varet nga elita politike e BH-ës, apo, më në veçanti, nga përfaqësuesit politikë të popujve përbërës të BH-ës. Njësoj sikur që në rastin e përkrahjes dhe kundërshtimit të njohjes së Kosovës, elita politike në BH është e përçarë edhe lidhur me çështjen e përfaqësimit të Kosovës në forumet ndërkombëtare. BH nuk e dorëzoi ndonjë mendim zyrtar kur rasti i Kosovës doli para GJND-së, meqë është evidente që tre përfaqësuesit në Presidencën e BH-ës nuk ia dolën të pajtohen, as për përkrahjen, dhe as për kundërshtimin, e ligjshmërisë së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Si rezultat, BH nuk votoi, as pro, dhe as kundër, rezolutës së Serbisë në APKB të 8 tetorit 2008 për t'ia dhënë rastin e Kosovës GJND-së; BH vendosi ta bojkotonte sesionin.²²⁶ Po ashtu, si rezultat, BH nuk e dorëzoi asnjë deklaratë të shkruar (në përkrahje, apo në kundërshtim) për ligjshmërinë e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës para GJND-së para asnjërit nga afatet e tij të fundit kohore, të 17 prillit 2009, dhe të 24 korrikut 2009, respektivisht.²²⁷ BH po ashtu nuk e bëri ndonjë deklaram gojor gjatë dëgjimeve të dhjetorit 2009 para GJND-së. Sa i përket anëtarësimit të Kosovës në FMN, më 3 maj 2009, BH nuk votoi as pro dhe as kundër anëtarësisë së saj në këtë organizatë,

²²⁰ "Cooperation with Romania starts" ["Fillon bashkëpunimi me Rumaninë"], qasur më 14 janar, 2014, <http://grid.al/read/news/155905558/2473996/nis-bashkëpunimi-me-rumaninë>.

²²¹ ²²¹ "Key facts and figures" ["Faktet dhe shifrat kyçe"], KFOR.

²²² Komunikim përmes E-mailit i KIPRED me zëdhënësin e EULEX-it në korrik, 2013.

²²³ "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 56.

²²⁴ "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 56.

²²⁵ "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 57.

²²⁶ Dokument i brendshëm nga MPJ.

²²⁷ Dokument i brendshëm nga MPJ.

por abstenoit.²²⁸ Po ashtu, më 3 korrik 2009, BH nuk votoi, as pro, dhe as kundër, anëtarësimin të Kosovës në Bankën Botërore, por e bojkotoi takimin.²²⁹

Kur fjala është për përfaqësimin e Kosovës në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, zyrtarët e BH-ës shumë herë janë konfrontuar hapur me njëri-tjetrin, e cila e thekson mungesën e tyre të konsensusit të brendshëm lidhur me këtë çështje.²³⁰ Për shembull, kur ka përfaqësues kroatë apo boshnjakë të BH-ës në ndonjë forum rajonal apo ndërkombëtar, ata, as nuk do ta refuzojnë, as nuk do ta kushtëzojnë pjesëmarrjen e tyre me praninë apo mungesën e zyrtarëve të Kosovës në ato ngjarje. Në rastet kur përfaqësuesit serbë të BH-ës janë të pranishëm në ndonjë takim multilateral rajonal apo ndërkombëtar, ata do ta kushtëzojnë praninë e tyre, që don të thotë, praninë e BH-ës, me atë që përfaqësuesit e Kosovës duhet të largohen nga takimet. Përfaqësuesit serbë të BH-ës po ashtu do të përpiqen të parashtrajnë kërkesa për më tepër autonomi për RS, duke e kushtëzuar pjesëmarrjen e Kosovës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të RS pos atyre të BH-ës.²³¹ Prandaj, përkrahja dhe kundërshtimi i BH-ës ndaj njohjes dhe ndaj anëtarësisë dhe pjesëmarrjes së Kosovës në forumet rajonale dhe ndërkombëtare janë të kushtëzuara nga përçarjet e brendshme të përfaqësuesve të popujve përbërës të BH-ës, të cilët vetë janë të ndarë lidhur me çështjen.

Greqia e ka sfiduar legjitimitetin ndërkombëtar të Kosovës në raste të ndryshme. Në rastin e rezolutës së Serbisë të 8 tetorit 2008 në APKB e cila thërriste për paraqitjen e rastit të Kosovës para GjND-së, Greqia vendosi ta përkrahte nismën e Serbisë, dhe votoi për rezolutën.²³² Mirëpo, njësoj si BH, dhe madje edhe Mali i Zi dhe Maqedonia, Greqia nuk dorëzoi ndonjë deklaratë të shkruar apo ndonjë mendim që do ta përkrahte apo kundërshtonte rastin e Kosovës para GjND-së në asnjërin nga afate e fundit të 19 prillit 2009 dhe 24 korrikut 2009.²³³ Greqia po ashtu nuk parashtroi ndonjë deklaratë gojore gjatë dëgjimeve publike të dhjetorit para GjND-së. Sidoqoftë, Ministri i Jashtëm i Greqisë në atë kohë, me përkrahjen e partnerëve të vetë evropianë vendosi ta vizitonte, edhe Prishtinën, edhe Beogradin, ashtu që palët t'i bindte për t'i zgjidhur çështjet në tryezën e bisedimeve, e cila, në përgjithësi, është në kuadrin e politikës së Greqisë për rajonin.²³⁴ Për dallim nga BH që abstenoit lidhur me anëtarësimin e Kosovës në FMN dhe e bojkotoi votimin për anëtarësimin e Kosovës në Bankën Botërore, Greqia ishte e pranishme dhe votoi kundër në të dyja rastet, duke e sfiduar, por duke mos e parandaluar anëtarësimin e Kosovës në këto dy organizata ndërkombëtare.²³⁵ Në pajtim me politikën e saj rajonale dhe të jashtme jo-izolacioniste, pavarësisht nga qëndrimi i saj për Kosovën, Greqia nuk ka qenë një lobues i patundur kundër pavarësisë së Kosovës, ashtu siç kanë qenë, për shembull, Spanja dhe Qiproja, dhe si e tillë ajo ka mbetur neutrale lidhur me këtë. Po ashtu, nuk ka shumë raste, nëse edhe ka fare pak, ku Greqia e ka kundërshtuar komunikimin me përfaqësuesit e Kosovës në forumet ndërkombëtare apo rajonale dhe në struktura të tjera multilaterale.

²²⁸ Dokument i brendshëm nga MPJ.

²²⁹ Dokument i brendshëm nga MPJ.

²³⁰ "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 153-166.

²³¹ "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 153-166.

²³² Dokument i brendshëm nga MPJ.

²³³ Dokument i brendshëm nga MPJ.

²³⁴ "Kosovo Calling" ["Thirrja e Kosovës"], 153-166.

²³⁵ Dokument i brendshëm nga MPJ.

Pas Serbisë, Rumania është sfiduesi më i patundur i legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës në mesin e mosnjohësve të rajonit. Për dallim nga rasti i BH-ës dhe i Greqisë, të cilat sfidimin ndaj legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës e mbështesin për shkak të konstelacioneve të tyre të brendshme politike, apo për shkak të prioriteteve të politikave të tyre rajonale dhe të jashtme, Rumania është përpjekur ta sfidojë legjitimitetin ndërkombëtar të Kosovës sa herë që ka mundur. Për shembull, në rastin e rezolutës së Serbisë të 8 tetorit 2008 para APKB e cila thërriste për dorëzimin e rastit të Kosovës para GJND-së, Rumania, njësoj si Greqia, vendosi ta përkrahte nismën e Serbisë, dhe votoi për rezolutën.²³⁶ Mirëpo, për dallim nga Greqia, Rumania e dorëzoi një deklaratë të shkruar, para afatit të parë të fundit më 19 prill 2009, në të cilën ajo e përkrahte rastin e Serbisë dhe e kundërshtonte atë të Kosovës para GJND-së, mirëpo kjo nuk e dorëzoi ndonjë deklaratë apo mendim shtesë para afatit të dytë të fundit të GJND-së më 24 korrik 2009.²³⁷ Rumania po ashtu e shfrytëzoi mundësinë për të dhënë deklaratë gojore gjatë dëgjimeve publike të dhjetorit 2009 para GJND-së për rastin në fjalë, ku ajo deklaroi që “Serbia i ka shkelur të drejtat themelore njerëzore të popullatës në Kosovë gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar; mirëpo, në kohën e Shpalljes së Pavarësisë, Beogradi nuk i ka shkelur të drejtat e popullatës së Kosovës”.²³⁸ Po ashtu, kjo argumentoi më tutje që “në shkurtin e vitit 2008 Serbia është një vend në tërësi i ndryshëm po të krahasohet me atë të vitit 1999, dhe vendimi për shpalljen e pavarësisë nuk mund të mbështetet në rrethanat e para 10 viteve”;²³⁹ si dhe që “Kosova e ka patur një status të veçantë në RSF të Jugosllavisë, por kjo nuk e përlligj secesionin, meqë në kohën e secesionit të Kosovës, RSF e Jugosllavisë nuk ka qenë duke ekzistuar për 16 vite. Shpërbërja e RSFJ ka përfunduar në vitin 1992, dhe që atëherë Kosova ka qenë pjesë përbërëse e Serbisë, dhe jo një entitet me të drejtën e vetëvendosjes që do ta përlligjte secesionin”.²⁴⁰

Pos kësaj, njësoj si edhe Greqia, Rumania votoi kundër anëtarësimit të Kosovës në FMN më 3 maj 2009, si dhe kundër anëtarësimit të Kosovës në Bankën Botërore më 3 korrik 2009, duke e sfiduar kësisoj, por jo edhe duke e parandaluar, Kosovën për t’u bërë anëtare e këtyre dy organizatave ndërkombëtare.²⁴¹ Si rezultat, anëtarësia e Kosovës në këta dy trupa ndërkombëtarë është pasuar nga një deklaratë shtesë nga Rumania, e cila e përsëriti që “ajo nuk e njeh ‘Republikën e Kosovës’ si një shtet. Pranimi i ‘Republikës së Kosovës’ në Fondin Ndërkombëtar Monetar dhe në Bankën Botërore, dhe anëtarësia e këtij entiteti në këta trupa, krahas Rumanisë, janë pa paragjykim ndaj pozitës së Rumanisë vis-à-vis statusit të Kosovës dhe nuk e presupozojnë në kurfarë mënyrë njohjen nga Rumania të shtetësisë së ‘Republikës së Kosovës’.”²⁴² Kështu, kjo është në pajtim me politikën dhe qasjen e Rumanisë, dhe atë deri në atë pikë që në të vërtetë duhet qenë të kujdesshëm dhe të mos jipet ndonjë deklaratë që madje edhe në mënyrë implicite do të nënkuptonte në një apo në ndonjë tjetër mënyrë që Rumania e ka njohur Kosovën si një subjekt ndërkombëtar. Nga ana tjetër, një qasje e tillë e Rumanisë ua ka vështirësuar jetën jashtëzakonisht shumë zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rumanisë, të cilët vazhdimisht duhet të shikojnë se a mos Rumania, madje

²³⁶ Dokument i brendshëm nga MPJ.

²³⁷ Dokument i brendshëm nga MPJ.

²³⁸ “Hague: Countinuing the debate on Kosovo” [“Hagë, Vazhdimi i debatit për Kosovën”], qasur më 20 janar, 2014, http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2009&mm=12&dd=10&nav_category=640&nav_id=397469.

²³⁹ Ibid.

²⁴⁰ Ibid.

²⁴¹ Dokument i brendshëm nga MPJ.

²⁴² Shih Marrëveshjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Rezervimi, deklaratat dhe vërejtjet, Rumania, 13 gusht 2009, në, <http://www.minbuza.nl/en/key-topics/treaties/search-the-treaty-database/1945/12/006615.html?printpart=reservations>.

edhe në mënyrë të pavetëdijshme, është duke rrëshqitur dhe duke e bërë ndonjë njohje të nënkuptuar pa miratimin e vet paraprak.²⁴³

Së fundi, për shkak të intensitetit të ulët të marrëdhënieve dhe takimeve të pakta bilaterale midis Kosovës dhe mosnjohësve, nuk ka patur përmendje të veçanta lidhur me përkrahjen për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë. Edhe pse, duke e patur parasysh që Greqia dhe Rumania janë vende anëtare të UE-së të cilat e ndihmojnë dialogun, ato mund të konsiderohen si përkrahëse të dialogut. Nuk ka patur ndonjë deklaratë të drejtpërdrejtë nga zyrtarët e BH-ës lidhur me dialogun; sidoqoftë, përfaqësuesit serbë të BH-ës dialogun e shikojnë më tepër nga perspektiva e Serbisë dhe e kanë qasjen e interesit kombëtar – të shumë zero – në vend se ndonjë qasje konstruktive e cila do të shikonte më përpara. Kështu, për dallim nga Shqipëria, e cila dialogun e shikon nga perspektiva e partnerëve të saj euroatlantike dhe nuk ka shkuar përtej qëndrimit të tyre, përfaqësuesit serbë të BH-ës kanë qenë më të zhurmsëm në përkrahjen e kauzës së Serbisë në Kosovë, në vend se për normalizimin e marrëdhënieve midis dy shteteve.

3.3 Intensiteti i marrëdhënieve me mosnjohësit e tjerë të rajonit

3.3.1 Intensiteti i marrëdhënieve/kontakteve bilaterale – Kosova dhe BH

Intensiteti i marrëdhënieve/kontakteve bilaterale me BH-ën është në masën më të madhe *joaktiv*. BH renditet vetëm mbi Rumaninë sa i përket nivelit të intensitetit të marrëdhënieve që i ka me Kosovën, dhe është dukshëm nën Serbinë dhe Greqinë, si dy vende të tjera mosnjohëse të rajonit. Marrëdhëniet joaktive midis Kosovës dhe BH-ës përftohen nga aktiviteti i tërësishëm bilateral nga

aspekti i takimeve në nivelet presidenciale, kryeministrale dhe të ministrave të jashtëm, ku asnjë i tillë nuk ka ndodhur që nga Shpallja e Pavarësisë së Kosovës. Mirëpo, ka patur disa takime jozyrtare që i pasqyrojnë përçarjet e përfaqësuesve të popujve përbërës të BH-ës. Për shembull, ndërkohë që anëtari boshnjak i Presidencës që e përkrah pavarësinë e Kosovës “është takuar me përfaqësuesit e Kosovës anash ngjarjeve ndërkombëtare”,²⁴⁴ Kryeministri i Republikës Serbe në BH, Milorad Dodik, e ka vizituar pjesën veriore të Kosovës në gjysmën e parë të vitit 2013, ky ai e përsëriti përkrahjen e tij për kauzën serbe të forcimit të Asociacionit midis komunave serbe.²⁴⁵

Intensiteti i marrëdhënieve të Kosovës me shtetet mosnjohëse të rajonit

	Shteti	Pikë	Intensiteti
	Shqipëria	3.75	Shumë Intensive
	Turqia	2.25	Intensive
	Maqedonia	2.00	Pak Intensive
	Kroacia	2.00	Pak Intensive
	Slovenia	2.00	Pak Intensive
	Bullgaria	1.00	Pak Intensive
7	Greqia	1.00	Pak Intensive
8	Serbia	1.00	Pak Intensive
	Mali i Zi	0.75	Joaktive
10	BH	0.50	Joaktive
11	Rumania	0.00	Joaktive

Pos mungesës së takimeve të larta zyrtare midis palëve, e cila i kontribuon marrëdhënieve joaktive midis dy shteteve, ka patur disa vizita të ndërsjella në nivele më të ulëta. Për shembull, disa përfaqësues të shoqërisë civile nga BH e kanë vizituar Kosovën në vitin 2009, ku temë kryesore ka qenë forcimi i bashkëpunimit në sektorin e edukimit. Është nënshkruar bashkëpunimi midis Universitetit të Bosnjes dhe Universitetit të Prishtinës, me qëllim që të ndihmohet shkëmbimi i përvojave dhe ndërtimi i kapaciteteve midis BH-ës dhe Kosovës, ashtu siç është theksuar nga

²⁴³ Zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Jashtme në “Thirrja e Kosovës”.

²⁴⁴ “Kosovo Calling” [“Thirrja e Kosovës”], 157.

²⁴⁵ “Dodik: There will be no Belgrade-Prishtina deal” [“Dodik: Nuk do të ketë marrëveshje Beograd-Prishtinë?”], qasur më 20 janar, 2014, http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2013&mm=04&dd=12&nav_id=85672.

Rektori i Universitetit të Mostarit që ishte i pranishëm në takim.²⁴⁶ Pos kësaj, më 21 korrik 2012, një delegacion i Anëtarëve të Parlamentit nga BH, artistë, analistë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të mediave, e kanë bërë një vizitë në Kosovë.²⁴⁷ Ata u pranuan nga Presidentja e Kosovës që e përkrahu mundësimin e lëvizjes së lirë të të mirave dhe të njerëzve nga Kosova në BH, dhe e lavdëroi përfshirjen dhe përkushtimin e komunitetit boshnjak në Kosovë, ndërkohë që i informoi që së shpejti mund të vijë deri te themelimi i një komune në Kosovë që do të ketë shumicë boshnjake.²⁴⁸ Ajo që i kontribuon paksa intensitetit të marrëdhënieve midis dy shteteve është shkëmbimi mesatar vjetor tregtar, i cili, midis viteve 2009-2012 ka qenë rreth 71.5 milionë €;²⁴⁹ megjithatë, krahasuar me shkëmbimin tregtar midis Kosovës dhe vendeve të tjera rajonale, vëllimi i tashëm tregtar midis dy shteteve është mjaft i ulët që të mos mund ta rrisë nivelin e intensitetit të marrëdhënieve midis dy shteteve.

3.3.2 Intensiteti i marrëdhënieve/kontakteve bilaterale – Kosova dhe Greqia

Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale midis Kosovës dhe Greqisë është *pak intensiv*. Edhe pse Greqia është në mesin e katër mosnjohësve të rajonit, intensiteti i marrëdhënieve të saj me Kosovën është në një nivel më të lartë se ai i atyre me fqinjën e Kosovës, Malin e Zi, për shembull. Marrëdhëniet pak intensive midis Kosovës dhe Greqisë përftohen nga aktiviteti i tërësishëm bilateral nga aspekti i takimeve në nivelin presidencial, kryeministrot dhe në nivel të ministrave të jashtëm, si dhe nga shkëmbimi tregtar midis dy palëve. Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare janë ato që i kontribuojnë më tepër nivelit të tashëm të intensitetit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Greqisë, ndërkohë që takimet dhe vizitat e zyrtarëve të nivelit të lartë të përmendur më sipër nuk kanë qenë aq të shpeshta. Megjithatë, për dallim nga BH dhe Rumania, Greqia ka qenë më e hapur ndaj takimeve dhe vizitave të zyrtarëve të lartë të Kosovës, dhe, të paktën, e ka ruajtur komunikimin institucional me autoritetet e Kosovës.

Edhe pse Greqia nuk e ka njohur Kosovën si shtet të pavarur, politika e saj, që nga Shpallja e Pavarësisë, ka qenë t'i mbajë kanalet e komunikimit të hapura me qëllim që t'i përmirësojë kushtet sociale dhe ekonomike. Kjo është në pajtim me strategjinë prioritare të Greqisë për rajonin, e cila është siguria dhe stabiliteti. Edhe pse ka patur kontakte midis zyrtarëve të të dyja palëve, nuk ka patur ende përkushtime lidhur me ndryshimin potencial të qëndrimit të Greqisë ndaj Kosovës.²⁵⁰ Që nga Shpallja e Pavarësisë në shkurt 2008, kanë ndodhur vetëm 4 vizita të ndërsjella. Zyrtarët grekë kanë qenë më aktiv në vizitat Kosovës se e anasjellta. Për shembull, ministrat e jashtëm të Greqisë e kanë vizituar Kosovën tre herë që nga viti 2008; Ministria e Jashtme, Dora Bakoyannis e ka bërë vizitën e saj në Kosovë më 3 shkurt 2009,²⁵¹ ku ajo u takua me Kryeministrin e Kosovës Hashim Thaçin, për t'i diskutuar, ndër të tjera, zhvillimet aktuale në Kosovë, misionin e OSBE-së në Kosovë (meqë në atë kohë ajo ishte udhëheqësja e radhës e OSBE-së), dhe për format e ardhshme të

²⁴⁶ Takimi i Presidentit Fatmir Sejdiu me Rektoren Suzana Bubic, <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,6,308> .

²⁴⁷ "President Jahjaga received a delegation from Bosnia and Herzegovina" ["Presidentja Jahjaga pranoi një delegacion nga Bosnje-Hercegovina"], <http://www.president-ks.gov.net/?page=2,6,2401>.

²⁴⁸ Ibid.

²⁴⁹ "Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations" ["Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare"], KIPRED, 32-35.

²⁵⁰ Shih vizitat e zyrtarëve të Greqisë në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,2322> and <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,6,1756>

²⁵¹ "Prime Minister Hashim Thaci meets Greek Foreign Minister Dora Bakoyannis" ["Kryeministri Hashim Thaçi e takon Ministren e Jashtme greke, Dora Bakoyannis"], qasur më 25 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,171>.

bashkëpunimit midis Kosovës dhe Greqisë.²⁵² Pasardhësi i saj, Dimitrios Droutsas e bëri vizitën e tij në Kosovë më 31 korrik 2010;²⁵³ dhe Ministri i Jashtëm që shërbeu për pesë muaj, Stavros Lambrinidis, e vizitoi Kosovën në mesin e mandatit të tij, më 8 shtator 2011.²⁵⁴ Ndërkohë, zyrtari i parë i nivelit të lartë që e vizitoi Greqinë ishte Ministri i tashëm i Jashtëm, Enver Hoxhaj, që vizitën e tij e bëri më 8 mars 2013.²⁵⁵

Zyrtarët e nivelit të lartë të të dyja vendeve janë takuar po ashtu edhe në disa raste multilaterale. Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi është takuar me ish-Ministrin e Jashtëm grek dhe me Zëvendës Kryeministrin, Enagelos Venizelos, në shtator të vitit 2013, në selinë e KB në New York. Ndër temat e diskutuara ishin procedurat lidhur me lirinë e lëvizjes, ku Z. Thaçi ka kërkuar nga Z. Venizelos ta bëjë të mundur që qytetarët e Kosovës të udhëtojnë në Greqi me vizat e Schengenit, pa patur nevojë të aplikojnë për vizën e veçantë greke, ashtu siç është dashur deri atëherë. Ata kanë diskutuar po ashtu për forcimin e bashkëpunimit në fushën ekonomike duke hapur zyra ekonomike në të dyja kryeqytetet, si një hap i parë ky drejt formalizimit të marrëdhënieve midis dy vendeve, të cilat do të ishin të një interesi për ekonominë e të dyjave. Zëvendës Kryeministri Venizelos e rikonfirmoi qëndrimin e Greqisë që ajo e përkrah rendin evropian të ditës për integrim për të tërë rajonin, përfshirë këtu edhe Kosovën.²⁵⁶

Këto takime bilaterale janë pozitive, të paktën nga perspektiva e ruajtjes së marrëdhënieve normale midis dy palëve, kuptohet, pa e bërë njohjen; mirëpo, shpeshësia e këtyre takimeve në këtë nivel nuk i kontribuon detyrimisht shumë asaj që marrëdhëniet midis dy palëve të jenë më intensive, kur këto të krahasohen me intensitetin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe disa shteteve të tjera të rajonit. Një nga aspektet më të rëndësishme që i kontribuon intensitetit të marrëdhënieve midis dy palëve është vëllimi i shkëmbimit tregtar. Shkëmbimi tregtar mesatar vjetor gjatë periudhës 2008-2012 midis dy shteteve ka qenë rreth 96 milionë €, duke e bërë Greqinë partnerin rajonal tregtar të pestë.²⁵⁷

3.3.3 Intensiteti i marrëdhënieve/kontakteve bilaterale – Kosova dhe Rumania

Marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe Rumanisë janë *joaktive*. Rumania është një nga vendet që është në fundin e listës së vendeve të rajonit nga aspekti i nivelit të intensitetit të marrëdhënieve bilaterale midis saj dhe Kosovës. Marrëdhëniet midis Kosovës dhe Rumanisë janë madje edhe më pak intensive se marrëdhëniet tashmë joaktive midis Kosovës dhe BH-ës, ku aktiviteti i vetëm domethënës midis dy shteteve është shkëmbimi tregtar. Marrëdhëniet joaktive të Kosovës me Rumaninë burojnë, edhe nga mosaktiviteti politik (takimet dhe vizitat në nivelet presidenciale, kryeministrorë dhe të ministrave të jashtëm), edhe nga mosaktiviteti i përgjithshëm ekonomik. Për dallim nga rasti me Greqinë, këtu nuk ka patur, as vizita zyrtare, as asi jozyrtare, madje edhe në nivelet më të ulëta institucionale. Madje edhe ata përbrenda elitës politike të Rumanisë që e përkrahin

²⁵² Ibid.

²⁵³ “Sejdiu: It’s the right time for Greece to recognize Kosovo” [“Sejdiu: Është momenti i duhur për Greqinë që ta njohë Kosovën”], qasur më 25 janar, 2014, <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,6,1273>.

²⁵⁴ “Prime Minister Hashim Thaci meets Greek Foreign Minister Stavros Lambrinidis” [“Kryeministri Thaçi takohet me Ministrin e Jashtëm grek, Stavros Lambrinidis”], qasur më 25 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,2322>.

²⁵⁵ “Hoxhaj në Athinë: Kapitull i ri në marrëdhëniet Kosovë-Greqi”, qasur më 26 janar, 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,4,1611>.

²⁵⁶ “Today, the Prime Minister of the Republic of Kosovo, Hashim Thaçi meets the Deputy Prime Minister and Foreign Minister of Greece, Evangelos Venizelos” [“Sot, Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, e takon Zëvendës Kryeministrin dhe Ministrin e Jashtëm të Greqisë, Evangelos Venizelos”], qasur më 26 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,3774>.

²⁵⁷ Publikimet për tregtinë e jashtme, Zyra e Kryeministrit, Agjencioni për Statistikë i Kosovës.

njohjen e Kosovës, si Kryeministri dhe zyrtarë të tjerë në qeveri, nuk kanë qenë rishtarë për çfarëdo takimesh të mundshme bilaterale apo për vizita në Prishtinë apo në Bukuresht – dhe kjo ndodh meqë Rumania nuk don ta dërgojë kurfarë sinjali që do të tregonte madje edhe njohje të nënkuptuar, apo çfarëdo qoftë formë tjetër të njohjes së autoritetit sovran të Prishtinës mbi Kosovën.

Kanë qenë disa kontakte të karakterit multilateral jashtë trevës së Kosovës dhe të Rumanisë. Për shembull, Ministri i Jashtëm i Kosovës është ftuar nga homologu i tij rumun në takimin e PBEJL-së në New York, dhe në atë vijuesin që do të mbahet në Bukuresht.²⁵⁸ Kjo është një lëvizje pozitive, të paktën për përmirësimin e intensitetit të marrëdhënieve, pa e përmirësuar detyrimisht cilësinë e tyre që do ta nënkuptonte një njohje të shpejtë. Zyrtarët e Kosovës dhe të Rumanisë e kanë shfrytëzuar mundësinë për t'u takuar në New York edhe në raste të tjera, gjë kjo që ka qenë një hap përpara nga refuzimi paraprak i Rumanisë për vendosjen e çfarëdo qoftë kontakti me ndonjë zyrtar të Kosovës në çfarëdo qoftë niveli.²⁵⁹ Nga ana tjetër, zyrtarët e Rumanisë në kuadrin e Zyres Ndërlidhëse të Rumanisë në Prishtinë, takohen me zyrtarë të Kosovës qoftë për ta lehtësuar ndonjë mesazh, apo për të shqyrtuar çfarëdo qoftë vështirësish që ndërmarrësit rumunë mund të hasin në Kosovë.²⁶⁰ Dita kombëtare e Rumanisë e 29 nëntorit është kremtuar në Prishtinë, ku morën pjesë trupi diplomatik, OJQ-të, si dhe zyrtarë të qeverisë së Kosovës.²⁶¹ Marrë në përgjithësi, në aspektet fundamentale që i shqyrton ky punim, Rumania i ka mbajtur, edhe intensitetin, edhe cilësinë, e marrëdhënieve me Kosovën në nivele madje edhe më të ulëta se vetë Serbia.

²⁵⁸ “Hoxhaj: Pa Kosovën, bashkëpunimi rajonal nuk është i plotë”, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,4,1889>, dhe “Minister Hoxhaj travels to Romania to the SEECF Summit” [“Ministri Hoxhaj udhëton në Rumani në Samitin e PBEJL”], <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,2245>.

²⁵⁹ Burim i KIPRED-it, 30 shtator, 2013.

²⁶⁰ Ibid.

²⁶¹ 20 nëntor 2013, ceremoni e ditës kombëtare të Rumanisë.

4 KOSOVA DHE SHTETET E TJERA ANËTARE TË UE-SË NË RAJON

4.1 Politikat e jashtme dhe rajonale

Tre shtetet e tjera anëtare të UE-së në rajon (Kroacia, Sllovenia dhe Bullgaria) i kanë të përbashkëta politikat e ngjashme, edhe pse jo identike, rajonale dhe të jashtme, nga aspekti i natyrës së tyre, ngjashëm me dy shtetet anëtare të UE-së të rajonit që u shqyrtuan më heret (Rumania dhe Greqia). Ngjashmëritë janë që të gjitha nga këto janë të interesuara dhe të përqendruara në sigurinë dhe stabilitetin rajonal; disa nga to i kanë të përbashkëta këto interesime për fqinjërinë e tyre të drejtpërdrejtë, dhe të tjerat edhe për rajonin më të gjerë. Roli dhe aspiratat rajonale të Kroacisë, për shembull, janë që ta vendosë një paqe, stabilitet dhe zhvillim të përhershëm për rajonin më të gjerë të Evropës Juglindore, dhe ajo këtë rol e quan ‘të pazëvendësueshëm’.²⁶² Nga aspekti i politikës rajonale të saj, Kroacia po ashtu përqendrohet në vendosjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore bazuar në “barazinë dhe reciprocitetin, dhe në gjetjen e mënyrës politike të bazuar në të drejtën ndërkombëtare për zgjidhjen e të gjitha çështjeve që kanë mbetur të hapura pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë.”²⁶³ Pasi që i përmbushi aspiratat e veta për anëtarësimin në NATO në vitin 2009 dhe për anëtarësimin në UE në vitin 2013, prioriteti i parë i Kroacisë tash mbetet rritja e marrëdhënieve me vendet fqinje, të cilat janë Serbia, BH, Sllovenia, Hungaria, dhe Italia matanë Adriatikut.²⁶⁴ Kroacia po ashtu i jep një vëmendje të veçantë organizatave, forumeve, si dhe nismave rajonale multilaterale.²⁶⁵

Ngjashëm, politika rajonale e Sllovenisë nuk është e përqendruar vetëm në fqinjët e saj të drejtpërdrejtë, dhe as nuk përqendrohet shumë gjerë sa i përket rajonit; kjo përqendrohet kryesisht në çështjet që kanë të bëjnë me Ballkanin Perëndimor, domethënë, në ish republikat simotra nga ish Jugosllavia, përfshirë këtu edhe Kosovën, dhe që është zonë prioriteti për interesat dhe veprimtaritë sllovene.²⁶⁶ Përqendrimi i Sllovenisë në Ballkanin Perëndimor buron nga ndërvarshmëria e saj, edhe ekonomike, edhe politike, me pjesën më të madhe të këtij rajoni, të cilën e ka trashëguar historikisht si një ish anëtar përbërës i ish Jugosllavisë. Duke qenë anëtare e UE-së për afërsisht një dekadë deri më tash, Sllovenia, njësoj si edhe shumica e shteteve anëtare të UE-së të rajonit, është një përkrahëse e patundur e integritetit të Ballkanit Perëndimor në UE dhe në NATO.²⁶⁷ Për më tepër, duke i patur parasysh interesat e saj të veçanta në Ballkanin Perëndimor, në korrikun e vitit 2010 Sllovenia i ka përgatitur ‘Udhëzimet për politikën e Sllovenisë në Ballkanin Perëndimor’, të cilat synojnë në koordinimin e veprimtarive qeveritare ndër-ministore që kanë të bëjnë me Ballkanin Perëndimor, me një interes të veçantë në integrimin e rajonit në UE dhe në NATO.²⁶⁸

Politika dhe prioritetet rajonale të Bullgarisë i korrespondojnë më afër atyre të Rumanisë, posaçërisht në përqendrimin e saj të veçantë në rajonin e Detit të Zi.²⁶⁹ Për Bullgarinë, bashkëpunimi me vendet e rajonit të Detit të Zi “i rrit gjasat për zhvillimet pozitive përmes ndërveprimit të afërt me procesin e integritetit evropian dhe euroatlantike, të përqendruar në jetësimin e programeve ekonomike dhe

²⁶² “Foreign Policy Aims” [“Synimet e Politikës së Jashtme”], MPJ, Kroaci.

²⁶³ Ibid.

²⁶⁴ Ibid.

²⁶⁵ Ibid.

²⁶⁶ “Foreign Policy – Western Balkans” [“Politika e Jashtme – Ballkani Perëndimor”], Ministria e Punëve të Jashtme e Sllovenisë, qasur më 8 janar, 2014, http://www.mzz.gov.si/en/foreign_policy/foreign_policy/western_balkans/.

²⁶⁷ Ibid.

²⁶⁸ Ibid.

²⁶⁹ “Foreign Affairs” [“Punët e Jashtme”], Ambasada e Republikës së Bullgarisë në Londër.

infrastrukturale të një rëndësie rajonale dhe evropiane.”²⁷⁰ Prioriteti kryesor i Bullgarisë në rajon janë Rumania dhe Greqia (anëtare të UE-së dhe të NATO-s), Qiproja (anëtare e UE-së), dhe Turqia (anëtare e NATO-s).²⁷¹ Mirëpo, për dallim nga Rumania, dhe ngjashëm me shtetet e tjera anëtare të UE-së në rajon, Ballkani Perëndimor dhe integrimi i tij në UE dhe në NATO janë po ashtu një prioritet për Bullgarinë, për arsye të ngjashme që integrimi i rajonit në këta dy trupa sjell paqe dhe stabilitet në rajon.

Duke e patur parasysh atë që të tri shtetet e tjera anëtare të UE-së në rajon janë anëtare, edhe të UE-së, edhe të NATO-s, këto i kanë të përbashkëta shumicën e qëllimeve dhe të politikave të tyre të jashtme. Në përgjithësi, që të tre këto shtete, Kroacia, Sllovenia dhe Bullgaria synojnë ta ruajnë dhe të forcojnë paqen dhe mirëkuptimin në fushën ndërkombëtare. Nga ana tjetër, duke e patur parasysh që Kroacia dhe Sllovenia ishin anëtare përbërëse të ish Jugosllavisë, përqendrimi i tyre i veçantë mbetet në zgjidhjen e çështjeve që kanë mbetur të hapura pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë; dhe kjo vlen posaçërisht për Kroacinë.²⁷² Ngjashëm, duke e patur parasysh të drejtën për vetëvendosje të Sllovenisë nga ish Jugosllavia, një nga drejtimet e politikave që Sllovenia i ndërmerr është që “ta respektojë dhe ta mbështesë të drejtën e kombeve për vetëvendosje.”²⁷³

Njësoj si edhe te shumica e vendeve të rajonit, Shtetet e Bashkuara e kanë një rol të veçantë në politikën e jashtme të këtyre tre shteteve anëtare të UE-së në rajon. Kroacia, për shembull, marrëdhëniet me SHBA-të i konsideron të jenë të një “rëndësie të veçantë”, dhe që “[f]orcimi i marrëdhënieve të partneritetit me SHBA-të mund të ketë një efekt pozitiv në pozitën e përgjithshme ndërkombëtare të Kroacisë dhe në realizimin e qëllimeve konkrete të politikave të saj të jashtme.”²⁷⁴ Kina dhe Rusia janë po ashtu në listën e vendeve me të cilat Kroacia mban marrëdhënie miqësore, edhe në aspektin politik, edhe në atë ekonomik.²⁷⁵ SHBA-të po ashtu e kanë një rol të rëndësishëm në politikën e jashtme të Bullgarisë.²⁷⁶ Bullgaria i sheh marrëdhëniet UE-SHBA si të rëndësishme për politikën e vet të jashtme, dhe përpiqet të zhvillojë marrëdhënie të fuqishme me SHBA-të dhe ta intensifikojë dialogun dhe bashkëpunimin politik në të gjitha nivelet; një nga synimet e Bullgarisë në marrëdhëniet e saj me SHBA-të është heqja e vizave për hyrje në SHBA për shtetasit bullgarë.²⁷⁷ Njësoj si edhe për shumicën e shteteve të tjera të rajonit, Rusia po ashtu e merr një vend të rëndësishëm në politikën e jashtme të Bullgarisë, me të cilën “dëshiron të vazhdojë të mbajë marrëdhënie stabile, miqësore dhe të parashikueshme.”²⁷⁸ Politika e jashtme e Sllovenisë nuk përqendrohet në ndonjë aktor të veçantë shtetëror apo në ndonjë fuqi globale; megjithatë, ajo i kushton vëmendje të veçantë UE-së dhe NATO-s si interesa strategjike të Sllovenisë.²⁷⁹

²⁷⁰ Ibid.

²⁷¹ Ibid.

²⁷² “Foreign Policy Aims” [“Synimet e Politikës së Jashtme”], MPJ, Kroaci.

²⁷³ “Foreign Policy – Western Balkans” [“Politika e Jashtme – Ballkani Perëndimor”], MPJ, Slloveni.

²⁷⁴ “Foreign Policy Aims” [“Synimet e Politikës së Jashtme”], MPJ, Kroaci.

²⁷⁵ Ibid.

²⁷⁶ “Foreign Affairs” [“Punët e Jashtme”], Ambasada e Republikës së Bullgarisë në Londër.

²⁷⁷ Ibid.

²⁷⁸ Ibid.

²⁷⁹ “Foreign Policy – Western Balkans” [“Politika e Jashtme – Ballkani Perëndimor”], MPJ, Slloveni.

4.2 Cilësia e marrëdhënieve me shtetet e tjera anëtare të UE-së

4.2.1 Marrëdhëniet bilaterale me SLOVENINË

Marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe Sllovenisë janë *shumë të mira*, një cilësim ky që nuk mund t'i atribuohet shteteve të tjera anëtare të UE-së në rajon që e kanë njohur Kosovën. Sllovenia është ndër shtetet anëtare të UE-së në rajon me të cilat Kosova i ka marrëdhëniet më të mira bilaterale. Marrëdhëniet bilaterale të Kosovës me Slloveninë janë madje edhe më të mira se ato me të gjithë fqinjët e saj, pos Shqipërisë. Në të vërtetë, pas Turqisë dhe Shqipërisë, shtete këto me të cilat Kosova ka marrëdhënie të shkëlqyera, Sllovenia është vendi i tretë në rajon me të cilin Kosova i ka marrëdhëniet më të mira, dhe kjo meqë Sllovenia Kosovën e konsideron të jetë një vend prioritar, meqë “Sllovenia dëshiron që i tërë rajoni të jetë i lirë, stabil, dhe ekonomikisht miqësor”.²⁸⁰ Këto marrëdhënie shumë të mira bilaterale përftohen nga rezultati i tërësishëm që Sllovenia e merr në aspektet fundamentale të marrëdhënieve të veta bilaterale me Kosovën. Së pari, krahasuar me shtetet e tjera anëtare të UE-së në rajon, Sllovenia e ka njohur Kosovën më 5 mars 2008, domethënë, brenda muajit të parë pas Shpalljes së Pavarësisë.²⁸¹ Marrëdhëniet diplomatike dhe marrëdhëniet në nivel ambasadorësh midis dy shteteve janë vendosur po ashtu brenda një muaji pas Shpalljes së Pavarësisë, dhe vetëm 10 ditë pasi që Sllovenia e kishte njohur Kosovën.²⁸²

Sllovenia e caktoi Ambasadorin e saj të parë në Prishtinë (Vojko Volk, që më parë kishte shërbyer si drejtues i Zyres Ndërlidhëse të Sllovenisë në Prishtinë)²⁸³ që në vitin 2008, që është më heret se që këtë e bënë Shqipëria apo Turqia. Sllovenia e vazhdoi përfaqësimin e saj diplomatik në nivelin e ambasadorëve në Prishtinë që nga koha kur e caktoi ambasadorin e saj të parë. Ambasadori i saj i dytë në Kosovë ishte Jožef Help, që shërbimin e tij në Prishtinë e filloi më 5 shkurt 2009, dhe e vazhdoi deri më 5 shtator 2013, kur u zëvendësua me Ambasadorin e tashëm të Sllovenisë në Prishtinë, Z. Miljan Majhen.²⁸⁴ Kosova, nga ana tjetër, e caktoi Ambasadorin e saj të parë në Ljublanë (Anton Berisha) mjaft kohë më vonë, më 5 janar 2010, që është rreth dy vite pasi që Sllovenia e kishte njohur Kosovën. Njësoj si edhe Sllovenia, që nga koha kur Kosova e caktoi ambasadorin e saj të parë në Ljublanë, përfaqësimi i saj diplomatik në pjesën më të madhe të kohës mbeti në nivel ambasadori. Ambasadori i parë i Kosovës në Ljublanë u zëvendësua më 1 korrik 2012 nga Mimoza Ahmetaj, e cila po ashtu u zëvendësua rreth një vit më vonë, më 30 shtator 2013 nga Nexhmi Rexhepi.²⁸⁵

Cilësia e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet e tjera anëtare të UE-së në rajon

	Shteti	Pikë	Cilësia
	Turqia	4.00	E shkëlqyer
	Shqipëria	3.88	E shkëlqyer
3	Sllovenia	3.25	Shumë e Mirë
	Maqedonia	3.13	Shumë e Mirë
5	Kroacia	2.63	E Mirë
6	Bullgaria	2.75	E Mirë
	Mali i Zi	1.88	Jo e Keqe
	Serbia	0.75	E dobët
	Greqia	0.25	E dobët
	Rumania	0.13	E dobët
	BH	0.00	E dobët

²⁸⁰ Miljan Majhen (Ambasador, Ambasada e Sllovenisë në Kosovë), intervistë në Prishtinë, 24 shtator, 2013.

²⁸¹ Shih vendet që e kanë njohur Kosovën në, <http://www.kosovothankyou.com/>.

²⁸² MPJ, dokument i brendshëm. .

²⁸³ “Presidenti Sejdiu priti ambasadorin e Sllovenisë, z. Vojko Volk”, qasur më 25 janar, 2014, <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,6,1050>

²⁸⁴ “President Jahjaga received the Ambassador of the Republic of Slovenia, Mr. Miljan Majhen” [“Presidentja Jahjaga e pranoi Ambasadorin e Republikës së Sllovenisë, Z. Miljan Majhen”], qasur më 26 janar, 2013, <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,8,3021>

²⁸⁵ Shih në, <http://www.ambasada-ks.net/si/?page=1,8,81>

Së dyti, Sllovenia renditet e dyta në mesin e shteteve anëtare të UE-së të rajonit, dhe e 6 ndër të gjitha vendet e rajonit me numrin e marrëveshjeve bilaterale që i kanë nënshkruar të dyja vendet, 6 në total, plus dy memorandume shtesë të bashkëpunimit.²⁸⁶ Natyra e marrëveshjeve midis Kosovës dhe Sllovenisë është e shumëllojshme, dhe këto shtrihen nga bashkëpunimi ekonomik dhe në zhvillim, e deri te bashkëpunimi midis parlamenteve përkatëse dhe kultura.

Së fundi, në mesin e vendeve të rajonit, Sllovenia ka qenë investitori më i madh në Kosovë me investimet mesatare vjetore prej 31 milionë € në periudhën midis viteve 2008-2012, gjë kjo që e rrit cilësinë e marrëdhënieve midis dy shteteve.²⁸⁷ Pos pranisë diplomatike dhe asaj të biznesit në Kosovë, Sllovenia është po ashtu njëri nga kontributorët kryesorë rajonal sa i përket numrave të trupave të udhëhequra nga NATO-ja në KFOR; kjo është vetëm pas Turqisë, dhe i ka dhënë 314 trupa.²⁸⁸ Zëvendës-komandanti i KFOR-it është po ashtu i kombësisë sllovene.²⁸⁹ Sllovenia po ashtu kontribuon për EULEX-in, ku kjo e ka në personel prej 23 vetash,²⁹⁰ dhe kreu i Zyres së UE-së në Kosovë, Samuel Zbogar është po ashtu i kombësisë sllovene. Si përmbledhje, Sllovenia është e pranishme në pothuaj të gjitha nivelet, edhe në sektorin politik, edhe në atë të biznesit.

4.2.2 Marrëdhëniet bilaterale me KROACINË

Marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe Kroacisë janë *të mira*, që është i njëjti cilësim që është i qartë edhe te Bullgaria si një shtet tjetër anëtar i UE-së që e ka njohur Kosovën. Megjithatë, Kroacia është në mesin e shteteve anëtare të UE-së në rajon me të cilat Kosova ka marrëdhënie paksa më të mira se ato me Bullgarinë, dhe paksa më të dobëta se ato me Slloveninë. Këto marrëdhënie bilaterale të mira përftohen nga rezultati i tërësishëm që Kroacia e merr në aspektet fundamentale të marrëdhënieve të veta me Kosovën. Së pari, Kroacia e njohu Kosovën më 19 mars 2009,²⁹¹ që don të thotë se Kroacisë iu desht më tepër se një muaj për ta bërë njohjen formale, për dallim nga rastet e Shqipërisë, Turqisë dhe të Sllovenisë, të cilat janë të vetmet vende të rajonit që Kosovën e njohën brenda muajit të parë. Marrëdhëniet diplomatike dhe marrëdhëniet në nivel ambasadorësh midis dy shteteve u vendosën më 30 qershor 2008, rreth tre muaj pasi që Kroacia e kishte bërë njohjen formale, për dallim nga Sllovenia, e cila është shtet tjetër anëtar i UE-së në rajon që në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën ka ecur më shpejtë se Kroacia.²⁹²

Duhet theksuar që Kroacia e caktoi Ambasadorin e vet të parë në Prishtinë (Zlatko Kramaric) më 17 janar 2009, pak më pak se një vit pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Para caktimit të Z. Kramaricit, Kroacia ishte e përfaqësuar përmes Dario Malnarit, që ishte Drejtues i Zyres Ndërlidhëse të Kroacisë në Prishtinë deri më 7 nëntor 2008, një periudhë kjo pas të cilës Z. Kramaric shërbeu si

²⁸⁶ Marrëveshjet Ndërkombëtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, qasur më 20 nëntor, 2013, <http://gazetazyrtare.rks.gov.net/MN.aspx>

²⁸⁷ "Direct investments in Kosovo" ["Investimet e drejtpërdrejta në Kosovë"], Banka Qendrore e Kosovës, qasur më 23 janar, 2014, https://docs.google.com/viewer?url=http%3A%2F%2Fwww.bqk-kos.org%2Frepository%2Fdocs%2Ftime_series%2F34%2520Foreign%2520direct%2520investments%2520-%2520by%2520country.xls.

²⁸⁸ "Troop Numbers & Contribution Nations" ["Numri i trupave dhe kombet kontributore"], NATO, qasur më 22 dhjetor, 2013, <http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/troop-numbers-contributions.aspx>.

²⁸⁹ Sipas faqes zyrtare të KFOR-it, numri i trupave shqiptare në KFOR është 308, dhe numri i personelit slloven në EULEX është 23. http://www.nato.int/kfor/structur/nations/placemap/kfor_placemat.pdf.

²⁹⁰ KIPRED, komunikim përmes e-mailit me zëdhënësin e EULEX-it në korrik 2013.

²⁹¹ Shih vendet që e kanë njohur Kosovën në, <http://www.kosovothanksyou.com/>.

²⁹² Dokument i brendshëm i MPJ.

Chargé d'affaires, deri në janar kur Z. Kramaric e mori pozitën e tij si Ambasadori i parë në Kosovë. Njësoj si edhe me shumicën e shteteve të tjera të rajonit me të cilat Kosova ka marrëdhënie të mira apo të shkëlqyera, Kroacia është përfaqësuar në nivel ambasadorësh që nga caktimi i ambasadorit të saj të parë pa ndonjë ndërprerje domethënëse. Pas përfundimit të mandatit të Z. Kramaric në dhjetor 2010, Kroacia e caktoi menjëherë, në mars 2011, Zoran Vodopijan si Ambasador të saj të ri në Prishtinë, dhe ky ka shërbyer në këtë detyrë deri në ditët e sotme.²⁹³ Këtu duhet përmendur atë që, për dallim nga rastet e dy fqinjëve të Kosovës (Maqedonisë dhe Malit të Zi), Kroacia nuk e ka kushtëzuar Kosovën me kërkesa për të drejta më të mëdha kushtetutare për kroatët që jetojnë në Kosovë, në kohën kur e njohu Kosovën, kur i vendosi marrëdhëniet diplomatike, apo kur e dërgoi ambasadorin. Mirëpo, Ambasada Kroate në Prishtinë është nën trysni për t'i ndihmuar ata pak kroatë që kanë mbetur në Kosovë, ndërkohë që Kosova ka premtuar po ashtu që kroatëve që jetojnë në Kosovë do t'u japë të drejta kushtetutare shtesë.²⁹⁴

Kur fjala është për palën kosovare, Prishtinës iu nevojiti rreth një vit e gjysmë pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve për ta caktuar Ambasadorin e saj të parë në Kroaci. Kosova e caktoi Valdet Sadikun si Ambasadorin e parë të plotfuqishëm të Republikës së Kosovës në Kroaci më 29 dhjetor 2009, i cili më vonë u zëvendësua pasi që e mori misionin e Zyrtarit për Ndërlidhje të Kosovës në Beograd, në qershor 2013.²⁹⁵ Mirëpo, Z. Sadiku nuk u zëvendësua menjëherë. Ambasada ishte duke u përfaqësuar nga Zëvendës Ambasadori Urtak Hamiti, i cili brenda disa muajsh u arrestua nga autoritetet kroate për sjelljen jodinjitoze dhe joprofesionale gjatë shërbimit të tij në Kroaci, si pasojë e të cilës MPJ e Kosovës e mori një notë proteste.²⁹⁶ Pos asaj që u zu gjatë vozitjes në gjendje të dehur, Z. Hamiti me sa duket refuzoi që oficerëve të policisë kroate t'ua paraqiste kredencialet e tij diplomatike, dhe u soll në mënyrë joprofesionale.²⁹⁷ Disa muaj pas këtij skandali, Kosova e caktoi ish Ambasadoren e vet në Budapest, Zonjën Shkëndije Geci Sherifin si Ambasadore të re të Kosovës në Zagreb, në gusht të vitit 2013.²⁹⁸

Së dyti, Kroacia renditet e para në mesin e shteteve anëtare të UE-së në rajon, dhe e pesta në mesin e të gjitha shteteve të rajonit me numrin e marrëveshjeve bilaterale që i kanë nënshkruar të dyja shtetet, që janë 8 në total, plus një Memorandum i Mirëkuptimit shtesë.²⁹⁹ Marrëveshjet midis dy shteteve dallojnë përnga natyra dhe e rregullojnë një brez të çështjeve në fushat e tilla si ato juridike, ekonomike, edukative, mbrojtëse, etj.³⁰⁰

Së fundi, ajo që Kroacinë e bën që të ketë marrëdhënie pak më të ulëta me Kosovën në krahasim me Slloveninë, për shembull, janë investimet e ulëta të Kroacisë në Kosovë. Kroacia renditet vetëm mbi BH-ën sa i përket investimeve vjetore në Kosovë, dhe është nën shumicën e mosnjohësve të rajonit.

²⁹³ "The new Croatian Ambassador presents his credentials" ["Ambasadori i ri kroat i paraqet kredencialet e veta"], qasur më 29 janar, 2014, <http://www.president-ks.gov.net/?page=2,6,1633>.

²⁹⁴ "Croatian minority in Kosovo" ["Pakica kroate në Kosovë"], State Office for Croats Abroad [Zyra shtetërore për kroatët jashtë vendit], qasur më 29 janar, 2014, <http://www.hrvatizvanrh.hr/en/hmiu/croatian-minority-in-kosovo/8>.

²⁹⁵ "President Jahjaga recieved Ambassador Valdet Sadiku" ["Presidentja Jahjaga e pranoi Ambasadorin Valdet Sadiku"], qasur më 28 janar, 2014, <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,6,2983>.

²⁹⁶ Shih Deklaratën për Shtyp të MPJ të Kosovës të 2 gushtit, 2013, qasur më 28 janar, 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,4,1814>.

²⁹⁷ Intervistë e KIPRED-it me gazetarin e Kosovës që e ka ndjekur këtë rast, 28 tetor 2013, Prishtinë.

²⁹⁸ "Shkëndije Geci ambasadore në Zagreb, rasti Hamiti i mbyllur", qasur më 28 janar, 2014, <http://www.koha.net/?page=1,13,154609>.

²⁹⁹ Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, qasur më 20 nëntor, 2013, <http://gazetazyrtare.rks.gov.net/MN.aspx>.

³⁰⁰ Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Kroacia i ka investuar vetëm 1.2 milionë € në vit në mesatare në periudhën midis viteve 2008-2012.³⁰¹ Pos pranisë diplomatike dhe asaj të biznesit në Kosovë, Kroacia po ashtu kontribuon me trupa dhe personel për KFOR-in dhe për EULEX-in respektivisht, edhe pse jo në numra të lartë krahasuar me shtetet e tjera të rajonit. Kjo merr pjesë me 23 trupa në KFOR³⁰² dhe me personel prej 14 vetash në EULEX.³⁰³

4.2.3 Marrëdhëniet bilaterale me BULLGARINË

Marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe Bullgarisë janë *të mira*, njësoj si edhe marrëdhëniet e Kosovës me Kroacinë si një shtet tjetër anëtar i UE-së në rajon. Mirëpo, edhe përkundrejt marrëdhënieve në tërësi të mira midis dy shteteve, kur të bëhet krahasimi me vendet e tjera të UE-së në rajon që e kanë pranuar Kosovën, Bullgaria renditet e fundit, që don të thotë që ka marrëdhënie pak më të dobëta me Kosovën se që i kanë Sllovenia dhe Kroacia. Këto marrëdhënie të mira biltarere përftohen nga rezultati i tërësishëm që Bullgaria e merr në aspektet fundamentale të marrëdhënieve të veta bilaterale me Kosovën. Së pari, Bullgaria e njohu Kosovën më 23 mars 2009,³⁰⁴ pesë ditë pasi që këtë e bëri Kroacia, që don të thotë që Bullgarisë iu nevojiti më tepër se një muaj për ta bërë njohjen formale, për dallim nga Shqipëria, Turqia dhe Sllovenia që janë të vetmet vende në rajon që Kosovën e kanë njohur brenda muajit të parë. Bullgaria është e pesta në mesin e 11 shteteve të tjera të rajonit që e kanë njohur Kosovën. Marrëdhëniet diplomatike dhe marrëdhëniet në nivelin e ambasadorëve midis dy shteteve u vendosën më 27 maj 2008, afër 3 muaj pasi që Bullgaria e bëri njohjen formale; dhe kjo don të thotë që marrëdhëniet diplomatike midis Kosovës dhe Bullgarisë u vendosën më shpejtë se ato me Kroacinë.³⁰⁵

Për dallim nga shtetet e tjera anëtare të UE-së të rajonit që e kanë njohur Kosovën, Bullgaria e caktoi Ambasadorin e saj të parë në Prishtinë (Krasimir Tulechki) më 28 tetor 2009, më tepër se një vit e gjysmë pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.³⁰⁶ Ambasada e Bullgarisë e trashëgoi praninë paraprake të Bullgarisë përmes Zyres së saj për Ndërlidhje në Prishtinë. Njësoj si edhe te shumica e shteteve të tjera të rajonit me të cilat Kosova ka marrëdhënie të mira apo të shkëlqyera, Bullgaria ka qenë e përfaqësuar në nivel ambasadorësh në pjesën më të madhe të kohës që nga koha e caktimit të Ambasadorit të saj të parë. Pasi që mandati i Z. Tulechki përfundoi më 2 gusht 2010, Bullgaria e caktoi Bobi Bobevin si Ambasador të saj të ri në Prishtinë, më 2 nëntor 2010, dhe ky ende shërben në këtë pozitë.³⁰⁷

Kur fjala është për palën kosovare, Prishtinës iu nevojitën rreth dy vite pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve për ta caktuar Ambasadorin e saj të parë në Bullgari. Kosova e caktoi Ariana Zherka-Hoxhën si Ambasadoren e parë të plotfuqishme të Republikës së Kosovës në Bullgari më 30 prill 2010.³⁰⁸ Kosova po ashtu e ruajti një prani pothuaj të pandërprerë në

³⁰¹ "Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations" ["Kosova në kontekstin rajonal; Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare"], KIPRED, 29-32.

³⁰² "Troop Numbers & Contribution Nations" ["Numri i trupave dhe kombet kontributore"], NATO, qasur më 22 dhjetor, 2013, <http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/troop-numbers-contributions.aspx>.

³⁰³ KIPRED, komunikim përmes e-mailit me zëdhënësin e EULEX-it në korrik 2013.

³⁰⁴ Shih vendet që e kanë njohur Kosovën në, <http://www.kosovothanksyou.com/>.

³⁰⁵ Dokument i brendshëm i MPJ.

³⁰⁶ Për informata të mëtejme shih linkun, qasur më 25 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,1274>.

³⁰⁷ "Bulgaria's Ambassador Bobi Bobev presents his credentials" ["Ambasadori i Bullgarisë Bobi Bobev i paraqet kredencialet e tij"], qasur më 22 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1434>.

³⁰⁸ "Sejdiu dekretoi ambasadoren e Kosovës në Bullgari", qasur më 20 janar, 2014, <http://www.telegrafi.com/lajme/sejdiu-dekretoi-ambasadoren-e-kosoves-ne-bullgari-2-5269.html>

Bullgari në nivelin e ambasadorëve që nga koha kur e caktoi Ambasadorin e vet të parë. Pas përfundimit të mandatit të Zherka-Hoxhës më 4 qershor 2012, Kosova e caktoi Shpend Kallabën si Ambasador të vet të ardhshëm, menjëherë më 29 qershor 2012, dhe ky ka qenë mjaft aktiv në takimet e veta bilaterale dhe multilaterale në Sofia dhe gjetkë në Bullgari.

Së dyti, Bullgaria renditet e 3-ta në mesin e shteteve anëtare të UE-së në rajon, dhe e 7-a në mesin e të gjitha vendeve të rajonit me numrin e marrëveshjeve bilaterale që i kanë nënshkruar të dyja shtetet, dhe këto janë 5 në total.³⁰⁹ Marrëveshjet midis dy shteteve dallojnë për nga natyra, dhe këto e rregullojnë një varg çështjes të tilla si policia, transporti, e kështu me radhë. Me nismën e Bullgarisë, dy shtetet e kanë nënshkruar një memorandum të bashkëpunimit për çështjet që kanë të bëjnë me integrimin evropain, më 2 dhjetor 2013.³¹⁰

Së fundi, Bullgaria renditet mbi Kroacinë, dhe është vetëm nën partnerët kryesorë investues të Kosovës, Sllovenisë, Turqisë dhe Shqipërisë, sa i përket investimeve të saj në Kosovë. Bullgaria i ka investuar vetëm 2.8 milionë € në vit, në mesatare, në periudhën midis viteve 2008-2012, më tepër se dy herë më shumë se investimet e Kroacisë në Kosovë.³¹¹ Pos pranisë diplomatike dhe asaj të biznesit në Kosovë, Bullgaria po ashtu kontribuon me trupa dhe personel për KFOR-in dhe EULEX-in, respektivisht. Edhe pse është njëri nga kontributorët më të ulët në strukturat e KFOR-it, Bullgaria është kontributori më i madh sa i përket personelit në strukturat e EULEX-it, krahasuar me shtetet e tjera të rajonit. Kjo merr pjesë me 11 trupa në KFOR³¹² dhe me personel prej 91 vetash në EULEX.³¹³

4.2.1 Çështjet bilaterale shtesë të Kosovës me shtetet e tjera anëtare të UE-së

Liria e lëvizjes për qytetarët e Kosovës në vendet e tjera, dhe mungesa rezultuese e pengesave për këtë lëvizje, është një aspekt tjetër fundamental që i kontribuon cilësisë së marrëdhënieve bilaterale midis shteteve. Sa i përket shteteve anëtare të UE-së të rajonit që e kanë njohur Kosovën, që të gjithat kanë rezultat të ulët lidhur me këtë aspekt fundamental, meqë që të gjithat zbatojnë pengesa në hyrje për qytetarët e Kosovës. Sllovenia është pjesë e zonës së Schengenit, ndërkohë që Kroacia dhe Bullgaria i nënshtrohen kërkesës ligjore për t'i zbatuar rregullat e Schengenit për qytetarët e vendeve të treta; prandaj, që të tre shtetet anëtare të UE-së të rajonit zbatojnë viza hyrëse për qytetarët e Kosovës.³¹⁴ Nga ana tjetër, Kosova nuk ka zbatuar asnjë herë pengesa në hyrje për cilindo nga shtetet anëtare të UE-së.³¹⁵

4.2.2 Shtetet e tjera të UE-së në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës

Që të gjitha shtetet anëtare të UE-së që e kanë njohur Kosovën e përkrahin forcimin e subjektivitetit dhe të përfaqësimit ndërkombëtar të Kosovës si një shtet i pavarur dhe sovran, edhe pse përmasa deri në të cilën çdonjëri nga këto shtete e përkrah Kosovën ndryshon. Pas propozimit fillestar të Martti Ahtisaarit për pavarësinë e kushtëzuar të Kosovës, dhe vetëm disa muaj para se Kosova ta

³⁰⁹ Marrëveshjet Ndërkombëtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

³¹⁰ Bobi Bobev (Ambasador, Ambasada e Bullgarisë në Kosovë), intervistë në Prishtinë, 3 tetor, 2013.

³¹¹ "Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations" ["Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare, KIPRED, 29-32.

³¹² "Troop Numbers & Contribution Nations" ["Numri i trupave dhe kombet kontributore"], NATO, qasur më 22 dhjetor, 2013, <http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/troop-numbers-contributions.aspx>.

³¹³ KIPRED, komunikim përmes e-mailit me zëdhënësin e EULEX-it në korrik, 2013.

³¹⁴ "Visas for Kosovo citizens" ["Vizat për qytetarët e Kosovës"], MPJ, Kosovë.

³¹⁵ "Who doesn't need a visa?" ["Kush nuk ka nevojë për viza?"], MPJ, Kosovë.

shpallte pavarësinë e saj, Sllovenia e luajti një rol shumë të rëndësishëm në përpjekjet për ta konsoliduar qëndrimin e përbashkët të UE-së dhe për ta përgatitur terrenin përbrenda UE-së lidhur me Shpalljen, në atë kohë të ardhshme, të Pavarësisë së Kosovës. Nga janari 2008 deri në korrik të po të njëjtit vit, Sllovenia e kishte Presidencën në Këshillin e UE-së, dhe e shfrytëzoi pozitën e vet si vend Kryesues i UE-së për ta vënë çështjen e Kosovës sa më lartë në rendin e ditës dhe për ta përkrahur pavarësinë e Kosovës.³¹⁶

Pos kësaj, Sllovenia nuk votoi, as për, dhe as kundër rezolutës së Serbisë para APKB të 8 tetorit 2008, që rasti i Kosovës t'i dorëzohet GJND-së, dhe as nuk e bojkotoi takimin ashtu siç bënë disa vende të tjera; Sllovenia vetëm vendosi të abstenonte.³¹⁷ Megjithatë, Sllovenia dorëzoi deklarata pozitive të shkruara në përkrahje të ligjshmërisë së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës para GJND-së, dhe atë në të dyja rastet: së pari më 17 prill 2009, dhe së dyti, kjo dërgoi deklarata përkrahëse shtesë para afatit të dytë të fundit më 24 korrik 2009.³¹⁸ Nga ana tjetër, Sllovenia nuk bëri deklarime gojore gjatë dëgjimeve publike të mbledhjeve shtesë të GJND-së të dhjetorit 2009. Sllovenia ka votuar po ashtu në përkrahje të anëtarësisë së Kosovës në FMN, më 3 maj 2009, dhe në Bankën Botërore, më 3 qershor 2009.³¹⁹ Pos kësaj, Sllovenia i ka ofruar Kosovës asistencë të vazhdueshme teknike në fushat e procesit të integritimit në strukturat euroatlantike, dhe, fakti që Sllovenia është një ish-anëtare përbërëse e ish-Jugosllavisë, dhe anëtar aktual i UE-së, Slloveninë e ka bërë një kandidat të mirë për të ofruar përkrahje, jo vetëm Kosovës, por edhe të tërë rajonit lidhur me këto çështje. Sllovenët po ashtu e kanë përkrahur Kosovën dhe kauzën e saj të lirisë dhe të pavarësisë në disa raste të tjera, ku vetë sllovenët kanë organizuar protesta me qëllim që ta ngritin vëmendjen për problemin e Kosovës.³²⁰

Kroacia ka qenë po ashtu një nga përkrahësit e pavarësisë së Kosovës. Ngjashëm me Slloveninë, Kroacia ka abstenuar, për shembull, lidhur me rezolutën e Serbisë të 8 tetorit para APKB, për t'ia dorëzuar rastin e Kosovës GJND-së.³²¹ Kroacia nuk e ka dorëzuar ndonjë deklaratë të shkruar, dhe as komente shtesë para afateve të fundit të GJND-së për ta bërë këtë, më 17 prill 2009, apo më 24 korrik 2009, as në përkrahje, dhe as kundër ligjshmërisë së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Mirëpo, Kroacia e ka bërë një deklaratë pozitive gojore gjatë dëgjimeve publike të GJND-së në dhjetor 2009, duke argumentuar që “Kosova ka qenë një pjesë përbërëse e Jugosllavisë, kështu që e ka patur të drejtën për vetëvendosje dhe për shpalljen e pavarësisë; [dhe që] shqiptarët e Kosovës, edhe pse ata e paraqesin 90 përqind të popullatës së Kosovës, kanë qenë për vite me radhë viktimat të reprezaljeve nga autoritetet serbe. Vullneti i popullit duhet të jetë elementi themelor në përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës.”³²² Kroacia, njësoj si edhe përkrahësit e tjerë të legjitimitetit dhe të përfaqësimit të forcuar ndërkombëtar të Kosovës, e ka përkrahur anëtarësinë e Kosovës në FMN duke votuar për anëtarësimin e saj, më 3 maj 2009, dhe kjo po ashtu e përkrahu anëtarësinë e Kosovës në Bankën Botërore, duke votuar për anëtarësimin e saj, më 3 korrik 2009.³²³ Duke e patur

³¹⁶ Miljan Majhen (Ambasador, Ambasada Sllovene në Kosovë), intervistë në Prishtinë, 24 shtator, 2013.

³¹⁷ Dokument i brendshëm nga MPJ.

³¹⁸ Për informata shtesë lidhur me dokumentin që MPJ e Sllovenisë e ka dorëzuar lidhur me rastin e Kosovës, shih linkun në vijim, qasur më 22 dhjetor, 2013, <http://www.ici-cij.org/docket/files/141/15696.pdf>.

³¹⁹ Dokument i brendshëm nga MPJ.

³²⁰ Miljan Majhen (Ambasador, Ambasada Sllovene në Kosovë), intervistë në Prishtinë, 24 shtator, 2013.

³²¹ Dokument i brendshëm nga MPJ.

³²² Për informata të mëtejme për dokumentin e publikuar nga GJND-ja, shih linkun, qasur më 23 dhjetor, 2013, <http://www.ici-cij.org/docket/files/141/15724.pdf>.

³²³ Dokument i brendshëm nga MPJ.

parasysh që siguria dhe stabiliteti rajonal janë pjesë të prioriteteve të politikës së saj të jashtme, Kroacia është një përkrahës i patundur i anëtarësimit të Kosovës në strukturat euroatlantike, dhe kjo e përkrah fuqishëm përfaqësimin e Kosovës në organizatat dhe në forumet rajonale. Kjo u pa qartë kur Kroacia vendosi ta bojkotonte Samitin e Ohrit në reagim të vendimit të Presidentit të Maqedonisë për të mos e ftuar Kosovën.

Njësoj si edhe përkrahësit e tjerë të Kosovës në skenën ndërkombëtare, Bullgaria e ka përkrahur po ashtu forcimin e legjitimitetit dhe të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Bullgaria, njësoj si edhe dy shtetet e tjera anëtare të UE-së të rajonit që e kanë njohur Kosovën, ka vendosur që të mos votojë, as për, dhe as kundër, rezolutës së Serbisë të 8 tetorit 2008 para APKB, e cila e thërriste GjND-në ta shqyrtonte ligjshmërinë e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, dhe kështu kjo vendosi të abstenonte.³²⁴ Bullgaria, nga ana tjetër, nuk ka dorëzuar ndonjë deklaratë të shkruar para GjND-së në afatin e parë të fundit, më 17 prill 2009, dhe as nuk dorëzoi çfarëdo komentesh shtesë deri në afatin e fundit të dytë, më 24 korrik 2009. Mirëpo, Bullgaria ofroi deklarime përkrahëse gojore gjatë dëgjimeve publike të dhjetorit 2009 para GjND-së, duke pohuar që “E drejta ndërkombëtare nuk i ndalon shpalljet e pavarësisë dhe as secesionin, [dhe që] [sh]pallja e pavarësisë nuk e ka shkelur asnjë dispozitë të të drejtës ndërkombëtare.”³²⁵ Bullgaria po ashtu përpiket ta përkrahë Kosovën përmes mekanizmave të integritit të UE-së, d.m.th. ajo konsideron që është shumë e rëndësishme për Kosovën që ta nënshkruaj Marrëveshjen për Stabilitet dhe Asociim (MSA), meqë kjo do t’i rriste më tutje marrëdhëniet midis dy vendeve.³²⁶ Duke e patur parasysh që Bullgaria e ka njohur Kosovën, kjo e përkrah njohjen e saj nga sa më tepër vende që të jetë e mundur; mirëpo, midis dy vendeve nuk ka mekanizma institucionale që do t’i koordinonin veprimet e tyre lidhur me këtë çështje.³²⁷ Bullgaria ka votuar po ashtu në favor të anëtarësimit të Kosovës në FMN, më 3 maj 2009, dhe në Bankën Botërore, më 3 qershor 2009. Këtu po ashtu duhet përmendur që në takimet bilaterale midis zyrtarëve të Kosovës dhe të Bullgarisë, Bullgaria ka qenë e përkushtuar për ta ndihmuar Kosovën me një numër njohjesh, si dhe me anëtarësimin në organizatat relevante ndërkombëtare.³²⁸

Së fundi, përkrahja që Sllovenia, Kroacia dhe Bullgaria ia japin dialogut të ndihmuar nga UE-ja midis Kosovës dhe Serbisë, është e natyrshme, duke e patur parasysh atë që të gjitha këto tre shtete janë shtete anëtare të vetë UE-së. Prandaj, lidhur me këtë, ato e përcjellin udhëheqjen e UE-së. Sllovenia, si edhe në rastin e Shqipërisë, fillimisht u duk se e ka një qëndrim të rreshtuar me Kosovën lidhur me vijat e kuqe si ‘nuk ka negociata për statusin’ apo ‘jo çështjet e riorganizimit’, gjëra këto që janë diskutuar midis presidentëve të Kosovës dhe të Sllovenisë.³²⁹ Po ashtu, më vonë, presidentët e të dyja vendeve, dhe posaçërisht Presidenti i Sllovenisë, e kanë përsëritur që procesi i dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, dhe dialogu midis UE-së dhe Kosovës lidhur me pranimin e kësaj të fundit në UE janë dy procese të ndara dhe që këto duhet të lëvizin paralelisht.³³⁰ Megjithatë, negociatat midis

³²⁴ Dokument i brendshëm nga MPJ.

³²⁵ Për informata të mëtejme për dokumentin e publikuar nga GjND-ja, shih linkun, qasur më 23 dhjetor, 2013, <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15718.pdf>.

³²⁶ Ibid.

³²⁷ Bobi Bobev (Ambasador, Ambasada e Bullgarisë në Kosovë), intervistë në Prishtinë, 3 tetor, 2013.

³²⁸ “On the first day of his official visit to Bulgaria, Prime Minister Thaçi was received with the highest state honors at the Presidency of the Republic of Bulgaria” [“Në ditën e parë të vizitës së tij zyrtare në Bullgari, Kryeministri Thaçi mori nderimet më të larta shtetërore në Presidencën e Republikës së Bullgarisë”], qasur më 24 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,2942>.

³²⁹ “President Jahjaga returned from the official visit to Poland” [“Presidentja Jahjaga u kthye nga vizita zyrtare në Poloni”], qasur më 15 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1815>.

³³⁰ “President Atifete Jahjaga was received by the President of Slovenia Danilo Turk” [“Presidentja Atifete Jahjaga u pranua nga Presidenti i Sllovenisë Danilo Turk”], qasur më 15 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,1902>.

Kosovës dhe Serbisë dolën të jenë rreth ‘riorganizimit të brendshëm’ të Kosovës, ku policia, sektori juridik, dhe krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë, si dhe disa çështje të brendshme të tjera, jo vetëm që u diskutuan që të gjithat, por për më tepër, për to u arrit edhe pajtimi. Zyrtarët slovenë e kanë lavdëruar udhëheqësinë, edhe të Kosovës, edhe të Serbisë, për kuptimin e realitetit në terren dhe për guximin që këto çështje t’i çojnë përpara.³³¹ Një rast i ngjashëm ka qenë në vizitat midis zyrtarëve të lartë të Kosovës dhe të Kroacisë, si dhe midis zyrtarëve të lartë të Kosovës dhe të Bullgarisë, ku janë përmendur të njëjtat pika (për vijat e kuqe, ku u fitua përkrahja paraprake),^{332dhe333} mirëpo u lavdëruan rezultate përfundimtare të ngjashme, pavarësisht nga prishja e vijave të kuqe që u paraqitën dhe që u përkrahën në fillim.^{334dhe335}

4.3 Intensiteti i marrëdhënieve me shtetet e tjera anëtare të UE-së

4.3.1 Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Kroacia

Nga aspekti i intensitetit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe shteteve anëtare të UE-së të rajonit që e kanë njohur Kosovën, kjo nuk ka marrëdhënie as shumë intensive dhe as intensive me asnjërin prej tyre. Për shembull, Kosova ka marrëdhënie bilaterale *pak intensive* me Kroacinë. Kjo don të thotë që

Intensiteti i marrëdhënieve të Kosovës me shtetet e tjera anëtare të UE-së në rajon

Shteti	Pikë	Intensiteti
Shqipëria	3.75	Shumë Intensive
Turqia	2.25	Intensive
Maqedonia	2.00	Pak Intensive
4 Kroacia	2.00	Pak Intensive
5 Sllovenia	2.00	Pak Intensive
6 Bullgaria	1.00	Pak Intensive
Greqia	1.00	Pak Intensive
Serbia	1.00	Pak Intensive
Mali i Zi	0.75	Joaktive
BH	0.50	Joaktive
Rumania	0.00	Joaktive

nga aktiviteti bilateral i tërësishëm midis dy shteteve, të shprehur nga aspekti i takimeve dhe vizitave në nivelet presidenciale, kryeministore dhe të ministrave të jashtëm, si dhe nga ai i aktivitetit ekonomik dhe tregtar, marrëdhëniet e Kosovës me Kroacinë janë më pak intensive se ato midis Kosovës dhe Shqipërisë, Turqisë apo Maqedonisë. Që nga Shpallja e pavarësisë në shkurt 2008, janë bërë rreth 16 vizita dhe takime të ndërsjella në të dyja anët e kufirit. Kosova ka qenë shumë më aktive në bërjen e vizitave në Kroaci në nivelet e sipërpërmendura, se e anasjellta; në fakt, zyrtarët e nivelit të lartë të Kosovës kanë bërë rreth tre herë më shumë vizita në Kroaci se e anasjellta.

Brenda periudhës pak më të gjatë se pesë vite (midis 17 shkurtit 2008 dhe 30 shtatorit 2013), janë bërë 6 vizita presidenciale, nga të cilat 4 janë bërë në Kroaci dhe 2 në Kosovë. Vizita e parë zyrtare në Kroaci nga një President i Kosovës është bërë më 19 shkurt 2010, kur ish Presidenti Fatmir Sejdiu e vizitoi Zagrebin me rastin e hapjes së Ambasadës së Republikës së Kosovës në Kroaci, një vizitë kjo që ndodhi rreth dy vite pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve.³³⁶ Që nga

³³¹ “President Jahjaga nominated Mr. Nasuf Aliu as a member of CEC” [“Presidentja Jahjaga e emëroi Z. Nasuf Aliun si anëtar i KQZ-së”], qasur më 15 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,3027>.

³³² Shih në <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1815> dhe <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1808>.

³³³ Ibid.

³³⁴ “Today, the Prime Minister of the Republic of Kosovo, Hashim Thaci, meets the President of the Republic of Croatia, Ivo Josipovic” [“Sot, Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi takohet me Presidentin e Republikës së Kroacisë, Ivo Josipovic”], qasur më 16 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,3735>.

³³⁵ “Prime Minister of Kosovo, Hashim Thaci is recieved by the Prime Minister of Bulgaria, Marin Raykov, and the President of Bulgaria, Rossen Pevnelev” [“Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi pranohet nga Kryeministri i Bullgarisë, Marin Raykov, dhe nga Presidenti i Bullgarisë, Rossen Pevnelev”], qasur më 16 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,3532>.

³³⁶ “Sejdiu: Croatia has always voiced her strong support for our objectives of freedom and independence” [“Sejdiu: Kroacia e ka shprehur gjithmonë përkrahjen e saj të fuqishme për qëllimin tonë të lirisë dhe të pavarësisë”], qasur më 19 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,291>.

atëherë, kanë qenë tre vizita të tjera presidenciale në Kroaci, nga një në çdonjërin nga vitet vijuese. Vizita e fundit ndodhi më 1 korrik 2013, me rastin e hyrjes së Kroacisë në UE. Nga ana tjetër, kanë qenë vetëm dy vizita presidenciale në Kosovë nga presidentët e Kroacisë, njëra nga Stipe Mesic, më 8 janar 2010, dhe tjetra, e cila ishte edhe e fundit, nga Ivo Josipovic, më 6 shtator 2013.

Kur vijmë te vizitat e ndërsjella në nivelin qeveritar, që nga koha kur Kosova e shpalli pavarësinë e vet, kanë qenë pesë vizita dhe takime në nivelin kryeministral dhe 5 të tjera në nivelin e ministrave të jashtëm. Mirëpo, ndërkohë që Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, që vazhdon ta mbajë postin që nga viti 2007, e ka vizituar Kroacinë 4 herë, Kroacia e ka bërë vetëm një vizitë në Kosovë në nivelin kryeministral, kur ish Kryeministrja e Kroacisë, Jadranka Kosor, e vizitoi Kosovën më 24 gusht 2011.³³⁷ Ngjashëm me vizitat në nivelin kryeministral, Kosova ka bërë më tepër vizita në Kroaci në nivelin e ministrave të jashtëm, ndërkohë që Kroacia atë e ka vizituar vetëm një herë në këtë nivel, gjë kjo që ishte pjesë e formatit multilateral, më 4 tetor 2012, me rastin e Samitit Ndërkombëtar të Grave të mbajtur në Prishtinë.³³⁸ Pos shumicës së këtyre vizitave dhe kontakteve bilaterale, zyrtarët e lartë të të dyja shteteve janë takuar po ashtu në forume dhe në mbledhje të tjera rajonale dhe ndërkombëtare. Ajo që është e veçantë për marrëdhëniet midis dy shteteve kur ndodhin vizita dhe takime, është që, edhe përkundrajt vizionit të përbashkët për të ardhmen euroatlantike të rajonit, që të dyja palët i angazhojnë komunitetin shqiptar në Kroaci dhe komunitetin kroat në Kosovë si pjesë të rrethit dhe të bisedimeve të tyre të ditës në pothuaj të gjitha këto takime.

Ajo që i kontribuon marrëdhënieve pak intensive midis dy shteteve është po ashtu edhe vëllimi i shkëmbimit tregtar midis Kosovës dhe Kroacisë. Vëllimi tregtar mesatar vjetor midis dy vendeve brenda periudhës 2008-2012 ka qenë 62.8 milionë €, gjë kjo që Kroacinë e shndërron vetëm në partnerin e 8 tregtar në mesin e vendeve në rajon.³³⁹

4.3.2 Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Sllovenia

Marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe Sllovenisë janë *pak intensive*, dhe këto janë mjaft të ngjashme me ato midis Kosovës dhe Kroacisë; megjithatë, intensiteti i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Sllovenisë forcohet më tepër për shkak të aktivitetit ekonomik, ndërkohë që pëson paksa në aktivitetin politik. Prandaj, marrëdhëniet e Kosovës me Slloveninë janë madje edhe më pak intensive se ato midis Kosovës dhe Kroacisë. Që nga Shpallja e Pavarësisë në shkurtin e vitit 2008, janë bërë rreth 16 vizita dhe takime të ndërsjella në të dyja anët e kufirit. Njësoj si edhe në aktivitetet në marrëdhëniet e saj me Kroacinë, Kosova ka qenë më aktive në bërjen e vizitave në Slloveni se e anasjellta. Brenda periudhës pak më të gjatë se pesë vjet (midis 17 shkurtit 2008 dhe 30 shtatorit 2013), është bërë një total prej 10 vizitave në Slloveni, në nivelet presidenciale, kryeministrale dhe në atë të ministrave të jashtëm, dhe 6 vizita janë bërë në Kosovë nga të njëjtit zyrtarë të nivelit të lartë të Sllovenisë.

Brenda të njëjtës periudhë, janë bërë vetëm 3 vizita presidenciale, nga të cilat 1 është bërë në Slloveni dhe 2 të tjera në Kosovë. Vizita e parë zyrtare në Slloveni nga një President i Kosovës është bërë më

³³⁷ Shih në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9>.

³³⁸ Për informata të mëtejme për fjalimin e mbajtur nga Presidentja Atifete Jahjaga, shih linkun në vijim, qasur më 19 janar, 2014, <http://www.president-ks.gov.net/?page=2,6,2558>.

³³⁹ “Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare], KIPRED, 29-32.

19 korrik 2011, kur Presidentja e tashme, Atifete Jahjaga, e vizitoi Slloveninë, dhe kjo ishte vizita e parë në Slloveni e një Presidenti të Kosovës brenda pesë viteve e gjysmë. Mirëpo, presidentët e Kosovës janë takuar me presidentët e Sllovenisë po ashtu edhe në mjedise multilaterale dhe në nisma ndërkombëtare. Presidenti i parë slloven që e vizitoi Kosovën ishte Danilo Turk, i cili këtë vizitë në Kosovë e bëri më 21 dhjetor 2009,³⁴⁰ ndërkaq, vizita e dytë presidenciale u bë nga Borut Pahor më 11 shtator 2013.³⁴¹

Kur vijmë te vizitat qeveritare, është bërë një total prej 13 takimesh të ndërsjella, 5 në nivelin kryeministrot, dhe 8 të tjera në nivelin e ministrave të jashtëm. Kryeministri i Kosovës e ka vizituar Slloveninë 4 herë, duke qenë kështu më aktiv në vizitat në Ljubljana se që ishte homologu i tij në vizitat Prishtinës. Kryeministri Hashim Thaçi e vizitoi Slloveninë për herë të parë më 16 prill 2009,³⁴² dhe vizita e tij e fundit ishte më 6 shtator 2013.³⁴³ Nga ana tjetër, Kryeministri slloven Borut Pahor, në të vetmen vizitë Kosovës në këtë nivel, erdhi në Kosovë më 8 mars 2010.³⁴⁴ Ministrat e Punëve të Jashtme të Kosovës (Skender Hyseni dhe Enver Hoxhaj) e kanë vizituar Slloveninë 4 herë, ku vizita e parë në Slloveni ishte nga Ministri Hyseni më 20 maj 2009,³⁴⁵ dhe e fundit ishte nga Ministri Hoxhaj më 26 qershor 2013.³⁴⁶ Ministrat e jashtëm të të dyja shteteve janë takuar po ashtu në takime të tjera që bëheshin në formate multilaterale. Nga ana tjetër, Ministrat e Jashtëm të Sllovenisë e kanë vizituar Kosovën 3 herë, dhe takimi i parë u bë më 21 prill 2009 nga ish Ministri i Jashtëm, dhe Udhëheqësi aktual i Zyres së UE-së në Kosovë, Samuel Zbogar.³⁴⁷ Hera e fundit që një ministër i jashtëm slloven e vizitoi Kosovën ishte më 18 nëntor 2011.³⁴⁸

Karakterit i takimeve midis dy shteteve ka qenë miqësor me synim të forcimit të marrëdhënieve bilaterale dhe të arritjes së qëllimeve të politikave të tyre rajonale. Nga njëra anë, në pothuaj secilin takim zyrtarët sllovenë e kanë siguruar Kosovën për përkrahjen që Sllovenia do ta ofrojë në integrimin rajonal dhe ndërkombëtar, dhe që do të ofrojë përkrahje teknike në procesin e integritimit në UE. Nga ana tjetër, zyrtarët e Kosovës e kanë shprehur në pothuaj çdo rast synimin e tyre për integrimin euroatlantik dhe për përkrahjen që Sllovenia mund ta ofrojë lidhur me liberalizimin e vizave, të cilën Sllovenia ishte e gatshme ta ofrojë, dhe kjo është diçka që tashmë jemi duke e dëshmuar përmes bashkëpunimit të ndërsjellë që është në rrjedhje e sipër midis ministrive përkatëse të Administratës Publike, të Punëve të Brendshme dhe të Mbrojtjes/Sigurisë.³⁴⁹ Duke e patur

³⁴⁰ “Presidenti Sejdiu priti Presidentin e Republikës së Sllovenisë, Danilo Turk”, qasur më 15 janar, 2014, <http://www.president-ks.gov.net/?page=1,6,451>.

³⁴¹ “Prime Minister of the Republic of Kosovo Hashim Thaci met President of the Republic of Slovenia Borut Pahor over luncheon” [“Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi u takua me Presidentin e Republikës së Sllovenisë Borut Pahor në një drekë zyrtare”], qasur më 15 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,3750>.

³⁴² “Prime Minister Hashim Thaçi is welcomed by the Slovenian President, Danilo Turk” [“Kryeministri Hashim Thaçi u mirëprit nga Presidenti i Sllovenisë, Danilo Turk”], qasur më 15 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,515>.

³⁴³ “Thaçi sonte në Slloveni”, qasur më 15 janar, 2014, <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,15,68756>

³⁴⁴ “Kryeministri slloven arrin për vizitë në Kosovë”, qasur më 15 janar, <http://www.mesazhi.com/artikuj/prishtine-kryeministri-slloven-arrine-per-vizite-ne-kosove>

³⁴⁵ Ministri Hyseni merr pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm të shteteve në Partneritetin Rajonal dhe Ballkanin Perendimorë qasur, më 15 janar, 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,179&offset=1>

³⁴⁶ Shiko takimin e Ministrat të Jashtëm të Rep. së Kosovës Enver Hoxhaj me Presidentin e Sllovenisë Borut Pahor, qasur më 15 janar, 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=1,4,1774&offset=2>

³⁴⁷ Minister Hyseni and the Foreign Minister of Slovenia sign bilateral Cooperation Agreement, [“Ministri Hyseni dhe Ministri i Jashtëm i Sllovenisë nënshkruajnë Marrëveshje Bilaterale për Bashkëpunim”] qasur më 15 janar, 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,172&offset=1>.

³⁴⁸ Prime Minister Thaçi met today with, Mr. Samuel Zbogar, Minister of Foreign Affairs, Republic of Slovenia, [“Kryeministri Thaçi u takua sot me Z. Samuel Zbogar, Ministër i Jashtëm i Sllovenisë”] qasur më 15 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,2491>

³⁴⁹ Miljan Majhen (Ambasador, Ambasada e Sllovenisë në Kosovë), Intervistë në Prishtinë, 24 shtator, 2013.

parasysh që Sllovenia është njëri nga investitorët më të mëdhenj rajonalë në Kosovë, një nga çështjet e tjera të rëndësishme që është trajtuar në të gjitha këto takime është forcimi i bashkëpunimit në sektorin ekonomik.³⁵⁰ Edhe përkundrejt investimeve të larta të Sllovenisë në Kosovë, vëllimi tregtar midis dy vendeve nuk është tejet bindës, ku me një mesatare vjetore prej 71 milionë € midis viteve 2008-2012, Sllovenia renditet si partneri i shtatë tregtar i Kosovës në rajon.³⁵¹

4.3.3 Intensiteti i marrëdhënieve bilaterale – Kosova dhe Bullgaria

Marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe Bullgarisë janë *pak intensive*, dhe janë paksa më pak intensive krahasuar me marrëdhëniet e Kosovës me shtetet e tjera anëtare të UE-së të rajonit që e kanë njohur Kosovën (Kroacia dhe Sllovenia). Rezultatet e Bullgarisë janë pak më të ulëta në intensitetin e marrëdhënieve bilaterale me Kosovën në të dyja frontet, në atë politik (për shkak të numrit më të vogël të vizitave dhe të takimeve bilaterale), dhe në atë ekonomik (për shkak të vëllimit më të ulët të tregtisë) midis dy shteteve, krahasuar me vendet tjera të rajonit që kanë patur rezultat më të lartë nga aspekti i marrëdhënieve bilaterale. Që nga Shpallja e Pavarësisë në shkurtin e vitit 2008, janë bërë rreth 6 vizita dhe takime të ndërsjella në të dyja anët e kufirit. Njësoj si edhe te aktiviteti në marrëdhëniet e saj me Kroacinë dhe me Slloveninë, Kosova ka qenë shumë më aktive në bërjen e vizitave në Bullgari se e anasjellta; në fakt, lidhur me këtë çështje, këtu Kosova ka qenë dy herë më aktive. Brenda periudhës pak më të gjatë se pesë vjet (midis 17 shkurtit 2008 dhe 30 shtatorit 2013), është bërë një total prej 4 vizitash në Bullgari në nivelet presidenciale, kryeministore dhe në atë të ministrave të jashtëm, dhe, po ashtu, janë bërë 2 vizita në Kosovë në të njëjtat nivele të zyrtarëve të lartë të Bullgarisë.

Brenda po të njëjtës periudhë, është bërë vetëm 1 vizitë presidenciale, e cila ishte vizita në Bullgari e Presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga, më 25 shtator 2012, rreth katër vjet pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve.³⁵² Nga ana tjetër, asnjëri nga presidentët e Bullgarisë, as Presidenti i mëparshëm Georgi Parvanov, as ai i tashëm Rosen Plevneliev, nuk e kanë vizituar Kosovën asnjë herë.

Kur fjala vjen për vizitat dhe takimet në nivelin qeveritar, është bërë një total prej vetëm 5 vizitash, nga të cilat 2 janë bërë në nivelin kryeministror, dhe 3 të tjera në nivelin e ministrave të jashtëm. Që të dyja vizitat në nivelin kryeministror u bënë në Bullgari nga Kryeministri i tashëm i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili Bullgarinë e vizitoi për herë të parë më 18 qershor 2012, më tepër se katër vjet pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve, dhe herën e dytë më 15 maj 2013. Nga ana tjetër, që nga Shpallja e Pavarësisë, ende nuk ka patur vizita nga Kryeministri i Bullgarisë në Kosovë. Ministrat e jashtëm të të dyja shteteve janë takuar vetëm tre herë brenda kësaj periudhe prej më tepër se pesë vjet e gjysmë; dy nga vizitat u bënë në Kosovë nga Ministri i Jashtëm i Bullgarisë (në vitet 2010 dhe 2011), dhe tjetra u bë më 27 qershor 2011 nga Ministri i Jashtëm i Kosovës, në të cilin rast u nënshkruan dy marrëveshje bilaterale: Marrëveshja për Bashkëpunim midis dy Ministrive, si dhe Marrëveshja për Transportin Ndërkombëtar të të mirave dhe të pasagjerëve.³⁵³

³⁵⁰ "Slovenia a regional and european partner of Kosovo" ["Sllovenia, partner rajonal dhe evropian i Kosovës"], qasur më 21 janar, 2014, <http://www.ambasada-ks.net/si/?page=1,8,75>.

³⁵¹ "Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations" ["Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare"], KIPRED, 29-32.

³⁵² President Jahjaga met with the President of Bulgaria, Mr. Rosen Plevneliev, ["Presidentja Jahjaga u takua me Presidentin e Bullgarisë, Z. Rosen Plevneliev"], qasur më 14 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,2538>.

³⁵³ U nënshkruan dy marrëveshje bashkëpunimi mes Kosovës dhe Bullgarisë, <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,826&offset=1>.

Karakterit i këtyre takimeve ishte në një masë të madhe i ngjashëm me karakterin e takimeve të zyrtarëve të Kosovës me zyrtarët e Sllovenisë. Kjo është më tepër për shkak të faktit që të dyja vendet janë shtete anëtare të UE-së dhe i kanë të përbashkëta shumë nga politikat e tyre rajonale. Prandaj, takimet dhe vizitat kanë qenë të përqendruara në vizionin e përbashkët që rajoni i Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, duhet të integrohet në UE, e cila është e rëndësishme për stabilitetin rajonal. Njësoj si edhe në rastin e Sllovenisë, zyrtarët e Kosovës u kanë kërkuar zyrtarëve bullgarë për t'i ndihmuar Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave, si dhe në fusha të tjera të procesit të integrimit evropian, duke e patur parasysh përvojën e Bullgarisë në këtë çështje.³⁵⁴ Intensiteti i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Bullgarisë po ashtu pëson paksa për shkak të mungesës së aktivitetit ekonomik, apo, më në veçanti, të shkëmbimit tregtar midis dy shteteve, krahasuar me shkëmbimin tregtar që Kosova e ka me fqinjërit e vet dhe me vendet e tjera të rajonit. Vëllimi mesatar i tregtisë vjetor midis viteve 2008-2012 me Bullgarinë ishte 47.5 milionë €, duke e bërë Bullgarinë partnerin e 9 tregtar në rajon.³⁵⁵ Marrëdhëniet tregtare midis Kosovës dhe Bullgarisë nuk janë të kënaqshme për zyrtarët bullgarë, dhe kur e shikojmë vëllimin tregtar midis Kosovës dhe Maqedonisë, ku tregtia midis këtyre është e kuptueshme, meqë është tradicionale, është e qartë që ka më shumë hapësirë për bashkëpunim tregtar dhe për rritjen e intensitetit tregtar midis dy shteteve.³⁵⁶ Megjithatë, që të dyja vendet janë të përkushtuara në përpjekjet e tyre për ta rritur bashkëpunimin e tyre në të ardhmen.³⁵⁷

³⁵⁴ "President Jahjaga met with the President of Bulgaria, Mr. Rosen Plevneliev" [Presidentja Jahjaga takohet me Presidentin e Bullgarisë, Z. Rosen Plevneliev], qasur më 24 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,2538>.

³⁵⁵ "Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations" ["Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare"], KIPRED, 29-32.

³⁵⁶ Bobi Bobev (Ambasador, Ambasada e Bullgarisë në Kosovë), intervistë në Prishtinë, 3 tetor, 2013.

³⁵⁷ Ibid.

5 KOSOVA DHE TURQIA

5.1 Politika e jashtme dhe rajonale

Rajoni i Ballkanit Perëndimor luan një rol të rëndësishëm në politikën rajonale të Turqisë. Turqia e mban këtë rajon si një prioritet, jo vetëm për shkak të perspektivave dhe interesave të saj politike, ekonomike dhe gjeografike, por, po ashtu, për shkak të lidhjeve historike të rajonit me Turqinë.³⁵⁸ E tërë Evropa Juglindore e luan, po ashtu, një rol të rëndësishëm për Turqinë, për shkak se kjo e sheh atë si një lidhje gjeografike me pjesën tjetër të Evropës, dhe, për shkak të kësaj, Turqia ia jep një rëndësi të madhe forcimit të marrëdhënieve bilaterale dhe ruajtjes së tyre me të gjitha shtetet e rajonit, dhe me atë të Ballkanit Perëndimor në veçanti.³⁵⁹ Një arsye tjetër pse Turqia e konsideron Ballkanin si të rëndësishëm është meqë këtu ka shumë pakica dhe komunitete turke që janë pjesë e pothuaj çdo shteti në Ballkan, dhe ka shumë qytetarë me origjinë ballkanike që jetojnë në Turqi.³⁶⁰ Duke e patur parasysh atë që arritja e stabilitetit dhe e sigurisë rajonale janë të rëndësishme për Turqinë, kjo praninë ndërkombëtare në Kosovë dhe në BH e konsideron si të domosdoshme për ta mbajtur këtë stabilitet, dhe kjo është palë në nisma të ndryshme rajonale në të cilat e luan një rol kyç.³⁶¹

Qëllimet e politikës së jashtme të Turqisë janë, në përgjithësi, të ngjashme me ato të shteteve të Ballkanit Perëndimor, ndër të cilat, ai më i rëndësishmi është për t'u bërë anëtar i plotë i Unionit Evropian.³⁶² Duke e patur parasysh që Turqia tashmë është një shtet anëtar i NATO-s, politika e saj e jashtme lidhur me këtë çështje është që t'i kontribuojë rritjes së mëtejme të NATO-s përmes të cilës kjo mund ta arrijë sigurinë rajonale dhe paqen globale. Ngjashëm me shtetet e tjera në rajon, Turqia synon t'i forcojë më tutje marrëdhëniet e veta bilaterale me SHBA-të dhe me shtetet individuale anëtare të UE-së. Nga aspekti i rajoneve, Turqia dëshiron t'i forcojë marrëdhëniet e veta me Ballkanin Perëndimor, me Lindjen e Mesme, Afrikën Veriore, Kaukazin Jugor, Azinë Jugore dhe Azinë Qendrore.³⁶³

5.2 Cilësia e marrëdhënieve me Turqinë

Marrëdhëniet bilaterale midis Kosovës dhe Turqisë janë të shkëlqyera. Në fakt, Ambasadorja e tashme e Turqisë në Kosovë, Songül Ozan, pos që marrëdhëniet bilaterale midis dy shteteve i përcakton si të shkëlqyera, beson që këto marrëdhënie janë “speciale”, dhe që, për Turqinë, Kosova “është një çelës magjik që njeriu mund ta shfrytëzojë për të hapur shumë dyer”.³⁶⁴ Nga aspekti i cilësisë së marrëdhënieve, Kosova ka marrëdhënie paksa më të mira me Turqinë se me Shqipërinë, ku pothuaj të dyja këto shtete arrijnë rezultate të njëjta në pothuaj të gjitha aspektet fundamentale në marrëdhëniet e tyre bilaterale, pos në atë që Turqia ka rezultate më të larta nga aspekti i investimeve në Kosovë; kjo atë e shndërron në shtetin në rajon me të cilin Kosova i ka marrëdhëniet më të mira. Së pari, si edhe në rastin e Shqipërisë, Turqia është njëri nga vendet e para në rajon që e ka njohur

³⁵⁸ “Foreign Policy – Balkans” [“Politika e Jashtme – Ballkani”], Ministria e Punëve të Jashtme e Turqisë, qasur më 15 dhjetor, 2013, <http://www.mfa.gov.tr/sub.en.mfa?91541430-f1dd-41d0-b6eb-e1a6cc3e556b>.

³⁵⁹ Ibid.

³⁶⁰ Ibid.

³⁶¹ Ibid.

³⁶² “Synopsis of the Turkish Foreign Policy” [“Përmbledhje e Politikës së Jashtme të Turqisë”], MPJ, Turqi.

³⁶³ Ibid.

³⁶⁴ Zyrtar i lartë politik turk, intervistë në Prishtinë, 7 tetor, 2013.

Kosovën; kjo e ka depozituar njohjen e saj më 18 shkurt 2008, pra, menjëherë, vetëm një ditë pasi që Kosova e kishte shpallur pavarësinë.³⁶⁵ Marrëdhëniet diplomatike dhe marrëdhëniet në nivel ambasadorësh midis dy shteteve janë vendosur në po të njëjtën ditë të njohjes, njësoj si edhe në rastin e Shqipërisë.³⁶⁶ Turqia e ka caktuar Ambasadorin e saj të parë në Prishtinë (Metin Hüsrev Ünler) më 21 prill 2009, më tepër se një vit pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, dhe që nga atëherë, Turqia në pjesën më të madhe të kohës përfaqësimin diplomatik në nivel ambasadorësh e ka mbajtur të pashkëputur. Pasi që shërbimi i Z. Ünler përfundoi në dhjetor 2011, Turqia menjëherë e caktoi Ambasadorin e vet të ardhshëm në Kosovë (Songül Ozan), në janar 2011, që vazhdon të shërbejë ende. Madje edhe para themelimit të Ambasadës së vet, Turqia ka qenë duke vepruar në Kosovë përmes Zyrës Ndërlidhëse në Prishtinë që nga viti 1999,³⁶⁷ dhe në këtë Z. Mustafa Sarniç shërbeu si Udhëheqës i Zyres nga viti 2007 deri më 31 tetor 2008.³⁶⁸ Nga ana tjetër, njësoj si edhe me çdo vend tjetër në rajon, Kosova e caktoi Ambasadorin e vet të parë në Ankara, pasi që Turqia e caktoi Ambasadorin e saj në Prishtinë. Ambasadori i parë i Kosovës në Turqi (Bekim Sejdiu) u emërua më 9 shtator 2009, rreth 5 muaj pasi që Turqia e kishte bërë këtë, dhe një vit e gjysmë pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve.³⁶⁹

Së dyti, Turqia po ashtu renditet e para në rajon me numrin e marrëveshjeve bilaterale që të dyja shtetet i kanë nënshkruar, dhe këto në total janë 21.³⁷⁰ Shumica e marrëveshjeve kanë të bëjnë me bashkëpunimin ekonomik, edhe pse janë nënshkruar po ashtu edhe marrëveshje të natyrave të tjera. Marrëveshja e fundit që është nënshkruar midis dy shteteve është Marrëveshja e Tregtisë së Lirë (27 shtator 2013), negociatat për të cilën kishin filluar në shtator 2012. Në pajtim me këtë Marrëveshje, Turqia do t'i eliminojë obligimet në dogana për të gjitha të mirat industriale dhe në 850 linja tarifore që kanë të bëjnë me të mirat bujqësore me origjinë nga Kosova menjëherë pas hyrjes në fuqi të saj. Kosova, nga ana tjetër, do t'i eliminojë obligimet doganore në të gjitha të mirat industriale dhe në 846 linja tarifore që kanë të bëjnë me të mirat bujqësore me origjinë turke, hap pas hapi në 9 vite përderisa të gjitha tarifatat të mos hiqen në tërësi.³⁷¹ Pos kësaj, Turqia i takon grupit të shteteve në rajon që nuk zbatojnë pengesa në hyrje për qytetarët e Kosovës. Pak para Shpalljes së Pavarësisë dhe një kohë të shkurtër pas saj, qytetarëve të Kosovës u nevojitej qoftë viza e cila duhej të vulosej në Zyren Ndërlidhëse Turke në Prishtinë (Pasaportat e UNMIK-ut), apo e cila ka mundur të mirrej në kufi (për Pasaportat e Serbisë). Megjithatë, Turqia vendosi t'i hiqte të gjitha pengesat në hyrje për

Cilësia e marrëdhënieve të Kosovës me Turqinë

Shteti	Pikë	Cilësia
1 Turqia	4.00	E shkëlqyer
Shqipëria	3.88	E shkëlqyer
Slovenia	3.25	Shumë e Mirë
Maqedonia	3.13	Shumë e Mirë
Kroacia	2.63	E Mirë
Bullgaria	2.75	E Mirë
Mali i Zi	1.88	Jo e Keqe
Serbia	0.75	E dobët
Greqia	0.25	E dobët
Rumania	0.13	E dobët
BH	0.00	E dobët

³⁶⁵ Për informata të mëtejme shih linkun në vijim, qasur më 15 dhjetor 2013, <http://www.kosovothankyou.com/>.

³⁶⁶ Dokument i brendshëm i MPJ.

³⁶⁷ "Relations between Turkey and Kosovo" ["Marrëdhëniet midis Turqisë dhe Kosovës"], Ministria e Punëve të Jashtme e Turqisë, qasur më 15 dhjetor, 2013, http://www.mfa.gov.tr/relations-between-turkey-and-kosovo_en.mfa.

³⁶⁸ Shih në, <http://arama.hurriyet.com.tr/arsivnews.aspx?id=-633279>.

³⁶⁹ "Embassy History and Previous Ambassadors" ["Histori e Ambasadës dhe e Ambasadorëve të mëparshëm"], Ambasada e Turqisë në Kosovë, qasur më 16 dhjetor, 2013, <http://pristine.be.mfa.gov.tr/MissionChiefHistory.aspx>.

³⁷⁰ Marrëveshjet Ndërkombëtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

³⁷¹ "Turkey-Kosovo Free Trade Agreement" ["Marrëveshja e Tregtisë së Lirë Kosovë-Turqi"], Ministria e Ekonomisë e Turqisë, qasur më 19 janar, 2014, <http://www.economy.gov.tr/index.cfm?sayfa=5202262F-CC62-D405-56667423C11AA54B>.

Pasaportat e reja të Republikës së Kosovës, dhe që nga viti 2009, qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë lirshëm në Turqi. E njëjta vlen edhe për qytetarët turq që e vizitojnë Kosovën – nuk zbatohen kurfarë pengesash në hyrje.

Së fundi, Turqia është në maje të listës së investitorëve në Kosovë, dhe kjo renditet e dyta në të tërë rajonin, pas Sllovenisë. Investimet mesatare vjetore të Turqisë në Kosovë midis viteve 2008-2012 i kanë tejkaluar 28.6 milionë €. ³⁷² Po ashtu, pos pranisë diplomatike dhe të biznesit në Kosovë, Turqia është një nga vendet e rajonit që i mban trupat dhe personelin në KFOR dhe në EULEX. Turqia e mban një total prej 394 trupash në KFOR, ³⁷³ që është numri më i madh krahasuar me të gjitha shtetet në rajon, dhe personelin prej 28 vetash në EULEX.

5.3 Turqia në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës

Marrëdhëniet e shkëlqyera midis Kosovës dhe Turqisë janë pasuruar më tutje nga fakti që Turqia e përkrah fuqishëm subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës dhe është e përfshirë aktivisht në forcimin e tij. Turqia, ngjashëm si shumë vende të rajonit, për shembull, ka abstenuar rreth Rezolutës së APKB të 8 tetorit 2008 të Serbisë, që thërriste GJND-në për të ofruar një opinion lidhur me ligjshmërinë e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. ³⁷⁴ Në një mënyrë të habitshme, qasja e Turqisë rreth Rezolutës së 9 tetorit 2009 të APKB-së, dhe ajo që Turqia nuk dorëzoi, as deklaratë të shkruar deri më 17 prill 2009, dhe as deklaratë shtesë më 24 korrik 2009, krahasohet, dhe, në fakt, është identike me qasjen e BH-ës në të gjitha këto situata. Po ashtu, njësoj si edhe BH, Turqia nuk e dha ndonjë deklaratë gojore gjatë dëgjimit publik para GJND-së, të mbajtur në dhjetor 2009. Sidoqoftë, kjo e përkrahu Kosovën duke votuar për anëtarësimin e saj në FMN, më 3 maj 2009, si dhe për anëtarësimin e saj në Bankën Botërore, më 3 qershor 2009.

Turqia ka qenë, krahas Shqipërisë, njëri nga lobistët më të rëndësishëm për njohjen e pavarësisë së Kosovës, dhe të legjitimitetit ndërkombëtar të saj. Kjo i shton edhe më tepër cilësisë së shkëlqyer të marrëdhënieve bilaterale që i kanë këto dy shtete. Në pothuaj çdo vizitë të veçantë që Turqia e bën jashtë, zyrtarët e saj i mbajnë njohjet e Kosovës në rendin e ditës. ³⁷⁵ Shembulli i fundit i përfshirjes së drejtpërdrejtë të Turqisë në lobimin për njohjet e Kosovës është roli shumë i rëndësishëm që Kryeministri i Turqisë e ka luajtur në arritjen e njohjeve nga Pakistani dhe Egjipti. ³⁷⁶ Kështu, për shembull, kur Pakistani vendosi ta njihje Kosovën, ky zyrtarët e Kosovës i informoi përmes Ankarasë për këtë vendim të vetin, meqë ata nuk kishin kurfarë kontaktesh në Kosovë. ³⁷⁷ Po ashtu, Brunei e dorëzoi vendimin e tyre për njohjen e Kosovës më 25 prill 2012 – menjëherë pasi që Mbreti i këtij vendi u kthye në shtëpi pas vizitës që ia bëri Ankarasë. ³⁷⁸

Turqia është një nga disa vendet në rajon, dhe madje edhe më gjerë, që e ka një lloj koordinimi institucional kur fjala vjen për lobimin për njohjet e legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës. ³⁷⁹ Pos

³⁷² “Kosovo in Regional Context: Economic and Trade Relations” [“Kosova në kontekstin rajonal: Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare”], KIPRED, 20-24.

³⁷³ “Troop Numbers & Contribution Nations” [“Numri i trupave dhe kombet kontributore”], NATO, qasur më 22 dhjetor, 2013, <http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/troop-numbers-contributions.aspx>.

³⁷⁴ Dokument i brendshëm i MPJ-së.

³⁷⁵ Erdogani e përmend Kosovën në fjalimin e 66 të Asamblesë së KB-ve, <http://www.voltairenet.org/article171548.html>.

³⁷⁶ Avni Spahiu (Ambassador, Ambasada e Kosovës në Turqi), komunikim me E-mail, 3 tetor, 2013.

³⁷⁷ Zyrtar i lartë politik turk, intervistë në Prishtinë, 7 tetor, 2013.

³⁷⁸ Ibid.

³⁷⁹ Ibid.

kësaj, Turqia e ka vënë shërbimin e vet diplomatik në dispozicion të Kosovës; dhe kjo don të thotë që të gjitha ambasadat që i ka Turqia janë në dispozicion të Kosovës pa kurrfarë kushtëzimi, thuaja sikur ato të ishin objekte dhe shërbime të vetë Kosovës, të cilat mund të shfrytëzohen, jo vetëm për zyrtarët e Kosovës por edhe për qytetarët e saj.³⁸⁰ Në pajtim me këtë, Ministria e Jashtme e Turqisë, për shembull, në koordinim me autoritetet e Kosovës, ka ofruar t'u ndihmojë qytetarëve të Kosovës të ngujuar në vendet e Lindjes së Mesme dhe të atyre në Afrikën Veriore gjatë Pranverës Arabe.³⁸¹ Së fundi, Turqia vazhdon t'i përkrahë përpjekjet e Kosovës për ta forcuar legjitimitetin e vet ndërkombëtar përmes rritjes së numrit të njohjeve dhe fitimit të anëtarësisë në organizatat ndërkombëtare, dhe atë posaçërisht në shtetet islamike si dhe në organizatat e tjera multilaterale të tilla si Zhvillimi dhe Iniciative Kooperuese e Evropës Juglindore.³⁸²

Së fundi, njësoj si dhe shumica e vendeve të rajonit, Turqia e përkrah dialogun me Serbinë, ku të dyja palët në dialog e kanë të njëjtin synim për integrimin evropian, por kanë hyrë në dialog për të arritur përfundime të kundërta lidhur me atë se si Kosova duhet të shikohet në të ardhmen. Njësoj si edhe Shqipëria, Turqia ka ofruar kryesisht përkrahje retorike në pajtim me shtetet e tjera anëtare të UE-së. Në takimet e ndryshme me zyrtarët turq para fillimit të dialogut, ish Kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu, i ka siguruar zyrtarët turq që Kosova nuk do t'i diskutojë asnjë herë çështjet e brendshme dhe që integriteti i saj territorial do të mbetet i paprekur.³⁸³ Madje edhe ish Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të Kosovës, Jakup Krasniqi, në një takim miqësor me Kryeministrin turk, Recep Tayyip Erdogan, ka pohuar, disa muaj para se dialogu të fillonte, që Turqia mund ta ofrojë një përkrahje të madhe dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, dhe që kësajsoj ta sigurojë paqen dhe stabilitetin rajonal në saje të potencialit të saj vigan politik dhe ekonomik.³⁸⁴ Kur dialogu filloi, Turqia ofroi përkrahje retorike për Kosovën, dhe e lavdëronte Marrëveshjen e Parë për Parimet e Normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, edhe përkundrejt asaj që kjo doli të ishte lidhur me çështjet e brendshme të Kosovës dhe me riorganizimin e saj.^{385dhe386}

5.4 Intensiteti i marrëdhënieve me Turqinë

Kosova dhe Turqia kanë marrëdhënie *intensive*, që renditen vetëm pas atyre me Shqipërinë. Këto marrëdhënie intensive përftohen nga aktiviteti i tërësishëm bilateral midis Kosovës dhe Turqisë nga aspekti i takimeve dhe vizitave në nivelet presidenciale, kryeministrorë dhe të ministrave të jashtëm, si dhe të aktivitetit ekonomik dhe tregtar midis dy shteteve. Që nga Shpallja e Pavarësisë në shkurt 2008, janë bërë rreth 14 vizita të ndërsjella në të dyja anët e kufirit, që është tre herë më pak se shpeshësia e takimeve dhe vizitave që Kosova i ka patur me Shqipërinë. Nga të gjitha vizitat midis Kosovës dhe Turqisë, 9 janë bërë në Turqi, dhe 5 të tjera në Kosovë, duke e bërë Kosovën dukshëm më aktive në vizitat e bëra në Turqi se e anasjellta. Për shembull, kur fjala vjen te vizitat në nivelin presidencial, u bënë gjithsej 4 takime, dhe që të katërtat u bënë në Turqi, duke e bërë këtë si njërin

³⁸⁰ Ibid.

³⁸¹ Ibid.

³⁸² Avni Spahiu (Ambassador, Ambasada e Kosovës në Turqi), komunikim me E-mail, 3 tetor, 2013.

³⁸³ Deklarim i Sejdiut në takimet me disa zyrtarë turq, qasur më 20 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,1103>.

³⁸⁴ The acting President of of the Republic of Kosovo Dr. Jakup Krasniqi receives the Prime Minister of Turkey Recep Tayyip Erdogan” [“Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi, e pranon Kryeministrin e Turqisë Recep Tayyip Erdogan”], qasur më 20 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,1429>.

³⁸⁵ “President Atifete Jahjaga met with the Turkish Foreign Minister, Mr. Ahmet Davutoglu” [“Presidentja Atifete Jahjaga u takua me Ministrin e Jashtëm Turk, Z. Ahmet Davutoglu”], qasur më 20 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,2744>.

³⁸⁶ “Prime Minister Thaci received by Prime Minister of Turkey, Recep Tayyip Erdogan” [“Kryeministri Thaçi u pranua nga Kryeministri i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan”], qasur më 20 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,3527>.

nga disa vendet e rajonit me të cilin Kosova ka marrëdhënie më intensive, dhe Presidenti i të cilit nuk e ka vizituar Kosovën. Ish Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, e ka vizituar Turqinë dy herë, një herë më 6 maj 2009,³⁸⁷ dhe herën tjetër më 2 shkurt 2010;³⁸⁸ ngjashëm, Presidentja e tashme e Kosovës, Atifete Jahjaga, po ashtu e ka vizituar Turqinë dy herë, një herë më 12 mars 2012,³⁸⁹ dhe herën tjetër më 11 prill 2013,³⁹⁰ duke e krijuar kështu një trend të një vizite presidenciale në pothuaj çdo vit. Takimet në nivelin presidencial midis dy shteteve janë bërë po ashtu edhe në mjediset multilaterale, posaçërisht në New York, në takimet e KB, dhe në konferencat e tjera jashtë. Abdullah Gül, Presidenti i vetëm që e ka patur këtë post që nga Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, këtë nuk e ka vizituar asnjë herë.

Intensiteti i marrëdhënieve të Kosovës me Turqinë

Shteti	Pikë	Intensiteti
Shqipëria	3.75	Shumë Intensive
2 Turqia	2.25	Intensive
Maqedonia	2.00	Pak Intensive
Kroacia	2.00	Pak Intensive
Slovenia	2.00	Pak Intensive
Bullgaria	1.00	Pak Intensive
Greqia	1.00	Pak Intensive
Serbia	1.00	Pak Intensive
Mali i Zi	0.75	Joaktive
BH	0.50	Joaktive
Rumania	0.00	Joaktive

Takimet dhe vizitat në nivelin qeveritar kanë qenë më të shpeshta, dhe numri i tyre ishte 10 në total, nga të cilat 5 ishin në nivelin kryeministral dhe 5 të tjera në nivel të ministrave të jashtëm. Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, që është i vetmi që e ka patur postin që nga pavarësia e Kosovës, e ka vizituar Turqinë tre herë, ndërkohë që homologu i tij, Recep Tayyip Erdogan e ka vizituar Kosovën zyrtarisht vetëm një herë. Z. Thaçi e ka vizituar Turqinë për herë të parë më 20 maj 2010,³⁹¹ më tepër se dy vjet pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve.

Vizita e tij e dytë u bë më 14 mars 2011,³⁹² dhe herën e tretë dhe të fundit më 10 maj 2013.³⁹³ Nga ana tjetër, Kryeministri turk, Recep Tayyip Erdogan e ka vizituar Kosovën dy herë, një herë më 3 nëntor 2010 në Prishtinë dhe në Prizren,³⁹⁴ dhe hera e dytë ka qenë më 23 tetor 2013.³⁹⁵ Z. Erdogan e gëzon një reputacion shumë të mirë në Kosovë, dhe në veçanti në mesin e komunitetit turk dhe në pjesën tradicionalisht konservatore të shoqërisë së Kosovës. Është raportuar që Z. Erdogan ta ketë vizituar Kosovën jozyrtarisht më shpesh, dhe që takohet me komunitetin turk dhe me përfaqësuesit e tyre në Prizren.³⁹⁶ Mirëpo, dy vizitat zyrtare të Erdoganit në Prishtinë dhe në Prizren, ku e para ishte në nëntor 2010 dhe e dyta dhe e fundit në tetor 2013, konsiderohen kontraverse për shkak të mesazhit implicit që ai ia doli ta dërgonte përmes këtyre vizitave në përkrahje të strukturës aktuale të

³⁸⁷ "President of Turkey Abdullah Gul reconfirms support for Kosovo" ["Presidenti i Turqisë, Abdullah Gül e konfirmon përkrahjen për Kosovën"], qasur më 20 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,688>.

³⁸⁸ "Republic of Turkey receives President Sejdiu with highest state honors" ["Republika e Turqisë e pranon Presidentin Sejdiu me nderimet më të larta shtetërore"], qasur më 20 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,523>.

³⁸⁹ "President Jahjaga met with the President of Turkey, Abdullah Gul" [Presidentja Jahjaga u takua me Presidentin e Turqisë, Abdullah Gül], qasur më 21 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,2234>.

³⁹⁰ "President Jahjaga meets representatives of Albanian community in Turkey" ["Presidentja Jahjaga takohet me përfaqësuesit e komunitetit shqiptar në Turqi"], qasur më 21 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,2835>.

³⁹¹ "Prime Minister receives full support from Prime Minister Erdogan of Turkey" ["Kryeministri e merr një përkrahje të plotë nga Kryeministri Erdogan i Turqisë:"], qasur më 21 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,1323>.

³⁹² "Prime Minister of Republic of Kosovo Hashim Thaci meets Prime Minister of Republic of Turkey Recep Tayyip Erdogan" ["Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi e takon Kryeministrin e Republikës së Turqisë, Recep Tayyip Erdogan"], qasur më 21 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,1888>.

³⁹³ "Prime Minister Thaci received by Prime Minister of Turkey, Recep Tayyip Erdogan" ["Kryeministri Thaçi pranohet nga Kryeministri i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan"], qasur më 21 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,3527>.

³⁹⁴ "Prime Minister Hashim Thaci: Prime Minister Recep Tayyip Erdogan was amongst the biggest supporters of our country's independence" ["Kryeministri Hashim Thaçi: Kryeministri Recep Tayyip Erdogan ishte ndër përkrahësit më të mëdhenj të pavarësisë së vendit tonë"], qasur më 21 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,1715>.

³⁹⁵ "Erdogan visits Kosovo" ["Erdogani e viziton Kosovën"], qasur më 3 dhjetor, 2013, <http://ilirida.net/lajme/33144-erdogan-vizitoi-kosoven-pershendet-shqiptaret-e-maqedonise.html>.

³⁹⁶ KIPRED takime dhe intervista të ndryshme.

Qeverisë së Kosovës të Kryeministrit Thaçi. Ky ishte rasti meqë që të dyja vizitat u përputhën me fushatën zgjedhore në Kosovë. Duke e patur parasysh popullaritetin e Z. Erdogan në Kosovë, supozohet që ai në një mënyrë implicite është duke i ndihmuar Thaçit për ta fituar përkrahjen në mesin e komunitetit turk në Kosovë.³⁹⁷ Mirëpo, kjo është mohuar nga përfaqësuesit turq në Kosovë si një ko incidencë e thjeshtë.³⁹⁸

Kanë qenë edhe pesë vizita dhe takime të ndërsjella shtesë midis ministrave të jashtëm të të dyja shteteve. Ministrat e Punëve të Jashtme të Kosovës (Skender Hyseni dhe Enver Hoxhaj) e kanë vizituar Turqinë dy herë, herën e parë Ministri Hyseni, më 28 gusht 2009,³⁹⁹ dhe vizita e dytë dhe e fundit ishte ajo e Ministrit Hoxhaj, më 18 dhjetor 2012.⁴⁰⁰ Takimet e tjera nga Ministrat e Jashtëm të Kosovës u bënë në formate multilaterale, në vende të tjera, si dhe në konferencat ndërkombëtare. Nga ana tjetër, ministrat e jashtëm turq e kanë vizituar Kosovën tre herë, ku vizita e parë u bë më 20 dhjetor 2008,⁴⁰¹ vizita e dytë në Kosovë ishte më 13 janar 2010,⁴⁰² dhe vizita e fundit ishte më 26 gusht 2011,⁴⁰³ duke i bërë kështu vizitat në nivelin e ministrave të jashtëm të jenë me një shpeshësi prej pothuaj një herë në vjet.

Temat e zakonshme që diskutohen midis dy palëve në të gjitha nivelet e përmendura më sipër janë të një karakteri ekonomik, politik dhe kulturor. Të dy palët vazhdimisht e theksojnë nevojën për marrëdhënie të fuqishme politike dhe ekonomike dhe për ta thelluar vazhdimisht partneritetin. Në përkrahjen për legjitimitetin ndërkombëtar të Kosovës, lobimi aktivizohet jo vetëm përmes ndjekjes së njohjeve por, po ashtu, edhe përmes përkrahjes me diskutime dhe koordinim që Turqia mund ta ofrojë në fushën e vet të ndikimit në mesin e shteteve islamike.⁴⁰⁴ Kështu, ish Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu kishte kërkuar përkrahjen që mund ta ofronin zyrtarët turq për të ardhmen e Kosovës në Organizatën e Konferencës Islamike dhe në Lidhjen e Shteteve Arabe.⁴⁰⁵ Turqia është njëri nga pak shtetet në rajon që e ofroh hapësirën më të madhe të mundshme për Kosovën, nga aspekti i pjesëmarrjes së vet në forumet dhe në pothuaj të gjitha ngjarjet ndërkombëtare që i organizon në trevën e vet, dhe, kësaj, kjo Kosovës ia ofron një përkrahje të pashembullt.⁴⁰⁶

Shumica e këtyre takimeve të larta zyrtare, përfshirë këtu edhe ato presidenciale dhe kryeministrale është karakterizuar po ashtu me diskutimet për sektorin e edukimit, apo, më në veçanti, me trysinë e pretenduar që zyrtarët e lartë turq e kanë ushtruar në zyrtarët e Kosovës për t'i rishikuar librat e

³⁹⁷ <http://english.sabah.com.tr/national/2013/10/24/pm-erdogan-kosovo-is-turkey>.

³⁹⁸ Zyrtar i lartë politik turk, intervistë në Prishtinë, 7 tetor, 2013.

³⁹⁹ "Minister Hyseni meets President Abdullah Gul" ["Ministri Hyseni e takon Presidentin Abdullah Gul"], qasur më 22 janar, 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=2.4.213&offset=1>.

⁴⁰⁰ "Hoxhaj: Turkey our strategic partner" ["Hoxhaj: Turqia, partner joni strategjik"], qasur më 22 janar, 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=1.4.1546&offset=1>.

⁴⁰¹ Për informata të mëtejme shih linkun në vijim, qasur më 22 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.844>.

⁴⁰² "Minister Hyseni met with Foreign Affairs Minister of Republic of Turkey, Ali Babacan" ["Ministri Hyseni u takua me Ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Ali Babacan"], qasur më 22 janar, 2014, <http://www.mfa-ks.net/?page=2.4.120&offset=2>.

⁴⁰³ "Prime Minister Thaçi: All the countries in the region aspire EU integration – and to achieve that they have to respect territorial integrity of neighboring countries" ["Kryeministri Thaçi: Të gjitha vendet e rajonit aspirojnë integritetin në UE – dhe për ta arritur këtë ata duhet ta respektojnë integritetin territorial të vendeve fqinje"], qasur më 22 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2.9.2290>.

⁴⁰⁴ "Prime Minister Hashim Thaçi: Prime Minister Recep Tayyip Erdogan was amongst the biggest supporters of our country's independence" ["Kryeministri Hashim Thaçi: Kryeministri Recep Tayyip Erdogan ishte në mesin e përkrahësve më të fuqishëm të pavarësisë së vendit tonë"], qasur më 21 janar, 2014, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2.9.1715>.

⁴⁰⁵ "Republic of Turkey reconfirms the support for Kosovo" ["Republika e Turqisë e rikonfirmon përkrahjen për Kosovën"], qasur më 23 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.232>.

⁴⁰⁶ "President of Turkey Abdullah Gul reconfirms support for Kosovo" ["Presidenti i Turqisë, Abdullah Gul e rikonfirmon përkrahjen për Kosovën"], qasur më 20 janar, 2014, <http://www.president-ksgov.net/?page=1.6.688>.

historisë ku osmanët dhe turqit janë paraqitur negativisht.⁴⁰⁷ Kjo e ka nxitur një diskutim të nxehtë në Prishtinë, i cili vazhdon tash disa vjet, posaçërisht në mesin e historianëve dhe të figurave të tjera publike që janë kundër kërkesave të Turqisë për t'i "rehabilituar" osmanët në librat e historisë së Kosovës.⁴⁰⁸ Megjithatë, zyrtarët e lartë turq në Ambasadën e Prishtinës pohojnë që ideja fillestare për të rishikuar dhe modifikuar pjesë të librave të historisë që shfrytëzohen në sistemin arsimor të Kosovës është dhënë nga ish Ministri i Arsimit i Kosovës, dhe Ministri i tashëm i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, dhe që zyrtarët turq vetëm e kanë ndjekur atë.⁴⁰⁹ Është raportuar trysni që është zbatuar në zyrtarët e Kosovës, meqë disa prej tyre kanë pohuar që kjo ka ardhur jo vetëm nga Presidenti i Turqisë, Kryeministri dhe Ministri i Jashtëm, por po ashtu edhe nga vetë Ambasadori i Turqisë në Kosovë.⁴¹⁰ Pos që ka ardhur deri te një debat i nxehtë dhe kontraversë lidhur me këtë çështje, Turqia nuk e ka kushtëzuar Kosovën që ta bëjë këtë, dhe vazhdon ta ndihmojë dhe ta përkrahë Kosovën në përpjekjet e veta për shtetësi.

Së fundi, edhe përkundrejt asaj që zyrtarët e Kosovës kanë qenë më aktiv në takimin e zyrtarëve serbë se të atyre turq, intensiteti i marrëdhënieve midis dy shteteve mbetet i fuqishëm, më së shumti për shkak të shkëmbimit tregtar midis dy shteteve. Vëllimi mesatar vjetor i tregtisë midis viteve 2008-2012 midis Kosovës dhe Turqisë ka qenë rreth 168.6 milionë €, duke e bërë kështu Turqinë partner të tretë në rajon, pas Maqedonisë dhe Serbisë.⁴¹¹

⁴⁰⁷ "Ndryshimi i Historisë zbut Perandorinë Osmane", qasur më 21 janar, 2014, <http://gazetajnk.com/?cid=1,964,4133>.

⁴⁰⁸ Turqia kërkon të "rehabilitojë" osmanët në historinë e Kosovës, qasur më 21 janar, 2014, <http://www.shqiptarja.com/kosova/2727/turqia-kerkon-te-rehabilitoje-osmanet-ne-historine-e-kosoves-149245.html>.

⁴⁰⁹ Zyrtar i lartë politik turk në Prishtinë, 7 tetor, 2013.

⁴¹⁰ Turqia kërkon të "rehabilitojë" osmanët në historinë e Kosovës, qasur më 21 janar, 2014, <http://www.shqiptarja.com/kosova/2727/turqia-kerkon-te-rehabilitoje-osmanet-ne-historine-e-kosoves-149245.html>

⁴¹¹ Publikimet për tregtinë e jashtme, Zyra e Kryeministrit, Agjencioni i Kosovës për Statistika, qasur më 20 janar, 2014, http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/14-tregtia-e-jashtme.

6 PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME

- Turqia renditet e para në mesin e shteteve të rajonit, dhe me të Kosova i ka marrëdhëniet më të mira nga aspekti i cilësisë së marrëdhënieve bilaterale. Shqipëria vjen e dyta, menjëherë pas Turqisë. Duke e patur parasysh madhësinë e saj gjeografike, pozitën dhe ndikimin, Turqia ka qenë shumë më me ndikim në ndihmën Kosovës në lobimin për njohjet e saj si dhe për forcimin e legjitimitetit të saj ndërkombëtar. Krahasuar me Shqipërinë, Turqia ka qenë po ashtu një investitor më i fuqishëm në Kosovë. Nga ana tjetër, Shqipëria është i vetmi vend në rajon me të cilin Kosova ka marrëdhënie shumë intensive, dhe kjo, kësajsoj, renditet e para nga aspekti i intensitetit të marrëdhënieve bilaterale midis dy shteteve.
- Marrëdhëniet/kontaktet me shtetet mosnjohëse të rajonit janë që të gjithat të dobëta. Derisa Greqia dhe Rumania e ruajnë praninë ‘diplomatike’ në Kosovë përmes Zyrave Ndërlidhëse të tyre, Serbia është i vetmi mosnjohës në rajon i cili, jo vetëm që ka përfaqësim ‘diplomatik’ përmes Zyrtarit të vet Ndërlidhës, por e ka lejuar edhe Kosovën për ta patur po të njëjtin përfaqësim në Beograd. Kosova ende nuk ka përfaqësim ‘diplomatik’ përmes Zyreve për Ndërlidhje në mosnjohësit e tjerë, pos asaj që Greqia nuk ia ka mohuar Kosovës të drejtën për ta bërë këtë, për shembull. Ajo që kontribuon po ashtu në atë që Serbia të renditet më lartë se mosnjohësit e tjerë të rajonit nga aspekti i cilësisë së marrëdhënieve/kontakteve, është që investimet që Serbia i ka bërë në Kosovë, edhe pse të ulëta, kur të merret parasysh rajoni, janë megjithatë të larta kur të krahasohen me mosnjohësit e tjerë. Serbia renditet po ashtu e teta në mesin e të gjitha shteteve të rajonit kur fjala është për intensitetin e marrëdhënieve bilaterale. Për dallim nga mosnjohësit e tjerë, me të cilët Kosova nuk ka marrëdhënie aktive, Serbia i ka ruajtur marrëdhëniet/kontaktet aktive politike me Kosovën në nivelin multilateral, mirëpo marrëdhënie të tilla në nivelin bilateral janë inekzistente. Shkëmbimi tregtar është diçka që i kontribuon nivelit të tashëm të intensitetit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Vëllimi tregtar i Kosovës me Serbinë është shumë më i lartë se me çdo shtet tjetër të rajonit pos Maqedonisë.
- Kur fjala vjen te shtetet anëtare të UE-së të rajonit që e kanë njohur Kosovën, Sllovenia renditet e para midis tyre sa i përket cilësisë së marrëdhënieve që i ka me Kosovën. Sllovenia, në fakt, renditet e treta në të tërë rajonin nga aspekti i cilësisë së marrëdhënieve që i ka me Kosovën; ajo është menjëherë pas Turqisë dhe Shqipërisë.
- Ajo që i kontribuon cilësisë më të mirë (dhe, në disa raste, më të mirë se që njeriu fillimisht do ta supozonte) të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Shqipërisë, Turqisë dhe të Serbisë, për shembull, është që këto shtete, së bashku me Malin e Zi dhe Maqedoninë janë të vetmet që nuk zbatojnë pengesa në hyrje (të tilla si vizat) për qytetarët e Kosovës.
- Vendet më përkrahëse në rajon në forcimin e legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës kanë qenë Shqipëria, Turqia dhe Sllovenia. Vende të tjera, si Kroacia dhe Bullgaria kanë qenë po ashtu përkrahëse, por jo deri në masën në të cilën kanë qenë këto trija. Maqedonia dhe Mali i Zi janë të vetmet vende të rajonit që e kanë njohur Kosovën por që kanë mbetur neutrale në qasjen e tyre për ta ndihmuar atë që ta forcojë legjitimitetin e vet ndërkombëtar. Kjo është pjesërisht për shkak të marrëdhënieve të afërta të tyre me Serbinë, dhe këto njohjen e Kosovës e kanë konsideruar si një goditje mjaft të madhe për Serbinë nga ana e tyre.

- Serbia është sfiduesja më e patundur e legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës. Kjo e ndërmerr çdo hap që mundet për ta sfiduar subjektivitetin dhe përfaqësimin ndërkombëtar të Kosovës. Serbia i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet që ka mundur, qoftë ligjore (KB, GJND-ja, etj.), qoftë praktike (lobimi), për ta ndalur Kosovën në fitimin e më shumë njohjeve. Rumania e ka përkrahur Serbinë në pothuaj të gjitha përpjekjet e saj për ta sfiduar legjitimitetin ndërkombëtar të Kosovës. BH ka mbetur më pasive lidhur me këtë çështje, për shkak të përçarjeve të saj të brendshme midis përfaqësuesve të saj boshnjakë dhe kroatë në Presidencë (që e përkrahin pavarësinë e Kosovës), nga njëra anë, dhe përfaqësuesve serbë të Presidencës (që e sfidojnë pavarësinë e Kosovës), nga tjetra. Greqia është i vetmi vend mosnjohës në rajon që e ka përvetësuar një qasje më përfshirëse dhe jo-izolacioniste ndaj Kosovës. Ajo e ka ftuar Kosovën për ta hapur Zyren e vet Ndërlidhëse në Athinë, dhe ka qenë po ashtu e hapur për t'u takuar me zyrtarët e lartë të Kosovës, edhe në Prishtinë, edhe në Athinë, gjë kjo që e dallon nga vendet e tjera mosnjohëse.

7 ANEKSET

Aneksi 1: Kosova në politikën e jashtme të rajonit

Kosova në politikën e jashtme të rajonit	
Shtetet	Qëndrimi i Kosovës
Shqipëria	<ul style="list-style-type: none"> • Kosova dhe Shqipëria nuk kanë çështje të hapura dhe Kosova qëndron në mesin e boshteve kryesore të politikës së jashtme të Shqipërisë. Shqipëria e konsideron bashkëpunimin me Kosovën si strategjik në funksionin e rritjes ekonomike, cilësisë së jetës dhe përshpejtimit të procesit të integrimi euroatlantike, si dhe në ndërtimin e një të ardhme të përbashkët euroatlantike. • Shqipëria e përkrah fuqishëm pavarësinë e Kosovës dhe është e përkushtuar për ndërmarrjen e hapave për të ndihmuar procesin e njohjeve të mëtejshme të Kosovës në skenën ndërkombëtare. Për më tepër, Shqipëria i mirëpret hapat e Kosovës drejt proceseve drejt Unionit Evropian. • Shqipëria e ka mirëpritur dhe e ka përkrahur dialogun midis Kosovës dhe Serbisë dhe të gjitha marrëveshjet/konkluzionet e arritura, përfshirë edhe Marrëveshjen e 19 prillit për të cilin Shqipëria pret që do ta japë një shtytje të re për njohjet e reja të Kosovës dhe për anëtarësimet e saj në forumet rajonale, në UE dhe në KB.
Turqia	<ul style="list-style-type: none"> • Në kornizën e politikës së jashtme të Turqisë është e pohuar që Turqia dhe Kosova kanë marrëdhënie të shkëlqyera bilaterale që burojnë nga historia e përbashkët dhe lidhjet vëllazërore. Për më tepër, është e shënuar edhe që Turqia ia bashkangjet rëndësinë më të lartë ruajtjes së stabilitetit dhe të integritetit territorial të Kosovës dhe vendosjes së marrëdhënieve konstruktive me fqinjët e saj bazuar në parimet e miqësisë. Turqia e përkrah zhvillimin e Kosovës dhe po ashtu edhe integrimin e saj në strukturat euroatlantike. Lidhur me këtë, Turqia vazhdon t'i ofrojë përkrahje Kosovës në fushat politike, ushtarake, humanitare dhe ekonomike. • Turqia i përkushtohet vazhdimisht përkrahjes së kërkesës së Kosovës për njohje të mëtejme ndërkombëtare si dhe për anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Turqia e përkrah procesin e dialogut midis Prishtinës dhe Beogradit, dhe këtë e sheh si një faktor të rëndësishëm për përpunimin e Serbisë dhe të Kosovës drejt qëllimit të tyre të integritetit në UE, dhe si një instrument të rëndësishëm në normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve fqinje. • Turqia qytetarët e Kosovës me origjinë turke, numri i të cilëve është rreth 19 mijë, i sheh si një urë të rëndësishme midis dy vendeve, të cilët kontribuojnë në mënyrë aktive në fushat politike, ekonomike, kulturore dhe shoqërore në Kosovë. • Turqia është duke kontribuar në mbrojtjen e trashëgimisë së përbashkët kulturore në Kosovë përmes Agjencionit Turk për Bashkëpunim dhe Koordinim, i cili e ka përfunduar restaurimin e monumenteve të shumta të tilla si Tyrbja e Sulltan Muratit, Xhamia e Fatihut dhe Xhamia e Sinan Pashës.
Maqedonia	<ul style="list-style-type: none"> • Pas përfundimit të demarkacionit të kufirit në vitin 2009, Kosova dhe Maqedonia nuk kanë më çështje të hapura. Marrëdhëniet me Kosovën nuk janë të theksuara në Qëllimet dhe Prioritetet e Politikës së Maqedonisë, dhe këto marrëdhënie janë në kuadrin e marrëdhënieve me vendet të cilave Maqedonia i thërrret si "fqinjëria e drejtpërdrejtë". Lidhur me këtë, promovohet fqinjësia dhe miqësia e mirë, dhe, kështu, edhe gatishmëria për bashkëpunim të përgjithshëm në disa fusha të interesit të përbashkët. Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë një nga prioritetet e politikës së jashtme të Maqedonisë. • Maqedonia synon të ndërtojë lidhje të bashkëpunimit gjithëpërfshirës me të gjitha vendet në fqinjësi të drejtpërdrejtë dhe më të gjerë – edhe në nivelin bilateral, edhe në kuadrin e nismave dhe projekteve rajonale, duke marrë pjesë në nismat e bashkëpunimit rajonal në të tërë rajonin e Evropës Juglindore – si një kontribut aktiv nga ana e Republikës së Maqedonisë në ndërtimin e marrëdhënieve të sigurisë, stabilitetit dhe të bashkëpunimit në Evropën Juglindore. • Pas pjesëmarrjes së Republikës së Maqedonisë në misionet paqeruajtëse (KB, NATO, UE), kjo përmendet në mesin e vendeve të tjera edhe si përkrahje logjistike për KFOR-in në Kosovë.
Serbia	<ul style="list-style-type: none"> • Serbia nuk e njeh Kosovën si një vend të pavarur, dhe Kosova është e rrënjësuar në Kushtetutën e Serbisë. • Për më tepër, në qëllimet kryesore të politikës së vet të jashtme në fushën e aktiviteteve multilaterale është e përfshirë edhe mbrojtja e sovranitetit dhe e integritetit territorial të Republikës së Serbisë, dhe gjetja e zgjidhjes kompromise lidhur me Kosovën dhe Metohinë duke e fituar përkrahjen më të gjerë të mundshme për qëndrimet e Republikës së Serbisë në mbledhjet multilaterale.
BH	<ul style="list-style-type: none"> • BH nuk e njeh Kosovën si një vend të pavarur. Prandaj, në udhëzimet dhe në aktivitetet bazike të politikës së jashtme të BH-ës që kanë të bëjnë me karakterin bilateral, Kosova nuk është e paraqitur në mesin e vendeve fqinje me të cilat BH synon të promovojë bashkëpunim.

Mali i Zi	<ul style="list-style-type: none"> • Mali i Zi është një nga vendet e rajonit me të cilin Kosova i ka disa çështje të hapura. Këto përfshijnë demarkacionin e kufirit, si dhe njohjen e malazezëve si një komunitet me të gjitha të drejtat kushtetutare dhe të barabarta me komunitetet e tjera të Kosovës. • Në prioritetet e politikës së jashtme të Malit të Zi Kosova është në kategorinë e emërtuar “Përmirësimi dhe mbajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe të bashkëpunimit rajonal”. Megjithatë, për shkak të mungesës së demarkacionit të kufirit, Kosova nuk përmendet në mesin e vendeve fqinje me të cilat Mali i Zi pohon që ta ketë të përbashkët të njëjtën hapësirë gjeografike dhe, po ashtu, të njëjtat qëllime të politikës së jashtme. • Qëllimi i politikës së jashtme të Malit të Zi është të zhvillojë marrëdhënie dhe komunikime të mira me respektim të ndërsjellë, dhe zhvillim të vazhdueshëm të kontakteve dhe të bashkëpunimit politik, ekonomik, të sigurisë, kulturor e shkencor, si dhe të sigurojë lidhje të mira infrastrukturore. Në këtë kontekst, rëndësi e veçantë i jipet marrëdhënieve me Serbinë, që detyron marrëdhënie të partneritetit të barabartë dhe të respektimit të ndërsjellë. • Mali i Zi i sheh marrëdhëniet e mira me fqinjët, si dhe bashkëpunimin rajonal, si një mjet për t’i arritur qëllimet e veta strategjike të integrimi, të tilla si anëtarësimi në UE dhe në NATO. Mali i Zi e përkrah zhvillimin e bashkëpunimit rajonal dhe përparimin e mëtejshëm të mekanizmave të bashkëpunimit në mesin e vendeve të Evropës Juglindore.
Kroacia	<ul style="list-style-type: none"> • Kosova nuk ka çështje të hapura me Kroacinë. Kosova nuk është e paraqitur në veçanti, por është në shtyllën e tretë të synimeve themelore të Kroacisë, në atë të quajtur “Rritja e marrëdhënieve me vendet fqinje.” Kroacia e ka një interes të veçantë në stabilizimin dhe demokratizimin e përhershëm të Juglindjes së Evropës, në sigurimin e paqes dhe të zhvillimit të përhershëm të kësaj pjese të Evropës, në vendosjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore të bazuara në barazi dhe në reciprocitet, dhe në gjetjen e mënyrës politike të bazuar në të drejtën ndërkombëtare për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura që kanë mbetur pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. • Për më tepër, qeveria kroate do t’i zhvillojë marrëdhëniet e veta me vendet fqinje duke u bazuar në parimet e fqinjësisë së mirë, të respektimit të ndërsjellë të sovranitetit, të pavarësisë dhe të integritetit territorial, të barazisë dhe të zgjidhjes së çështjeve të hapura përmes dialogut politik, bazuar në parimet e të drejtës ndërkombëtare, apo përmes ndihës ndërkombëtare ligjore.
Slovenia	<ul style="list-style-type: none"> • Kosova dhe Sllovenia nuk kanë çështje të hapura ndërmjet tyre. Në politikën e vet të jashtme, në kuadrin e shtyllës së Ballkanit Perëndimor, Sllovenia e konsideron këtë zonë si një interes dhe veprimtari slovene prioritar. • Për shkak të bashkë-varësisë së sigurisë dhe prosperitetit të Sllovenisë me situatën në rajon, marrëdhëniet me vendet e Ballkanit Perëndimor karakterizohen me miqësi, gatishmëri për të ofruar asistencë, dhe dëshira të sinqerta për të kontribuar për stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendeve në fqinjërinë e drejtpërdrejtë me të cilat e ndan historinë dhe rrënjët kulturore dhe linguistike. Pos kësaj përmenden, ndër të tjera, edhe 329 trupat sllovene të stacionuara në Kosovë si anëtarë të njësisë të KFOR-it që e ofrojnë sigurinë. • Marrëdhëniet pozitive të Sllovenisë me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë të bazuara në besim dhe në partneritetin me vetëbesim të anëtarëve të barabartë. Marrëdhëniet e Sllovenisë me vendet e jashtme janë të themeluara në qëndrime që politikisht janë të paanshme. Kjo vlen po ashtu edhe për vendet që janë në konflikt, të tilla si Serbia dhe Kosova. • Sllovenia vazhdon të jetë një përkrahës i fuqishëm i rritjes së Unionit Evropian që do t’i inkorporojë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor.
Bullgaria	<ul style="list-style-type: none"> • Kosova dhe Bullgaria nuk kanë çështje të hapura. Kosova nuk përmendet në veçanti në prioritetet e politikës së jashtme të Bullgarisë. Mirëpo, stabiliteti i rajoneve të Evropës Juglindore dhe të Detit të Zi është i një interesi të veçantë për Bullgarinë. Ajo që nevojitet është një mjedis i besueshëm dhe i parashikueshëm i sigurisë, i favorshëm për një zhvillim të qëndrueshëm të vendeve të rajonit, dhe promovimi i sigurisë dhe i zhvillimit të bashkëpunimit në një kontekst euroatlantik dhe evropian.
Rumania	<ul style="list-style-type: none"> • Rumania nuk e njeh Kosovën si një vend të pavarur. Rrjedhimisht, në politikën kyçe të Rumanisë për Ballkanin Perëndimor Kosova nuk përmendet në mesin e vendeve të tjera të kësaj zone.
Greqia	<ul style="list-style-type: none"> • Greqia nuk e njeh Kosovën si një vend të pavarur. Në politikën e saj rajonale thuhet që Greqia është duke zhvilluar dhe zbatuar një politikë kohezive rajonale, qëllim përfundimtar i të cilës është ta konsolidojë paqen dhe sigurinë, dhe ta përhapë prosperitetin anëmbanë fqinjësisë së drejtpërdrejtë. • Historia e Greqisë është e ndërthurur me historinë e Ballkanit, një zonë kjo në të cilën Greqia e ka luajtur një rol kryesor përgjatë shekujve. Historikisht, Ballkani ka qenë një rajon i paqëndrueshëm, dhe konfliktet e fundit – me shpresë edhe të fundit – në rajon kanë ndodhur gjatë hyrjes në shekullin 21 dhe në rrjedhën e shpërbërjes së Jugosllavisë. Kosova përmendet si një çështje që është përfutur nga shpërbërja e Jugosllavisë. • Vendi pohon që është duke e ndjekur konsolidimin e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në rajon, përmes vendosjes së marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe të respektimit të parimeve themelore të të drejtës dhe rendit ndërkombëtar – ashtu siç këto janë të parashtruara në Kartën e KB-ve – si dhe përmes përfshirjes së plotë të vendeve ballkanike në institucionet evropiane dhe euroatlantike.

Burimi: Dokumentet zyrtare të shteteve të rajonit

Aneksi 2: Arritja e rezultateve për cilësinë e marrëdhënieve

Rezultatet/pikët nga Matrica e Vlerësimit për cilësinë e marrëdhënieve midis Kosovës dhe vendeve të tjera në rajon											
Shtetet	Vendosja e marrëdhënieve diplomatike	Vendosja e marrëdhënieve në nivel ambasadorësh	Përfaqësimi në Kosovë	Përfaqësimi në vendin x	Njohja	Nr. i marrëveshjeve	Lejimi i lirisë së lëvizjes për qytetarët e R.K.	Investimet (në miliona €)	Totali	Rezultati përfundimtar	Cilësia
Turqia	4	4	4	4	4	4	4	4	32	4.00	E shkëlqyer
Shqipëria	4	4	4	4	4	4	4	3	31	3.88	E shkëlqyer
Sllovenia	4	4	4	4	4	2	0	4	26	3.25	Shumë e Mirë
Maqedonia	3	3	4	4	2	4	4	1	25	3.13	Shumë e Mirë
Kroacia	4	4	4	4	3	2	0	0	21	2.63	E Mirë
Bullgaria	4	4	4	4	3	2	0	1	22	2.75	E Mirë
Mali i Zi	2	0	3	3	2	1	4	no data	15	1.88	Jo e Keqe
Serbia	0	0	1	1	0	0	4	0	6	0.75	E dobët
Greqia	0	0	1	0	0	0	0	1	2	0.25	E dobët
Rumania	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0.13	E dobët
BH	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00	E dobët

Annex 3: Arritja e rezultateve për intensitetin e marrëdhënieve

Rezultatet/pikët nga Matrica e Vlerësimit për intensitetin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe shteteve të tjera të rajonit							
Shtetet	Vizitat/takimet Presidenciale	Vizitat/takimet Kryeministore	Vizitat/takimet e Ministrave të Jashtëm	Vëllimi i tregtisë (në miliona €)	Totali	Rezultati përfundimtar	Intensiteti
Shqipëria	4	4	4	3	15	3.75	Shumë Intensive
Turqia	2	2	2	3	9	2.25	Intensive
Maqedonia	1	1	2	4	8	2	Pak Intensive
Kroacia	2	2	2	2	8	2	Pak Intensive
Sllovenia	1	2	3	2	8	2	Pak Intensive
Bullgaria	1	1	1	1	4	1	Pak Intensive
Greqia	0	0	2	2	4	1	Pak Intensive
Serbia	0	0	0	4	4	1	Pak Intensive
Mali i Zi	1	1	1	0	3	0.75	Joaktive
BH	0	0	0	2	2	0.5	Joaktive
Rumania	0	0	0	0	0	0	Joaktive

Aneksi 4: Njohjet dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike

Njohjet dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike			
Shtetet	Njohja	Marrëdhëniet diplomatike me Kosovën	Data e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike
Shqipëria	18.02.2008	Po	18.02.2008
Turqia	18.02.2008	Po	18.02.2008
Maqedonia	09.10.2008	Po	18.10.2009
Serbia	Jo	Jo	Jo
BH	Jo	Jo	Jo
Mali i Zi	09.10.2008	Po	15.01.2010
Kroacia	19.03.2008	Po	30.06.2008
Sllovenia	05.03.2008	Po	15.05.2008
Bullgaria	20.03.2008	Po	27.05.2008
Rumania	Jo	Jo	Jo
Greqia	Jo	Jo	Jo

Burimi: Kosovothanksyou.org dhe MPJ e Kosovës

Aneksi 5: Investimet për GDP të shteteve të rajonit në Kosovë

Investimet Rajonale në Kosovë			
Shtetet	PBB vjetore 2008-2012 (Euro)	Investimet vjetore në Kosovë 2008-2012 (Euro)	Investimet / PBB
Shqipëria	9,103,083,707.46	16,271,100.58	0.18%
Slovenia	35,813,926,455.34	30,918,194.78	0.09%
Maqedonia	7,063,515,894.47	2,456,910.44	0.03%
Turqia	529,723,858,261.08	28,682,710.79	0.01%
Bullgaria	36,765,300,926.39	3,573,691.68	0.01%
Serbia	29,946,420,711.00	1,464,795.53	0.00%
Greqia	217,363,261,780.39	1,306,822.96	0.00%
Kroacia	45,364,864,587.67	1,276,044.66	0.00%
BH	12,823,737,263.07	428,679.75	0.00%
Mali i Zi	3,153,157,986.15	n/a	n/a
Rumania	133,243,905,052.57	n/a	n/a

Burimi: Banka Botërore dhe Banka Qendrore e Kosovës

Aneksi 6: Tabelë gjithëpërfshirëse

Tabelë gjithëpërfshirëse									
Shtetet	Njohja	Data e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike	Vendosja e marrëdhënieve në nivel ambasadorësh	Numri i marrëveshjeve	Investimet/PBB mesatarja e 2008-2012	Vëllimi tregtar mesatarja 2008-2012 (Euro)	Vizitat/takimet Presidenciale	Vizitat/takimet Kryeministore	Vizitat/takimet e Ministrave të Jashtëm
Shqipëria	18.02.2008	18.02.2008	18.02.2008	17	0.18%	109,310,400.00	16	13	10
Turqia	18.02.2008	18.02.2008	18.02.2008	21	0.01%	168,551,200.00	4	4	5
Maqedonia	09.10.2008	18.10.2009	18.10.2009	16	0.03%	346,593,200.00	3	2	6
Serbia	No	No	No	11*	0.00%	250,443,000.00	1*	16*	0*
BH	No	No	No	0	0.00%	71,596,000.00	0	0	0
Mali i Zi	09.10.2008	15.01.2010	No	3	n/a	19,067,800.00	2	1	3
Kroacia	19.03.2008	30.06.2008	30.06.2008	8	0.00%	62,850,800.00	6	5	5
Slovenia	05.03.2008	15.05.2008	15.05.2008	6	0.09%	71,047,600.00	3	5	8
Bullgaria	20.03.2008	27.05.2008	27.05.2008	4	0.01%	47,557,800.00	1	2	3
Rumania	No	No	No	0	n/a	14,760,200.00	0	0	0
Greqia	No	No	No	0	0.00%	96,159,800.00	0	0	4

* Marrëveshjet jobilaterale

* Takimet në Bruksel

--- fundi i dokumentit ---